

BIBLIOTEKA

E

811-32

54 95

SHTETIT

GJIROKASTËR

FYELLI i MARSIASIT

DH. S. SHUTERIQI

trajime

DH. S. SHUTERIQI

SHKURTORI I SHKËRIT
GJIRKASIT

~~33716~~

2488

FYGLLI I MARSIASIT

DHE TREGIME TË TJERA

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1963

VEPRA TË DH. S. SHUTERIQIT

O PTOLEME! poemë, 1945.

ENVERIT, poemë, 1945; bot. i ripunuar 1949.

MI KRAHN' E PRARUAR TË PAQES, poemë dhe
vjersha, 1950.

ÇLIRIMTARËT, roman, libër I, 1952; libër II, 1955.

PESË TREGIME, 1953.

RRUGA E RINISË, tregime, 1953.

TAKIME PAQE, tregim, 1955.

GURNECKA, tregime, 1957.

KËNGË, vjersha dhe poema, 1961.

METRIKA SHQIPE, 1947.

A. Z. ÇAJUPI, Baba-Tomorri dhe vepra të tjera (re-
daktim), 1950.

ANTOLOGJI E LETËRSISË SHQIPE, 1955; bot. 5, 1962.

HISTORI E LETËRSISË SHQIPE, 1955; bot. 4 i ripunuar, 1962.

KËNGA E POPULLIT, përmbledhje poezie popullore, 1955,

ÇAJUPI, Vepra (redaktim), 1957.

HISTORIA E LETËRSISË SHQIPE e Universitetit Shtetëror
të Tiranës, (bashkëpunim me Auktorë të tjerë dhe re-
daktim), vëll. I, 1959; vëll. II, 1960.

FYELLI I MARSIASIT

**Për kujtim të tim eti
dhe të vëllezërve të mi.**

Tregim i parë

DALLËNDYSHET

Janë ngjarje të kohës së kaluar, këto që po nis t'ju tregoj sot, të dashur shokë të rinj. Shpesh jam matur të rrok pendën dhe t'i shkruaj për ju, po nuk më është bërë mbarë. Sot, m'u shkrep dhe një herë të rrok pendën dhe të mbaj premtimin që ju kam dhënë në veten time qëkuri. Dhe ja, po nis t'i hedh në kartë këto tregime.

* * *

Dua ta nis me udhëtimin tim të parë.

Ne udhëtonim me kalë qëmoti. Automobil nuk kishte ahëre në Shqipëri, ose thuaj se nuk kishte. Edhe tren, domosdo që nuk kishte. Tani, ka edhe aeroplan. Bile, midis jush, mund të ketë që kanë udhëtuar me aeroplan. Në fëmininë time, udhëtohej me kalë. Udhëtimin tim të parë unë kështu e bëra.

Ka qenë viti 1920. Babanë ma kishin transferuar në liceun e Korçës. Ne banonim në Elbasan, në qytetin e lindjes. ku im atë jepte, prej shumë vjetësh, mësimin e shqipes në shkollën normale.

Kur u rrita dhe pak, mësova se atë transferim babait ia bënë për inat nj'a dy eprorë të tij, me të cilët ai nuk shkonte mirë. Ahere, ishin kohë padrejtësirash. Të transferoje një njeri nga vendlindja, tri ditë udhë larg, ta largoje nga shtëpia dhe katan-dia, mund të ishte një dënim i vërtetë.

Na u desh të shkrehim shtëpinë, të ngrejmë plaçkat dhe të marrim atë udhë të gjatë majë kalit.

I shkreti baba u nis i pari vetë, se ashtu ia desh puna. Pastaj, dërgoi e na mori dhe ne të shtëpisë, — nënën time dhe dy fëmijë (mua me një motër në djep), gjyshen (mëmën e mëmës) dhe një dajë, djalë katër-pesëmbëdhjetë vjeç.

Ja si udhëtonim ne ahere.

Kishte karvane, që bënëin rregullisht udhën nga Elbasani në Korçë dhe nga Korça në Elbasan. Dërgonin përpjetë krypë e vaj, sillnin tatëpjetë shajak e gjëra të ndryshme. Ose dërgonin e sillnin njerëz. Karvane të tjera venin e vinin nga Durrësi dhe Berati, Dibra, Ohri dhe Manastiri. Elbasani ka qenë kurdoherë një qendër e rëndësishme udhësh në mes të Shqipërisë.

Ngarkuam plaçkat pra, dyshekët e jorganët nëpër dengje, enët nëpër arka e kasa, dhe u nisëm me kuaj.

Ishin ca kafshë të mëdha, me samarë të lartë, që ne i mbuluam me belca të kuqe. Në qafë, kuajt kishin këmborë dhe këto këmborë binin tërë udhës me një muzikë të vërtetë, që përhapej përrenjve dhe

pyjeve përpjetë e tatëpjetë, dhe gëzonte vendin sikur të shkonin krushq dasmorë.

Qiraxhinjtë (kështu quheshin të zotërit e karvanit) ia thoshin këngës. tregonin historira, flisnin për udhëtimet e tyre të mëparëshme, na mësonin ndonjë gjë për fshatrat që shihnim dhe viset nga kapërxenim, bënin shakara dhe u ngërmonin kuajve, që nuk ecnin si duhet ose që nuk mbanin radhën:

— Hy, tyc! Tyc, mor të çaftë ujku!

Dhe rruga e gjatë dukej shumë e shumë më e shkurtër se ç'mund të pandehni ju.

Unë që isha pesë vjeç ahëre, kuptoja disa gjëra dhe hapja veshët e dëgjoja, ç'tregonin qiraxhinjtë. Me pyetjet e mia, qiraxhinjtë i lodhja. Pyesja për çdo zog që shihja për herë të parë, për shkëmbenjtë e drurët. Dhe qiraxhinjtë mblidhnin lule të bukura, gurë të bukur, dhe m'i jepnin. Kur qëndronim pranë ndonjë burimi, më nxirnin nga arka ku më kishin futur, dhe më freskonin.

Harrova t'ju them: të mëdhenjtë udhëtonin majë kalit po ne të vegjëlit na futnin nëpër arka pa kapak. Na i shtronin mirë ato arka, me mindere e jastëkë, dhe ne rrinim aty si në kuti. Dhe koloviteshim që ç'ke me të.

Në një arkë të tillë e kam bërë udhëtimin tim të parë. Vetëm koka më dilte përmbi arkë, një kokë me kaçurrela të zez, në mos e qethur me maqinë, — nuk më kujtohet mirë.

Nga kjo anë e samarit ishte arka ime. Nga ana tjetër, një tjetër arkë, me disa plaçka të shtëpisë. Në këtë arkë, udhëtonte maçoku ynë, një

maçok i bardhë me pulla të zeza. Nuk më kujtohet emri i tij, po ta zëmë se e quanin Lashi.

Herë pas here, Lashi ngjitej e nxirrte kokën mbi arkë, me njërin sy në një pullë të bardhë dhe me tjetrin në një pullë të zezë. E ngrinte kokën mbi arkë, sikur të desh të sigurohej se po udhëtonim dhe ne të zotërit e tij me të, apo e kishim braktisur. Mjaulliste ahëre prej gëzimit, fuste kokën brenda dhe nuk dëgjohej më fare. Mbase dhe flinte kutullaç atje në arkë, në të ngrohtë, si pranë zjarrit të shtëpisë sonë në Elbasan. Se, asaj vjesh-te të dytë, bëri një behar i vërtetë plot diell.

Kur kali pengohej më ndonjë gur dhe ne tronditeshim nëpër arka, unë shtrëngoja fort duart e mia të vogla në buzët e arkës sime dhe Lashi zgjaste kokën mbi arkën e vet, i zgjuar ose i trembur nga ato lëkundje të papritura, dhe mjaulliste sikur të qante:

— Mjau! Mjau! Po ç'na bën kështu, mor gjok? Do të na rrokullisësh më ndonjë gorre!

Unë kisha qejf kur gjoku pengohej, se doja të shoh Lashin të nxjerrë kokën e tij të mërzhitur ose të trembur, dhe i flisja maçokut «pës-pës». Ai, që më donte shumë, matej të kapërxente mbi samar dhe të vinte tek unë, po nuk ia mbante.

Në shtëpi, në Elbasan, me një të hedhur, Lashi arrinte degën më të lartë të portokallit ose të ftoit të oborrit tonë, ose këcente çati më çati mbi rrugicat e lagjes. Tani, maçoku nuk guxonte të kapërxejë mbi samar nga një arkë te arka tjetër, po mbli-dhej shpejt në fund të arkës së vet, ku e ndjente veten plotësisht të sigurt, dhe më kot mund ta thërrisja unë ahëre «pës-pës»: Lashi nuk e nxirrte më

kokën, po të mos pengohej fort gjoku. Bile, ditën e dytë, maçoku as që desh t'ia dijë nga lëkundjet një copëherë të gjatë dhe nuk do ta kishte nxjerrë më fare kokën mbi arkë, sikur të mos kishin ndodhur ato që do t'ju tregoj.

Ditën e dytë, ne udhëtuam prej Quksi në Pogradec. Dita e parë e udhëtimit ishte prej Elbasani në Qukës, një herë nga e djathta, pastaj nga e majta e lumit të Shkumbinit, i cili, sa më shumë t'u ngjitesh maleve përpjetë, aq më shumë bëhet i ngushtë dhe i rrëmbyer.

Sikundër thashë, që vjeshtë e dytë. Nga Qukësi e tutje, koha ishte po aq e bukur, veçse pak e ftohtë. I thonë mal atje dhe jo si në Elbasan, ku piqet ulliri dhe portokalli. Dhe ja, më të dalë të Qukësit, pasi kapërxyem nëpër disa gryka të ngushta, hymë në Fushën e Domosdovës, pranë fshatit Përrenjë.

Ata që s'e kanë parë atë fushë, të mos e lënë pa e parë, se është një nga më të bukurat e Shqipërisë. Është një pllajë e madhe, rrethuar prej malesh të lartá, herë të gjelbëruara, herë të përhirta dhe shkëmbore. Nëpër fushë, — ara misri, grurore, shelgjishta të gjata, nën të cilat rrjedhin ose burojnë, të padukëshme, ujra të kristalta. Rrëzë maleve, zbardhojnë shtëpitë e kaq fshatrave.

Edhe Lashi ynë u duk sikur u çudit me bukurinë e këtij vendi, se i mbeti koka jashtë arkës. Veçse nuk që bukuria që ia tërhijte vëmendjen kaq shumë maçokut, po telat e telefonit që nuk ishin larg udhës, nga e djathta jonë.

Mbi këto tela, kishin qëndruar me qindra dhe mijra dallëndyshe, që linin viset e ftohta dhe nise-

shin për viset e nxehta, si çdo vjeshtë. Qindra e mijra cicërima zhurmuese mbushnin qiellin e kaltër. Ishte një mori e tillë dallëndyshesh, sa nuk kisha parë kurrë në ato pak vjet të jetës sime dhe sa nuk ma merrte mendja të kish në botë. Rëndonin dallëndyshet mbi telat e telefonit dhe telat nxinin prej tyre, ashtu sikundër zbardhojnë dimrit, kur ngarkohen me dëborë.

Lashi nuk e fuste aspak kokën në arkë, po hapte sytë e tij të shëndritshëm dhe lëshonte ndonjë mjau të lehtë, nga frika se mos trembë zoqtë. Këta i trembnin herë pas here këmborët e karvanit.

Bëhej kështu një muzikë këmborësh, cicërimash e përrenjsh që rrjedhin ëmbël, muzikë të cilën vetëm ai që e ka dëgjuar mund ta marrë me mend mirë. Të gjitha më kanë mbetur në kujtesë si gjëra të çuditëshme.

Unë isha hutuar fare në arkën time. Kur ja, kuajt u afruan kaq shumë pranë telave të telefonit, sa dallëndyshet u trembën, fluturuan si një re e vërtetë dhe ranë më tutje pas nesh, gjithmonë përmbi telat.

Disa dallëndyshe qëndruan në vend ku ishin. Maçoku gati sa nuk këceu prej arkës. Atë çast, pashë të bien dallëndyshet nga telat përdhe, sikur t'u ishin tharë krahët. Lashi me gjithë mend do të kishte këcyer nga arka përtokë, po edhe këtë radhë nuk ia mbajti.

Sa frikaman paske qenë ky maçoku ynë, që unë diç e dija!

Ma ndjeu zemra përse u këputën e ranë ato dallëndyshet, edhe pse u hutova dhe nuk mora vesh mirë se ç'ngjau. U lëndova kaq shumë dhe kaq me-

njëherë, sikur zoqtë të mos kishin rënë përdhe, po mbi zemrën time të vogël dhe ta kishin vvarë. Sytë m'u mbushën me lot e thirra:

• — Bobo, dallëndyshet, nëne!

Hysa, ai i pari i qiraxhinjve, rendi dhe i mori dallëndyshet e rrëzuara, duke psherëtitur me hidhërim:

— Zoqtë e shkretë!

Ndonjë dallëndyshe më e dobët nga të tjerat ose shumë e kapitur prej udhës që mund të kishte bërë gjer në Shqipëri, duke u nisur nga vise të largëta të Europës, — ta zëmë nga Hungaria ose Gjermania dhe më tutje, — s'kishte mundur të qëndrojë më gjatë.

Karvani ishte ndaluar nuk e di përse: ndofta se dhe kuajve iu dhimbsën zoqtë e mjerë; ndofta se i ndaloi Hysa. Ky m'i solli mua dallëndyshet në grushtin e tij.

Ishin tri dallëndyshe të zeza, me barkun të bardhë e aty-këtu si më të kuq e bojë hiri. Fletët u kërcisnin si kartë. Të quknin majat e bishtave të tyre si gërshëra.

Ishin akoma të ngrohta dallëndyshet dhe unë i vura në prehrin tim dhe nisa t'i përkëdhel me doçkat e mia. Kur ja, ndjeva se njëres i rrihte zemra atje përbrenda krahërorit të butë, dhe më më i dridhej se i rrihte.

— Qenkan të gjalla! brita unë prej gëzimit.
— Qenkan të gjalla, nëne!

Karvani sikur u nis me këto fjalë, me urdhërin tim, dhe zunë të bien gëzueshëm këmborët e kuajve.

Dallëndyshet, të trullapura nga teli dhe të vrapa nga të rënit, filluan ta marrin veten ngadalë. Për çdo lëvizje të tyre, unë lëshoja nga një klithmë gëzimi. Hysa vinte dhe fuste kokën te arka ime, gëzohej dhe ai dhe gëzonte të tjerët, duke u tre-guar se ç'po bëjnë dallëndyshet.

Lashi, nuk kishte më frikë nga tronditjet e gjo-kut, po mbante kokën mbi arkë dhe vështronte nga unë, sikur të më lutej me sytë dhe mjaullimat e tij:

— Mjau! Mjau! Nem edhe mua një dallëndy-she, të los me të! Jemi apo nuk jemi shokë? Dua dhe unë të los me dallëndyshet!

Po unë kaq gjë e dija: që maçoku lot me da-llëndyshet ashtu si lot me minjtë që i bien ndër thonj.

— Jo, mor maçok! Mua të më gënjesh ti? Tani që dallëndyshet po shërohen, kërkon t'i ngordhësh zotrote? Nuk të jap dallëndyshe unë, kaq ta bësh dhëmbin! E di unë sa gënjeshtar je ti!

Po maçoku, që më kuptonte, nuk pushonte së luturi me mjaullima edhe më të buta, edhe më prekëse:

— Mjau! Mjau! Nuk të gënjej, për kokën tën-de! Mos paça kokën, që s'të gënjej! Po nem edhe mua një dallëndyshe, të los me të! Dua dhe unë të los ca! Apo nuk u mërzita në këtë arkë dhe unë?

Kur po më lutej kështu Lashi dhe unë e vësh-troja vëngër, dy dallëndyshe rrahën krahët, më shpëtuan nga prehri dhe dolën fluturim prej arkës: As që i pashë mirë se si shpëtuan. Veç kur u zhdu-kën midis një tufe të madhe dallëndyshesh, që flu-

turuan mbi kokën tonë plot cicërime! Nuk di ta tregoj gëzimin tim.

Dallëndyshja e tretë që mbeti, nisi dhe ajo të provojë krahët e saj, po s'arriti të fluturojë. Unë u bëra pik' e vrer. E fërkova, e mora në duar, e putha, e ngrita lart. I mjeri zog përpëliste krahët dhe nuk lëshohej dot në hapësirë. Thonjtë e tij më kishin kapur e më pickonin gishtat, po zogu nuk fluturonte dot.

Më së fundi, dallëndyshja e tretë guxoi, cicëriti disaherë fort drejt shoqes, që kishin qëndruar mbi telat e telefonit larg nesh, e u hodh në ajër.

E pashë të përpëlitet në fluturim, të ngjitet përpjetë, të ngrihet shumë, dhe pastaj, pa mundur të arrijë te shoqet e saj, të këputet prej së larti si një gur. Unë mbylla sytë, i lebetitur:

— Bobo, dallëndyshja!

Ime gjyshe tha:

— E ngrata! Ra tamam në përrua!

Hysa erdhi e më nxori prej arkës, më mori në krahë dhe nisi të më tundë e të më shtrëngojë, për të më ngushëlluar, me fjalë të tilla:

— Hajde, trim i Hysës, hajde! Kështu bëjnë burrat? Pa shih, pa shih, si po qan vërtet! Pa dale ta gudulis një çikë!

Dhe më gudulisi. Po vaji im nuk pushoi, veçse kur më mori gjyshja përpara kalit dhe nisi të më puthë e të më ledhatojë.

Shpesh kam menduar më pas te ajo dallëndyshe dhe mendoj edhe sot me trishtim. Ne ishim nisur për një udhë të gjatë, si dhe zoqtë. Merreni me mend sikur dhe ndonjëri nga ne të kishte mbe-

tur udhës, ashtu si mbeti ajo dallëndyshe fatzezë. Dhe vërtet, ime motër, që ish ahëre motake, na u sëmur dhe desh na vdiq të nesërmen, po e shëruam. Unë nuk arrita ta shëroj dallëndyshen. Sigurisht nga padija, me që isha i vogël. Po ndofta edhe nuk mund të shërohej më... Kurse maçoku ynë, ai zemërgur, do të kishte dashur ta çqyente të gjallë me dhëmbë zogun. Një muaj të tërë, nuk i fola Lashit dhe as e përkëdhela fare. E di që kam bërë gabim, po nj'a dy herë i dhashë edhe ndonjë shqelm.

Tregim i dytë

G U R N E C K A

Këto që do t'ju tregoj tani, janë nga udhëtimi im i dytë, të cilin e kam bërë me automobil dhe me kalë.

Unë ju kam thënë se automobili pothuaj se nuk shihje ahëre në Shqipëri. Kështu vërtet. Automobili punonte vetëm në ndonjë kënd të Shqipërisë. Në Elbasan nuk kishte. Dhe, për të parën herë, automobili unë kam parë në Korçë.

Ishin ca kamionë të mëdhenj, me motorin të vogël përpara, mbi katër rrota të ngushta dhe të larta. Krahas kamionëve të sotmë, kamionët e qemotit ngjanin me ca karroca të shëmtuara.

Mbi një maqinë të tillë kam udhëtuar prej Korçë në Pogradec, duke kaluar nga Bilishti, ku lamë dhe morëm postën. Bashkë me tim atë, shumë vend te shoferi, përpara.

Shoferi ishte një djalë i ri, i nxirë nga dielli dhe i ndotur nga vajrat. E quanin Maqi. Ishte nga shoferët e parë të Shqipërisë.

Ka qenë fillimi i korrikut 1921. Shkollat ishin mbyllur dhe im atë vendosi t'i kalojë pushimet te disa miq të tij, në krahinën e Mokrës së Pogradecit. Unë isha ahere gjashtë vjeç dhe në vjeshtë do të shkoja në filloret.

E ç't'ju tregoj më parë për atë udhëtim me automobil? Kaq më kujtohet, se, kur maqina shkante me shpejtësi, unë habitesha që arat, drurët, shtëpitë, nga të dyja anët e udhës, ecnin dhe ato drejt nesh. Nuk dukej sikur ecte maqina, po sikur lëvizte toka me ç'kishte përsipër.

Dhe ata kamionët e qëmotit buçitnin aq shumë, sa nuk buçasin sot as aeroplanët reaktivë. Pa le kur kërcitnin, se u zihej benzina shpesh: bënin bam-bam, sikur të kërciste ndonjë pushkë a top!

Unë trembesha, mbyllja sytë dhe veshët, fshihja kokën në krahëror të tim eti. Shoferi qeshte me mua me zë të lartë. Automobili, si për inatin tim, kërciste akoma bam-bam.

Mezi u mësova. Nisa ahere të mos lë rehat borinë e automobilin, një bori e gjatë një pash, e mbërthyer pranë timonit, dhe që i bihej duke shtypur një tollumb të madh e të kuq llastiku: pà! pà!

Unë i bija borisë, Maqi shoferi qeshte dhe, ç'qe gjë e gjallë pranë udhës, nuk dinte ku të futej nga tërë kjo potere e kamionit që kërciste dhe e borisë që pëlliste.

Lëre ç'qejf!

Po ç'e do, se babanë e zuri maqina. Ai vuante nga stomaku: erën e benzinës dhe trungullitjet e

mëdha të kamionit nuk i duroi dot. Nxori zorrët e barkut e u bë më i verdhë se limoi. Më vinte keq për të, po ç't'i bëja? Të them të drejtën, më vinte dhe rëndë nga shoferi, i cili mbase thosh me vete: «Ç'baba që paska dhe ky! Nuk duron dot as erën e maqinës!»

Duke menduar kështu, pezmatohesha. Maqi dukej sikur e kuptonte pezmatimin tim. Ai, me një dorë mbante timonin dhe me tjetrën më shtrëngonte pas vates, duke thënë:

— Bravo, Taqkë! Ti do të bëhesh një shofer i mirë.

Mund të shënoj këtu, se ëndrra e madhe e fëminisë sime, disa vjet me radhë, ka qenë të bëhem shofer. Kush e di sa maqina të vogla kam prishur e ujdalur unë, kush e di sa garazhe kam ndërtuar...

Ishim nisur prej Korçe me të lindur dielli dhe arritëm në Pogradec pas katër orësh. E merni me mend se maqinat e dikurëshme nuk qenë të shpejta si këto të tanishmet. Po ne qëndruam shumë udhës, dhe jo vetëm në Bilisht për postën. Disaherë qëndruam që të marrë veten babai, herë të tjera që të marrë veten maqina dhe t'i shtjerë Maqi ujë. Ato maqinat e qëmotit nxeheshin shpejt dhe keq: u zjente ujët në kazan dhe u çfrynte avulli me gulçim nga krei i radiatorit.

S'ka gjë më të bukur se sa të shohësh Pogradecin dhe liqenin e tij që nga Qafa e Plloçës. Dikur, qyteti nuk shtrihej akoma buzë liqenit, si shtrihet sot. Pogradeci ishte një qytet i vogël, shumë i përmbledhur. Shtëpitë e tij sa mezi nxirnin çatitë e kuqe përmes plepave dhe gështenjave. Liqeni shtrihej si një det i kaltëruar, i rrethuar me male të

33316
2488

larta. Skaji mezi i çquhej atje tej nga veriu, nga Ohri dhe Struga.

Në Pogradec, na priti një ish-nxënës i tim eti, një farë Marko, prej katundit Podgozhan të Mokrës. Markua kishte qenë disa kohë mësues, po tani punonte si murator, mjeshtëri kjo që podgozhanasit e ushtrojnë gjysh stërgjyshi. Arësimi ahëre ishte i pakë në Shqipëri dhe shkollat, edhe pse të rralla, nuk punonin të gjitha me rregull.

Ndejtëm dy dit në Pogradec. Babai kishte miq aty dhe shkante t'i vizitojë. Markua rrinte me mua. Më shetiste nga gështenjat, vinim e laheshim në liqen. Ai ishte një burrë i shtruar dhe i ëmbël, disi kuqal, me sa më kujtohet, me një palë mustaqe gjer te veshi dhe një kasketë të vjetër që i binte mbi vetulla.

Që ditën e parë, Markua më bleu një grip dhe vamë të zëmë peshk te një urë druri që hynte thellë në liqen.

Pas kësaj lidheshin varkat ose gjemitë. Bile kishte dhe një gjemi të madhe me motor, që punonte nga Pogradeci në Ohër. Kjo ishte e francezëve.

Pogradeci, gjatë luftës së parë botërore, ishte në dorë të ushtrisë franceze. Më 1920, kur ne bëmë udhëtimin tonë të parë në ato vise, akoma kishin mbetur disa ushtarë francezë në Pogradec, me gjithë së lufta po bënte dy vjet që pushoi. I kam përpara syve çadëret e tyre anës liqenit. Kishin nga një flamur shumëgjyresh në majtë... Kur u rrita, kam mësuar se si ushtritë e huaja, pa na pyetur në farë, bënë luftë midis tyre në Shqipëri dhe shkaktërruan vendin...

Merreni me mend peshkimin tim të parë. Një djalë një pëllëmbë, me një kallam dy herë më të gjatë se vetja, hidhte grepin që nga ura në liqen.

Grepit, Markua i vinte tul buke të ngjeshur. Me dhjetra peshq të veckël, me dhjetra gurnecka, — sikundër i quajnë në Pogradec një lloj cironkash, — i suleshin grepit, çukitnin bukën, e hanin në sy tim, po... grepin nuk e hanin!

Ec e mos pëlçit e mos bëj bam! Nj'a dy herë, nga inati, desh e flaka në liqen kallamin. Nj'a dy herë edhe qava. Po Markua më merrte me të mirë e më mbante me shpresë:

— Mos u mërçit, mor bir. Peshku nuk zihet kaq lehtë. Gurnecka është e zgjuar. Po mos ki merak, se do zësh gurnecka sa të duash.

Dhe fjala i doli.

Ja, një gurneckë më e vogël se shoqet dhe sigurisht më e urtuar dhe më pak e djallëzuar, u lëshua që atje matanë si plumbi, iu vërsul grepit tim dhe e gëlltiti menjëherë bukën me gjithë grep. Po më kot deshi të kthehet prapë gurnecka, se mori dhe perin pas.

Me fjalë të tjera, ngeci gurnecka në grept, u përpëliti nëpër ujë, herë i zbardhi barku dhe herë i nxiu kurrizi, këceu dhe mbi ujë një herë, po nuk shpëtoi dot.

«Sa e fortë na paska qenë dhe një gurneckë!» bëra çudi unë.

Bëra çudi dhe u hutova. Nuk e tërhoqa grepin. Markua nuk e pat edhe ai mendjen aty. Po, kur pa se ç'ngjiste, më briti:

— Hiqe grepin!

Unë, fët ngrita kallamin lart dhe gurnecka nisi të përpëlitet në ajër, majë perit. Shëndriste në diell si një copë argjend.

Lëre-lëre gëzimin tim!

Nisa të hidhem përpjetë e të thërras:

— E zuna! E zuna! Shi gurnecka! Shi gurnecka!
Sa e madhe, mre dajë Marku! Sa e madhe!

Hidhesha e thërrisja kaq shumë, sa u mblodhën përqark nesh një tok burra e kalamaj, dhe nisi një gaz i vërtetë. Talleshin pogradecarët me mua.

Njëri thoshte:

— Bobo, ç'gurneckë! Sa një krap!

Tjetri ia priste:

— E patë, more, si e zuri? Pëshkatar e shkuar peshkatarit!

Tjetri ia kthente:

— E zuri gega gurneckën!

Se, që thoni ju, unë akoma nuk e kisha thyer gjuhën, po flisja gegërisht, si në Elbasan. Dhe kjo gjuha ime më dallonte menjëherë midis vendësve, midis toskëve. Edhe në Korçë, shokët e lagjes e të foshnjores nuk më thërrisnin me emër, po gegë.

Sidoqoftë, unë as që ua vura veshin talljeve të pogradecarëve, po hidhesha e thërrisja akoma për gurneckën e parë që kisha zënë dhe që tani më përpëlitet në duar, pasi Markua e hoqi prej grepit.

Atë kohë, një gjemi u afrua te ura. Ishte një nga ato gjemitë e moçme, që nuk t'i zë më syri në liqen të Pogradecit: të bëra me trungje të mëdha, të gjera dhe të gjata sa dy buallica bashkë, me bashin të ngritur lart mbi ujë, të rënda dhe që ngri-

nin valë kur shkonin, të nxira dhe të molitura nga vitet.

Në atë gjemi, ishin dy burra në këmbë, që punonin nga një lopatë secili. Dhe, sa ç'ishte gjemia e gjatë, — një alamet peshku, që skuqte në diell. Peshku ishte më i gjerë se gjemia dhe i dilnin fletët nga të dy anët, si krahë të mëdhenj e të ngërthyer.

Te ura u imblodhën njerzit xhumbë dhe buzë liqenit u grumbulluan menjëherë me dhjetra vetë. Kush të pyeste më parë dhe kush të thërriste më shumë. Të dy peshkatarët, që sollën gjeminë, mbaheshin rëndë-rëndë dhe mezi u përgjigjeshin njerëve që pyesnin.

Mbaj mend që thoshin se peshk i tillë po bënë shumë dhe shumë kohë që s'ishte zënë në Pogradec. Ca thoshin se njëzet, ca thoshin se dyzet vjet më parë. Dëgjova të thonë se ky peshk na peshokërke pesëdhjetë, tetëdhjetë, një qind okë... Nisën të mos merren vesh njerzit për këto punë.

Markua, që të mos më shtypin dhe të mos bie në ujë, më kishte ngritur në krahë.

Unë ia kisha nxjerrë shpirtin gurneckës sime, duke e shtrënguar në duar. Gurneckën e harrova fare dhe shikoja atë alamet peshku sa një gjemi e më të madh se gjemia, që kishte hapur një gojë dy herë sa të kalit dhe kishte zgurdulluar një sy sa një patkua. Prej syut rridhte pak gjak. Gjak rridhte edhe nga një vrimë e madhe që i kishin bërë peshkut mbi njërën ijë.

Ashtu, fort i çuditur dhe më i çuditur se tërë bota, thashë edhe unë një fjalë:

— Kjo qenka gurneckë, o dajë Marku, dhe jo ajo qi zuna unë!

Nj'a dy vetë që dëgjuan fjalët e mia, ia krisën gazit:

— Kjo s'është gurneckë, mor i uruar, tha njëri. — Ky është krap, mbreti i krapëve. Ti, ndaj këtij, je sa një gurneckë vetë.

Vërtet, atë çast, unë e ndjeva veten aq të vockël sa s'ka. Se ç'isha unë ahëre? Një gurneckë e vockël.

BUZË SHKUMBINIT

Mokra është malësi. Përrenj e lumenj të rrëmbyer, pyje të thella, male të larta. Dhe nëpër ato vise, — lugina të shumta, fshatra të përndara.

Me kuajt që na solli Markua, shkua në Podgozhan. Aty qëndruam vetëm një natë dhe nuk më kujtohet farëgjëje prej Podgozhanit, veç babait të Markos, — një plak i bardhë si dëborë, me një mjekër gjer te brezi, — dhe nj'a dy-tre çuna, djemtë e Markos, të gjithë balashë. Po, mbi të tëra, më kujtohet hoshmari që na nxorën për darkë.

Kush nuk e di se ç'është hoshmari, ia them unë. Është një si kaçamak me miell misri, i mbytur në gjalpë. Ka aq shumë gjalpë, sa i qëndron katër gisht përsipër. Dhe mban ky hoshmari një erë kaq të mirë, sa ia kalon edhe mjaltit vetë. Dhe hahet me kaq shijë, sa të shkrin në gojë.

Edhe sot më lëshon goja lëng, kur e kujtoj atë hoshmarin e parë që hëngra në Podgozhan. Dhe s'më harrohen djemtë e Markos, të cilët nuk u shtruan në sofër me ne, po rrinin atje pranë derës së konakut të miqve dhe, me sytë e tyre si xhixha, e ndiqnin lugën time plot hoshmar që nga çanaku te goja dhe që nga goja te çanaku.

Ajo gjellë është e rëndë. Im atë nuk futi më shumë se tri lugë në gojë. Ai hëngri çorbën me pulë dhe kosin. Unë e teprava me hoshmar edhe sepse më fliste babai. Të nesërmen, e mërzita Markun atyre pyjeve, kur vijua udhëtimin: më zbriti kaq herë prej kalit që të vete të çlirohem. . .

Ne ishim nisur për Veliçan. Atje i kishte miqtë e tij babai dhe atje ndejtëm nj'a dy-tri javë.

E ç't'ju them më parë për Veliçanin?

Fshat i madh, kodër më kodër. Ujë shumë, — dardha edhe më shumë. Ato i mbaj mend mbi të gjitha Veliçanit, — dardhat. Mokra është e njohur për dardha, po Veliçani ndofta mbi tërë fshatrat e saj. Dardha bishtje, bozdogale, lëngie, vjeshtake, trushinka dhe shumë e shumë të tjera, të cilat ne nuk i shijua të gjitha, sepse nuk piquen të gjitha në një kohë, po palë-palë, verës dhe vjeshtës. Ku i përmend dot njeriu tërë llojet e dardhave të Mokrës e të Veliçanit? Dhe bëjnë aq shumë atje dardhat, sa hanë njerëzia dhe ngopen bagëtia.

Në Veliçan, tek miqtë tanë, fëmijë të vegjël s'kishte. Qe vetëm Hekurani, një djalë katërmëdhjetë vjeç, goxha burrë ahëre, me kokën gjer atje. Me të shoqërohesha dhe losja unë. Ose, më mirë, los-te Hekurani me mua. Më çonte dardhë më dardhë e burim më burim. Herë vinim me dhen, herë me

dhi, herë të tjera me lopë. Mblidhnim e hanim luleshtrydhe korijeve dhe lëndinave. Kur nuk gjenim luleshtrydhe, kënaqeshim me manat e ferrës.

Për mua, Hekurani bënte pibza prej kashte gruri. Një ditë, më bëri një hark, një hark të vërtetë. E gdhendi në dru dhe e stolisi me gjithëfarë lulesh. I çau harkut një lug për së gjati dhe të dy cepat e tij i lidhi me një spagë të fortë. Pastaj, preu degë fieri, i qëroi dhe i bëri shufra të holla si shtiza.

Me të tilla shigjeta qëlloja. I hidhte harku shigjetat e fierit më larg se ç'mund të hidhte Hekurani një gur me dorë.

Kudo që vinim, harkun e mbaja me vete, e varja në sup. Natën, e vendosja te koka. Shikoja dhe ëndërra, sikur vrisja zoq me hark. Bile pashë edhe një ëndërr, ku i vrava unë me hark ato dallëndyshet, që, si ç'ju kam treguar, ranë nga telat e telefonit, kur ne udhëtonim me kalë në Fushën e Domosdovës. Ai i pari i qiraxhinjve, Hysa, më qortoi nëpër ëndërr e m'u zemërua fort se vrava dallëndyshet me hark. Unë isha kaq i mjerë që vrava dallëndyshet, sa qava nëpër gjumë dhe zgjova e tremba Hekuranin, i cili flinte pranë meje.

Kështu me atë hark. Lëre se ç'hark që ishte!

E ç't'ju them më për Veliçanin?

Një ditë, im atë vendosi të shkojë në Shën Marenë, një manastir majë maleve të Mokrës. Kishte qejf të shetisë im atë dhe të njohë vende të tjera. Ishte akoma i ri, as dyzet vjeç. Mua nuk më mirrte dot me vete, se udha qe shumë e vështirë, prandaj më la në Veliçan. Me gjithë atë, të zotët e shtëpisë, unë dhe Hekurani, e përcollën babanë gjer

te buza e Shkumbinit, një orë larg prej fshatit. Ua hypëm ca mushkave të forta dhe u nisëm.

Buzë Shkumbinit qe një mulli i madh, midis dardhave, nën një dushkajë. Aty lumi, pranë buri-meve të tij të Malit të Lenies, qe shumë i ngushtë e i rrëmbyer. Ujët i buçiste nëpër shkëmbenj të bardhë. Faqet e malit ngriheshin thikë nga të dy anët. Atje lart, qielli dukej edhe ai si një lumë i kaltëruar, po i qetë.

Babai u shplodh ca te mulliri, piu një ujë të ftohtë dhe një kafe, i hypi mushkës, kapërxeu lumin dhe mori faqen e malit përpjetë, bashkë me dy veli-çanakë, që e përcollën gjer në Shën Marenë.

Ne ndejtëm te mulliri gjer në të ngrysur të ditës.

E ku harrohet ajo ditë? U lamë me Hekuranin në ujët e ftohtë e gurgullues, mbloodhëm zaje të bukura, pamë si punonte mulliri, hëngrëm dhe një mish në hell. E poqi mullisi për miqtë. Po mbi të gjitha, nuk më harrohen troftat që zumë.

Shkumbini na qenke plot me trofta, koranë malesh, të bardhë si shkumba dhe me pika të kuqe e të zeza. Lëre ç'peshq të bukur pikëlorë që janë! Pastaj, — ç'të hash!

Babai i Hekuranit, një dy burra të tjerë dhe mullisi, zunë remën që sillte ujët nga lumi në mulli, dy-tre qind metra më tutje. Rema shteroi dhe mbetën troftat e shkreta pa ujë. Po sa trofta? Kush mund t'i numuronte? Mbushëm dy koshariqe dhe ngarkuam me to një mushkë.

Përpëlitej peshku i bukur nëpër remë, shkiste nëpër llucë dhe nëpër barishte, futej thellë e fshihëj nëpër vrimat e anëve ose nën gurët, sa ishte

zor ta kapje. Dhe, kur e kapje, të shkiste nëpër duar e të shpëtonte. Kishte trofta të mëdha sa krahu im dhe te tjera më të vogla se pëllëmba ime.

Po s'kishte vetëm trofta. Babai i Hekuranit, duke dashur të zërë një peshk nëpër barishtet e remës, zuri një gjarpër uji, që na trembi fort. E vërviti burri kaq me forcë dhe kaq lart gjarpërin, sa ky ra mbi ca gurë dhe nuk u pa sa copësh u bë.

S'kishte vetëm trofta e gjarpinj ajo remë, po edhe karavidhe të kuqe, të cilat më shtinin gjithashtu frikën. I vija në nishan ato karavidhe me harkun tim, po nuk i qëlloja dot. Shigjetat prej fieri qëllonin në llucë dhe lluca më cirkoste. Isha cirkosur kaq shumë me sa duket, sa i ati i Hekuranit qeshi me mua e tha:

— Po ti na qenke pikëluar si një troftë, mor bir!

Në Velican u kthym natën, me hënë. Dita e gjatë me lodhjen e saj, freskia e mbrëmjes, era e bimësisë dhe zilet e mushkave, m'i mbyllën sytë në prehër të babait të Hekuranit, mbi samar. Në shtëpi, më vunë në dyshek pa darkë. U erdhi keq të më zgjojnë.

Të nesërmen, u ngrita si zakonisht, me të lindur dielli. Dhe, si zakonisht, zgjata dorën të marr harkun që mbaja te koka, po harku s'ishte aty! E kisha harruar buzë Shkumbinit. Troftat më kishin bërë të harroj edhe harkun.

Më kot e kërkuam të nesërmen atë hark. Kush e di se cili e pat kismet. Mua, Hekurani më gdhëndi një tjetër edhe më të bukur.

NJË VARR NË TUSHEMISHT

Nga Mokra u kthyem në mbarim të korrikut. Zbritëm malet tatëpjetë dhe qëndruam edhe dy-tri ditë në Pogradec e në Tushemisht, përpara se të kthehemi në shtëpi, në Korçë.

Tushemishti është një fshat buzë liqenit, në kufi të Jugosllavisë. Aty ka qenë së pari mësues im atë, kur mbaroi shkollën.

Në atë fshat, babai kishte dhe një vëllamë, të cilin e quanin Gjokë. Ishin bërë vëllezër si qëmoti, duke prerë gishtat dhe duke pirë ca gjak të njëritjetrit.

Kur i vajti lajmi Gjokës se kishte zbritur vëllami në Pogradec, ai erdhi prej Tushemishti me një qerre që tërhiqnin dy qe të mëdhenj, — njëri bash, tjetri shegan. U përqaftua me mall të parrëfyer me tim atë dhe, pa vonuar, u nisëm për Tushemisht.

Ishte pasdreke. Dielli digjte. Koha filloi të freskohet me gjithë atë shpejt. Qerrja ecte ngadalë buzë liqenit. Një rrotë i shkonte në ujë, e dyta mbi ranishte. Liqeni ishte pak i dallgëzuar prej erës së lehtë që vinte nga Mali i Thatë përballë nesh. Shën Naumi, një manastir i madh në kufi, pasqyrohej me kambanaret e tij në ujrat gushëpëllumbi të liqenit. Shtëpitë e bardha të Tushemishtit dalloheshin mirë rrëzë një kraste të kuqe e thuaj se të xhveshur.

Gjoka ishte kaq i lumtur, sa harronte t'i ngasë qetë, po i linte të çapiteshin si të deshën. Ai nuk pushonte së foluri me tim atë dhe së fërkuari këmbën e faqet e mia.

Kush e mban mend se çfarë tregonte? Po nuk më harrohet fytyra e tij e mprehtë, e pjekur nga dielli, me gjembat gjysëm të kuqërremta e gjysëm të zeza të mjekrës së parruar. Të dy sytë e tij të picër nuk pushonin së lëvizuri e së shëndrituri në dy zgavra të thella shumë, të cilave u qëndronin si qepena një palë vetulla të trasha.

Mustaqe nuk mbante Gjoka. Më vonë, kam mësuar se ai kishte shetitur anët e dheut, kishte punuar në Amerikë dhe Argjentinë, Rumani dhe Australi. Nuk e di se si, po kishte parë edhe Japoninë atje në fund të Azisë. Kurbeteve i kishte lënë mustaqet Gjoka, — kështu thosh duke qeshur. . .

Në Tushemisht arritëm më të ngrysur.

Unë, me gjithë se i trullosur prej kolovitjeve të qerres, ecja trimosh, me harkun e Mokrës në sup dhe me një qese plot shigjeta fieri varur në qafë. Gjoka kërkonte të më mbajë për dore, po unë doja të shkoj në ballë.

Kalamanjtë e Tushemishtit, ku qenë e ku s'qenë, u grumbulluan rreth nesh, dhe kush të çuditej më parë dhe më shumë me atë hark të bukur druri, me të cilin unë mbahesha me të madh. Sigurisht, asnjëri prej tyre nuk e merrte dot me mend se ç'ish-te ajo si pushkë që varej te supi im. Të nesërmen, do t'ua tregoja se ç'ishte dhe ua tregova e i çudita dhe një herë të gjithë, aq bukur shtija dhe goditja tani me atë hark.

Po ç'e do, se nuk ishin aty edhe kalamanjtë e Pogradecit, ata që u tallën me mua gegën, kur zura gurneckën e parë. Atyre kisha se ç't'u tregoj tani, unë që kisha zënë dy koshariqe trofta në Shkumbin dhe që kisha qëlluar edhe karavidhet me hark, që kisha parë edhe babanë e Hekuranit të zërë një gjarpër të gjallë. Po në Pogradec ndejtëm shumë pak, vetëm disa orë.

Në Tushemisht, ndejtëm dy dit e dy net.

Ky Tushemishti, aty rrëzë krastës së kuqe, është çap e burim. Po çfarë burimesh? Gufon ujët nga rrëzat e malit dhe vija të panumurta kryqëzohen nëpër udhët e fshatit e nëpër oborret e shtëpive. Dhe s'ka shtëpi ku të mos dalë një burim. Me atë ujë njomin arat e kopështiet. Bën ky Tushemishti ca fasule e ca piperka, që janë të famëshme në tërë krahinën përreth e tutje e më tutje.

Im atë kishte mall të madh për burimet e Tushemishtit. Gjoka dhe ai tregonin se si, aty e njëzet vjet më parë, kur babai ishte mësues i fshatit, dimrit, nëpër vijat e Tushemishtit, ngjiteshin nga liqeni koranët dhe ata i kapnin natën në dritën e kandilit, duke i goditur me fushnji.

Unë, që tani isha peshkatar i vërtetë, që kisha zënë dy koshariqe trofta, i dëgjoja me vëmendje të madhe këto histori të koranëve, dhe e përfytyroja atë priftin e Tushemishtit, të cilit, thosh im atë, s'ia kalonte njeri për të goditur koranët me fushnji natën, dhe atë priftëreshën e tij, që i hidhte peshqit pothua se gjysmë të gjallë në tigan, pasi i qëronte shpejt e shpejt.

Kur u përmendën gjithë këto, Gjoka psherëtiu thellë, hoqi cigaren nga buza, nxori shapkën e nxirë dhe sytë iu mbushën me lot.

— E, mor vëlla! tha ai. — Më lëndohet zemra, kur i sjell ndër mend ato kohë. Kanë qenë vite të vështira, vërtet. Turku i flamosur na pinte gjakun. Po kjo ishte rinia jonë. A të kujtohet yt kushëri, ai ndjesë-pasti Petër? Qëkuri i ka mbirë bari përmbi varr!

Të tilla fjalë e marr me mend tani se thoshte Gjoka.

Psherëtiu dhe im atë e nduku mustaqet. Ndofta dhe atij ia njomi syun një lot.

Ç'ishte ai kushëri për të cilin flitnin? Ku ishte ai varr?

Të dy vëllamët po pinin ahëre nga një kupë raki përpara darke. Unë e humba vëmendjen shpejt dhe nisa të los përsëri me fëmijët e Gjokës.

Të nesërmen në mëngjes, Gjoka më mori prej dorë dhe ngjitëm një kodrinë, majë së cilës qe kisha e fshatit.

Babai ecte përpara. Bastuni i tij kërciste gurëve. Babai kishte një kapellë kashte, nga ato që në Korçë quheshin psatha: të sheshme lart e me një kordhelë të zezë përreth, katër gisht të gjerë.

Kishte një pallto të zezë dhe një palë pantallona bojë qumështi. Ecte me kujdes, gur më gur, që të mos gërvishtë këpucët e tij të bardha.

Kur dolëm majë kodrinës, pamë liqenin përpara nesh, të kaltërt, rrema-rrema në ngjyrë më të çelur. Frynte një fullim i lehtë nëpër rogovecka dhe bari i thatë kërciste nën këmbë.

Rreth e rrotull kishës, qenë varret e fshatit. Babai u end ca nëpër ato varre, me psathën në dorë. Ai qëndroi së fundi pranë një varri të madh. të mbuluar nga një gur i skalitur.

— Ja këtu është tretur i shkreti! tha Gjoka dhe nxori shapkën.

Ky ishte varri i Petrit. Babai im me t'anë e Petrit, qenë kushërinj të parë.

Këto që do të tregoj tani, i kam dëgjuar kaq herë prej gojës së Gjokës, ku jam edhe sot mik i shtëpisë.

Petri erdhi mësues në Tushemisht pas time eti, të cilin e dërguan në Elbasan. Ka qenë aty nga viti 1904. Ishte koha e sundimit të Turqisë. Shkollat shqipe nuk kishte, se gjuha jonë ndalohej nga turqit. Shqipen prindët tanë e mësonin ta këndojnë e ta shkruajnë fshehurazi. Ahere, kishte vetëm shkolla turke e shkolla të tjera të huaja në Shqipëri. Në Tushemisht, mësonin greqisht në shkollë. Atje, mësues i greqishtes ka qenë im atë, që edhe ai, nëpër shkolla greke kishte mësuar. Po kështu edhe Petri, kushëriu i ynë. Veçse ata, fshehurazi, u mësonin nga pak fëmijëve edhe shqipen. Dhe jo vetëm fëmijëve, po dhe të rriturve.

Kështu mësoi edhe Gjoka shqip.

Ky na paske qenë në fillim me grekun, sepse

kishte mësuar nëpër shkolla greke dhe i ishte mbushur mendja që, si i krishter, ai duhej të qe grek dhe jo shqiptar. Aq ia kishte prerë mendja Gjokës dhe këto punë të prapa bënte propaganda greke në vendin tonë. Mësuesit e fshatit, im atë dhe imi kushëri, Gjokën e bënë shqiptar të mirë.

Petri ishte djalë i pamartuar, as njëzet e pesë vjeç. Kishte qejf të shetisë malit e fushës. Shkonte për gjah në një kënetë aty pranë, Blata e Starovës, që është plot me rosa dhe pata të egra, plot kurilla e nositë (si ç'u thonë andej pelikanëve) dhe çfarë zogu të më duash. Edhe më shpesh, mësuesi gjuan-te peshk në liqen ose lahej me orë të tëra. Nuk lahej vetëm në verë po në çdo stinë, le të bënte dhe akull.

Një ditë prej ditësh, Petri mori një plevit të rëndë. Lëngoi një dy javë në Tushemisht pa mjek e pa ilaçe, se mjek e ilaçe nuk gjendeshin as në fshat, as në Pogradec. Kur nisi të bëhej shumë keq, e hypën në një gjemi dhe e dërguan në Ohër, ku kishte edhe mjek edhe ilaçe.

Po tani, Petri nuk kishte shpëtim. Pas një jave të tretë, ai e ndjeu veten fare keq dhe e kuptoi se do të vdiste. Kërkoi ahëre që ta kthejnë shpejt në Tushemisht, se atje donte t'i mbyllte sytë.

Më kujtohet shpesh Gjoka, kur tregonte se si e mori përsëri Petrin me gjemi dhe e solli në fshat.

Ishte natë, thosh ai, natë dimri pa hënë. Po ishte një natë e kthjellët. Qielli xhixhëllonte me tërë yjtë. Liqeni s'kishte asnjë valë. Ujëti ishte mavi i errët, si qielli. Ishte i frikshëm ujëti, si dhe qielli atë natë, tregonte Gjoka.

Petrit i kishin shtruar përmbi gjemi një dyshak të madh, të mbuluar me jorganë e belca. Atij i kishin vënë dy jastëkë të mëdhenj, që t'ia mbanin kokën lart dhe të mund të shihte. Dy fenerë i kishin vendosur te bashi i gjemisë, që t'u ndriçojnë udhën natën e të mos përplasen shkëmbenjtë, po edhe të përgjojnë të sëmurin se mos u vdesë pa parë.

Gjemia shkiste pa zhurmë mbi ujrat e murrëtyera. Dëgjoheshin vetëm goditjet e lehta të lopatave të gjemixhinjtë, që punonin me shumë kujdes, për të mos çqetësuar të sëmurin.

Mësuesi nuk i mbylli sytë gjithë udhës. Ai kish-te dy sy të zez e të mëdhenj, që tani i dukeshin edhe më të mëdhenj në fytyrën e thare petë. Nata ishte e ftohtë akull, po, kur e kur, mbi ballin e të sëmurit shkëlqenin bula djerse. Ky nuk ngopej së shikuari qiellin e yllëzuar, malet që diçka dalloheshin nga e majta, gjemixhinjtë që vozitnin pa fjalë.

Gjoka i rrinte të sëmurit te krei, me zemër të copëtuar. Petri i buzëqeshte herë pas here dhe me një zë të shuar, që firoste në mugëtirë, ia mirrte ndonjë kënge të tij të dashur, të cilën e priste pa e filluar mirë, se s'kishte fuqi.

Kur arritën pranë Shën Naumit, Petri e përmblodhi tërë fuqinë që i kishte mbetur dhe u ngrit e u ul mbi shtrat. Gjoka e mbajti. Në Shën Naum, në atë vend të rrallë për bukuri, mësuesi e kishte zakon të vijë e të shetisë katër-pesë herë javën. Shën Naumi dhe Tushemishti nuk janë më shumë se një çerek ore larg njëri-tjetrit dhe ahëre këtu nuk kishte kufi: të gjitha viset ishin pushtuar nga turqit.

Gjersa nuk u zhduk Shën Naumi prapa krastës, Petri nuk u shtri. Kur u zhduk ai vend i bukur, mësuesi ra në shtrat i kapitur fare, ktheu kokën nga Tushemishti, vështroi andej gjatë dhe mbylli sytë. Mbylli sytë dhe ashtu u shua dhe pushoi së jetuari, midis Shën Naumit dhe Tushemishtit. As Gjoka, as gjemixhinjtë nuk e kuptuan kur dha frymën.

Gjoka tregonte se, tërë atë natë, yj të panurmurtë shkëputeshin nëpër qiell, sikur të deshën të përcillnin mësuesin e mirë që po shkëputej edhe ai nga jeta...

Më kujtohet si tani im atë i ngashëryer dhe Gjoka pranë tij edhe më i ngashëryer, mbi varr të Petrit. Isha fort i vogël, gjashtë vjeç, po ndjeja dhe unë dhimbje, kur shihja se vuanin ata.

Me gjithë atë, unë u harrova aty për aty. Më tërhoqi vëmendjen një karkalec i madh, që nisi të këcejë nëpër varre, dhe ngava pas karkalecit.

Tregim i pestë

R O G E Ç Ë T

Ky ishte viti i dytë që ne banonim në Korçë. Po kalonte dimri dhe po vinin rogeçët.

Rogeçë në Korçë u thonë karnavaleve. Në Elbasan, u kanë thënë surreta. Në Elbasan surretat i bënin natën, kurse në Korçë rogeçët i bënin ditën.

Atë natë, nëna ime lidhte një vezë të zier majë një peri dhe më bënte mua dhe babait «ham», kush ta kafshojë i pari. Nuk do mend se tërë vezët që bënim «ham» për surreta, i kisha kafshuar i pari unë dhe i kisha ngrënë unë. Babai nuk ishte i zoti, me gjithë gojën e madhe që kish...

Rogeçët po afroheshin.

Korça e tërë, me të mëdhenj e me të vegjël, shtëpi më shtëpi, po bëhej gati në të fshehtë. Thoshin se, një palë djem të rritur, do të ngrinin asaj

nate rogeçësh një ballonë të madhe sa kambanaret e kishës së Shën Gjergjit.

Sa qejf!

Në Korçë. rogeçët bëheshin gjithëfarësh. Dilnin si krushq me gomar e me nuse, dilnin lakuriq si njerëz të kuq me pupla; kishte kryemëdhenj, qafështrembër, etj, etj.

Rogeçët po afroheshin dhe deshëm të bëhemi gati edhe ne më të vegjëlit.

Shokët u përpoqën të më mbushin mendjen dhe të më veshin nuse, që të hypja mbi gomar dhe ata të dilnin krushq me fustanella e me daulle. Po unë nuk dëgjova. Nuk desha të dal si nuse. Ahere, shokët, nga inati se nuk i dëgjova, ma ngjitën emrin nuse. Nuse-nuse, nuse-nuse, më thërritnin të gjithë. Gjer atë ditë, si ç'ju kam treguar, ata më thërritnin gegë dhe unë nuk zemërohesha, se gegë isha. Kur më thanë nuse, nuk i durova. U zura keq me ta.

Rogeçët po afroheshin.

Po shokët ishin ndarë prej meje dhe askush nuk donte të dalë me mua. Mbeta vetëm dhe qaja e grindëshë në shtëpi, se nuk do të dilja rogeç. Po ç'të bënte nëna me babanë?

— Bëhu rogeç vetëm, bir i nënës, më thotë një ditë im më. — Për inat të shokëve!

Ku dilej rogeç vetëm?

— Dalin plot, t'u bëftë nëna. Ma ka thënë Spirovica mua. Ec e pyesim Spirovicën bashkë.

Spirovica ishte fqinja jonë. Unë grindëshë dhe nuk doja ta pyes Spirovicën.

Po dita e rogeçëve afrohej dhe unë po pëlçisja se nuk do të dal rogeç.

Më në fund, desha, s'desha, vendosa të dal vetëm.

— Për inat të shokëve! thashë.

Po si të vishem? Si të vishem?

— Do bëhem njeri i kuq me pupla, gollomesh, thashë.

Veçse, ku më linte nëna me babanë që të bëhem njeri i kuq me pupla dhe të dal lakuriq, të marr ndonjë plevit.

— Larg qoftë! tha nëna.

Unë qava, se doja të dal si njeri i kuq me pupla, gollomesh, po nuk dëgjoji as nëna, as babai.

Dhe dita e rogeçëve po afrohej!

— Do bëhem godaleshas! thashë unë. — Do ngjesh një brez të kuq, do vesh pendebrekë të zeza dhe jakuce të zezë me xhufka, xhamadan dhe opin-ga lope, do vë qeleshe të bardhë. Të çuditet Korça kur të dal!

Po ku t'i gjeja rrobet? Katundi i Godaleshit ishte tri dit larg, në Elbasan. Si nuk iu kujtua me kohë babait t'i shkruante një letër mikut të tij, Xhemës, në Godalesh, që të na çonte një palë rrobe? Si i bëhej hallit?

Qava dhe qava, se nuk mund të bëhesha godaleshas, po më kot.

Dhe dita e rogeçëve po afrohej!

Si të bëj? Si të vishem?

Nëna më thotë:

— Dëgjo nënën, ti bir, bëhu nuse. Të vesh nëna me çitjanë me lule, me këmishë me gjymysh. Të bën nëna bishta e ta lidh kryet me shami të

mëndafshhtë. Të lyen nëna me pudër e të vë të kuq.
Të bën nëna si nuse, si kukull. Të çuditet e gjithë
Korça kur të dalësh, aq të bukur të bën!

Unë u zura edhe me nënën, se nuk doja të bë-
hem nuse, që të tallen pastaj shokët me mua. Tri
dit me radhë, nuk dola nga shtëpia, prej inatit.
Lëre se ç'inat të keq që kam pasur ahëre! Nuk de-
sha t'ia di as për shkollën.

Po rogeçët ishin te dera: edhe tri dit donin!

Nëna tha:

— Po bëhu prift, mor të keqen!

Unë «oni-oni» e kisha lehtë të bëj dhe kryq
dija. Pse të mos bëhesha prift?

— Mirë e ke ti, nëne, do bëhem prift! Për
inat të shokëve!

Shpejt, babai vajti e solli nga pazari një tufë
letra gjithëfarë ngjyrash. Nëna shpejt i preu dhe
i qepi një palë rrobe prifti për bukuri.

Kur i veshja unë ato rrobe, nuk njihesha se
nuk isha prift. Bëra «oni-oni», bëra kryq dhe,
me babanë e nënën, qeshëm sa u shqyem. Çfarë ro-
geçi!

Po, si qeshëm dhe lojtëm mirë, unë thashë:

— Pse të mos bëhem dhespot, moj nëne?

— Po do dhe mitër, të keqen nëna! Do dhe
patericë me dorezë gjarpëri. Mirë je prift.

— I bën ato, ti nëne, i bën!

— Je mirë, kurban nëna! Ç'e do dhespotin?

— Dua të bëhem dhespot! ngula këmbë unë.
— Dua!

Shpejt, babai shkoi e bleu karton dhe nëna
sajoi shpejt një mitër me të gjitha ngjyrat. Mori

dhe bastunin e babait, e veshi me letra dhe na doli një patericë e vërtetë me dorezë gjarpëri.

Unë u vasha, vura mitrën në kokë dhe mora patericën në dorë. Çfarë dhespoti!

— Tani u bëra rogeç, tani! thirra prej gëzimit.

— Të pëlcasin shokët, të pëlcasin!

— Se mos të prishet mendja e kërkon të na bëhesh patrik! tha babai e ia krisëm gazit.

Gjersa erdhi e diela e rogeçëve, unë po me një hall rrija: si do ta mbaj mitrën, si patericën, si do t'i bëj gishtat e dorës kur të bekoj, si do ta përdredh zërin kur të këndo.

— Paqe më ju të gjithë! thoshte dhespoti i vogël, duke bekuar nënë e babanë.

— Urtësi, ju të drejtë! thoshte babai si prift.

— Të paqim uratën, shenjtëri! thoshte nëna, më puthte gishtat e dorës dhe tronditej shtëpia prej gazit tonë.

E diela e rogeçëve, më në fund, arriti!

Me natë, filluan të dëgjohen daullet. Të parët fare dolën ata me nusë lart në gomart, me fustanella. Pastaj, me radhë, dolën fustanella të tjera, mbërthyer me jataganë dhe me kobure të vjetra, me qostekë të mëdhenj varur mbi xhamadanë të bardhë me gajtana të zeza, me shami të zeza lidhur mbi krye, me tirq të bardhë e opinga me xhufka. Dhe dolën pashallarët e bejlerët, me fesa të kuq me pubza të zeza, që u hapeshin mbi supe, me nishane dhe këllëç. Dolën njerzit e kuq me pupla, lakuriq në mes të atij dimri. Dolën kryemëdhenjtë, dolën qafështremberit, dolën plakat shtriga. Dolën njerzit e lartë sa shtëpitë, me çibuqe të gjata një pash. Dolën zonjat dhe zotërinjtë, me

rrrobe të bardha vere e me psatha mbi krye, rrokur allabraca.

E çfarë nuk dolën?

Të gjithë kapërxyen përpara shtëpisë sonë dhe zbritën andej nga udhët e mëdha të qytetit. Shumë prej tyre shtrinin dorën e thoshin «jepi-jepi» dhe njerzit i darovitnin me ndonjë kacidhe.

Rruga jonë u mbush me njerëz. Edhe ata që nuk ishin veshur rogeç, me burra, me gra, me fëmijë, e kishin vënë ndonjë fes karte, ndonjë hundë të gjatë apo ndonjë maskë, që u fshinte sytë. Dhe rruga u shtrua me kufeta, — disa çikla të vogla karte shumëgjyreshe, që i hidhnin njerzit shoqi-shoqit.

Unë i shihja që nga dritarja, i veshur si dhespot, po pa mitër mbi krye. Tani, që isha bërë tamam rogeç dhe dita kishte ardhur dhe rrugët ishin mbushur me çfarë rogeçi të më doje, tani unë kisha turp të dal në rrugë, me gjithë se po pëlçisja të dal! Bile kisha turp të nxjerr dhe kokën si rogeç, me mitër, në dritare.

Po, kur u afrua dreka, asnjeri nuk lojti më nga rruga jonë, as rogeçë, as të tjerë. Bota kishin shkuar nga rrugët e sheshet e qendrës së qytetit. Andej ishte qejf i madh.

Kur pashë se rruga ishte bosh, vura mitrën, mora patericën, zbrita shpejt poshtë dhe nxora kokën te dera.

Në rrugë, asnjeri. Ngadalë, dola. Robet e kartës ia bënë kërr-kërr.

Nga të shkoja? Të nisesha dhe unë nga kishin vajtur të gjithë, apo të dilja te fusha e shkollës, që ishte aty pranë?

Eca pak, si me drojtje, i menduar. Kur, një turmë burra dhe gra, me fesa karte, me hunda të gjata dhe maska të vogla, tërë kufeta nëpër rroba e flokë mbushën krein e rrugës.

Shpejt, desha të hyj në shtëpi, po nuk munda të çel derën. Ngriva në këmbë, spec i kuq nga turpi, me mitrën në kokë dhe patericën në dorë.

—U, dhespotka! tha një grua dhe m'u avit.

— Sa i bukuri qenka! tha një tjetër grua.

— Po ky djalë është yll, me! tha një e tretë dhe më puthi faqen.

Burra e gra e vunë dhespotkën në mes dhe nisën të lozin me të.

Një burrë tha:

— Ky nuk qenka rogeç si të tjerët, s'ditkërka të bëjë «jepi-jepi».

Një tjetër burrë më hoqi mitrën dhe, duke thënë ai «jepi-jepi», hodhi dy kacidhe brenda. Të gjithë sa ishin, me burra, me gra, hodhën kacidhe. Mitra u mbush me kacidhe e, ashtu plot, ma kthyen mbi kokë, duke u shkukur së qeshuri. Pastaj, gratë më puthën faqet me radhë.

Një burrë u tall:

— Dhespotit i puthin dorën, me budallaçka! dhe qeshën edhe më shumë.

Një tjetër burrë u tall:

— I thuaj mamasë, të paçim uratën, të të bëjë edhe një mjekër. Nuk shkon dhespoti pa mjekër.

E të gjithë ikën me gaz të madh.

Ah! moj nëne, që harrove të më bësh mjekër!

Unë hapa derën, hyra në shtëpi dhe e flaka mitrën në oborr. Kacidhët u përndanë nga të katër anët. As që u ula t'i mbledh, po vajta dhe ra-

shë mbi shtrat, ku ia plasa vajit me dënësë, duke grisur rrobet e bukura të kartës.

Babai me nënën, kishin qeshur dhe ata sa deshën.

Nëna më mori në krahë duke thënë:

— Paska dhe djali ynë turp!

Babai deshi të më ngacmojë:

— Ku di ky se ç'janë rogeçët. Ja unë, s'kam turp. Kam borxh të dal me mitër në kokë dhe të vete ku të duash.

Unë u ngrita menjëherë në këmbë, fshiva lotët e ia pata:

— E vë me bast?

— E vë, m'u kthye babai.

— Me dy korona?

— Me dy korona.

Shpejt, zbrita poshtë dhe mblodha kacidhet, të cilat bënë më shumë se dy korona. Paret i mbajti nëna, që preu bastin.

Si u lava dhe u ndërrova, dolëm të tre të shohim rogeçët andej nga kisha e Shën Gjergjit.

Babai vuri mitrën mbi krye dhe s'kishte turp aspak, po ecte në mes të udhës, duke më mbajtur prej dore, me gjithë nënën që qeshte.

Si bëmë një copë udhë, mua më erdhi turp për të, se e shihnin bota buzagaz, e i thashë:

— Hiqe mitrën, baba, se është turp!

— Po bastin? ma pat ai.

— E fitove, mirë! thashë nga e keqja.

Nëna më pëshpëriti në vesh:

— Nuk ia ap paret unë! dhe qeshëm të dy.

Babai hoqi mitrën dhe e bëri palë nën sjetull.

Te një dyqan që gjetëm udhës, ai bleu një fes të kuq karte, një hundë të gjatë e të kuqe, një maskë të vogël me varak.

Fesin e vuri babai, hundën e vuri nëna, maskën e vura unë. Dhe të tre, zënë dorë për dorë, shkuaam të shohim rogeçët.

Ja kështu nuk u bëra vetëm unë rogeç atij moti në Korçë, po dhe nëna me babanë.

Në mbërëmjet, djemtë e rritur ngritën një balonë me drita, edhe më të madhe se kambanaret e kishës së Shën Gjergjit. Balona ra majë Malit të Mborjes dhe u dogj.

Sa qejf!

Asaj nate, nëna na bëri «ham» si ngamot mua dhe babait. Edhe këtë herë, unë e kafshova i pari vezën dhe unë e hëngra.

Tregim i gjashtë

NJE TAKIM ME AVNIUN

D uhet të ketë qenë mbarimi i vitit 1923 ose fillimi i vitit 1924. Muaji nuk më kujtohet, as dita. Po mbaj mend se bënte ciknë. Dëborë e ngrirë shkëlqente përmbi çatitë dhe drurët. Akulli kërciste nën këmbë.

Babai më kishte marrë me vete, nuk e di përse: ndofta për të bërë pazaret, ndofta se i isha qepur pas dhe nuk i ndahesha, si ç'e kisha disaherë zakon të keq.

Ne banonim ahërë në krye të qytetit. Zbritem rrugicat tatëpjetë dhe po i afrohem kishës së Shën Gjergjit. Aty përballë kishës, në mes të udhës, u ndal një burrë i ri, i futur i tëri në një bruc të zi që i zbriste gjer te këmbët, me një qylaf të bardhë e të gjatë mbi kokë. Ishte i shkurtër dhe bruci e tregonte si të rrumbullaktë. Po në fytyrë ishte i hajthëm.

Im atë nuk e vuri re, se shikonte më shumë kalldrëmin, që të mos shkasë. Mua më ra në sy menjëherë ky njeri i veshur ndryshe nga të tjerët, që ndaloi në mes të udhës e që na vështrote me buzë në gaz. Sytë e tij të përhirët shkëlqenin me një dritë të mprehtë.

I bëra shenjë me bërryl tim eti dhe i pëshpërita dy fjalë. Ky e diktoi atë tjetrin, që nuk lëvizi nga vendi, po nuk e njohu.

Ishim pothuajse dy çape përpara tij.

— Si, nuk po më njeh, zoti profesor? pyeti burri.

Im atë e njohu menjëherë atë zë. Fytyra i shëndriti prej gëzimit dhe, pa thënë akoma një fjalë, hapi krahët e u përqaftuan fort e fort.

— Po ti je, mor Avni? Po si shkon, mor Avni? Po si vete, mor trim i Shqipërisë?

I dëgjoj edhe tani këto fjalë, që bënë të më hidhet edhe mua zemra prej gëzimit.

Avni Rustemin, — se ai qe! — e njihte tani gjithë Shqipëria. Edhe pse nuk isha më shumë se tetë vjeç, kisha dëgjuar të flitet shpesh për të nga im atë dhe shokët e tij. Atë vit shkoja në të tretën fillore. Mësuesi na pat folur dy herë për Avniun, — dhe me çfarë krenarie!

Avni Rustemi kishte vrarë tradhëtarin e atdheut, Esad pashë Toptanin, pak vjet më parë. Ia kishte numuruar të shtata, mu në mes të Parisit, kryeqytetit të Francës, ku pashai bënte pazarllëqe në kurriz të Shqipërisë. Ishte çuditur bota me trimërinë e Avniut. Kjo trimëri e kishte bërë Avniun djalin më të dashur të popullit. Atë e njih- te tani i madh e i vogël.

Unë Esad Pashë Toptanin e shëmbëlleja me ndonjë bej tjetër që kisha parë. Një hundëmadh, me kokën sa një shinik, me një feste të kuqe, e cila ta kishte pubzën si topuz, një okë të rëndë. E merrja me mend të madh e barkledh, që, kur ishte gremisur nga plumbat e Avniut, ishte tundur dheu, si prej ndonjë arapi të përrallave.

Sa për Avniun, atë e shëmbëlleja me një djalë shtat hedhur e levend, me dy sy të zez që shkrepëtinin, me krahërorin të gjerë, që, kur gufonte, e bënte burrin të tmershëm.

Nga gjithë këto, Avniu kishte vetëm sytë, edhe pse nuk i kishte të zez. Ai, i bukur nuk ishte, po mjaft i hijshëm. Hijeshi të veçantë nuk i jep vetëm syu, po edhe zëri, se zëri e zbukuron vërtet njeriun. Kish një zë të fortë, pak si të trashë. Fliste shpejt dhe fjalët e tij nguliteshin si gozhdë, dangdang.

Im atë kishte qenë mësues i Avniut në shkollën normale të Elbasanit, në kohën e Turqisë. Që ahëre, ai më s'e kishte parë. Djali u bë burrë dhe ndryshoi, aq sa im atë nuk e njohu menjëherë. Po zërin nuk ia kishte harruar.

Ata të dy u përqaftuan me mall e dashuri.

Unë qëndroja mënjanë, i emocionuar e me turp.

Sigurisht, zunë me gojë kujtimet e tyre të shkollës normale. Pastaj, im atë e përgëzoi për vrasjen e Esad Pashës dhe e pushtoi edhe një herë fort.

Avniu ishte i ngutur, se diku e prisnin. U ndanë, me premtimin që të na vijë në shtëpi për drekë a për darkë.

Nuk e di përse, po Avniu nuk e mbajti këtë premtim dhe më nuk e pashë. Ai qëndroi pak ahëre në Korçë dhe im atë foli shpesh për të në shtëpi. Bile më kujtohet një ditë, kur babai me një shok të vetin, që na kishte ardhur për vizitë, thanë se Avniu nuk bënte mirë që dilte pa roje. Toptanasit dhe njerzit e miqtë e tyre, mund ta vrisnin. Di se prefekti i Korçës i vuri Avniut një roje pas, ato dit që ndejti akoma në qytet.

Shkuan pak muaj dhe, një ditë prilli, erdhi lajmi i gjëmshëm: u vra Avniu! Zogu vuri njeri dhe vrau Avni Rustemin në Tiranë!

Avniun e qau i madh e i vogël. Humbja e tij qe një zi e rëndë për gjithë zemrat, edhe për ne fëmijët e njomë të shkollave. Mësuesit i dridhej buza kur na foli për vdekjen e Avniut. Ai na shih-te atë ditë me një vështrim të tillë, që sikur të kërkonte nga ne të bëheshim të gjithë Avninj.

DY ZORRËTHARË

Babanë ma transferuan përsëri më 1924. Këtë radhë, e dërguan në Elbasan. Kështu, ne u hypëm edhe një herë kuajve e u kthyem me mall të madh në qytetin e lindjes.

Qe një gëzim i veçantë për mua, që ta bëj sërish atë udhë me kalë.

Nuk më kujtohet mirë se me ç'karvan e bëmë udhën, po sigurisht me karvanin e Hysës, të cilin tani e kishim si mik të shtëpisë. Kur vinte në Korçë, ai nuk linte pa na vizituar e pa na sjellë lajme nga Elbasani. Një herë, më kujtohet, na pat sjellë edhe një teneqe të madhe me ullinj nga një kushëri,

Pashë përsëri Fushën e Domosdovës dhe m'u kujtuan me trishtim dallëndyshet. Pashë hanin e Qukësit, ku kaloheshin net të këndëshme, më shumë me përralla qiraxhinjsh, se sa me gjumë. Pashë

shkëmbenjtë e Xhyrës dhe burimet e akullta të atij fshati, që dalin tamam përmbi xhade.

Për ata shkëmbenj mësova ahere edhe një histori, historinë e atij xhyranakut që na u martua në Stamboll dhe iu lëvdua së shoqes, se Xhyra na qenke një qytet me nëntëdhjetë e nëntë minare. Turqisht i thonë:

Xhyra kasabası
doksan dokus minaresi.

Kur erdhi stambollesha në Xhyrë dhe bëri çudi se nuk pa as qytet as minare, po vetëm ndonjë shtëpi majë shkrepit, i shoqi i tregoi shkëmbenjtë e lartë të fshatit e i tha:

— Ja minaretë tona, hanëm.

Minare e mbi minare janë shkëmbenjtë e Xhyrës...

Dhe ç'e lartë ura e Kamarës, ai hark i hollë mbi Shkumbin! Frikë të madhe kam pasur kur kaluam mbi atë urë. Qiraxhiu më mbante prej krahu majë kalit, se, që ta dini ju, tani nuk më kishin futur më në arkë, po i kisha hypur kalit si një i madh. Isha nëntë vjeç plot tani.

Ja më në fund edhe Elbasani ynë, përmes minareve dhe selvive. Këtu po, këtu mund të bëhen edhe një qind minare ndofta, bashkë me kullën e sahatit...

Ishte qershor ose korrik. Bënte një vapë që nuk durohej. Ne ishim mësuar në vise të freskëta dhe ramë si në furrë. Babai, nga frika se mos sëmuremi, na dërgoi nj'a dy muaj te disa miq të tij, në Shelcan të Shpatit, një katund jo larg Elbasanit.

Shtëpia e miqve tanë kishte vetëm një kthinë, një odë të vjetër shumë, me dy dritare si dy vrima, majë një palë shkallësh të larta guri. Tavan nuk kishte, por trarë të trashë, të nxirë nga vitet dhe bloza, të shtrembër. Dyshemeja ishte gjithë të çara. Nën të, ishte ahuri, ku mbllaçitej tërë natën kau i vetëm i të zot të shtëpisë dhe tringëllinin zilet e tri dhive që ai kish.

Nuk tregohet varfëria e miqve tanë. Ishin një plak e një plakë. Kishin dy djem mbi të dyzetat e një djalë tridhjetë e sa vjeç, të gjithë të pamartuar. Në shpat, gratë i blinin, po me se të blinin grua miqtë tanë, Toçtë!

Në pleqëri të shkuar, Toçtë kishin bërë edhe një djalë të katërt, Nasin. Nasi ishte vërsniku im, po, krahas meje, ai dukej dy-tri vjeç më i vogël. Ishte i thatë e i rrëgjuar. Mezi kishte fuqi t'i kullotë ato tri dhitë e tij të zgjebosura.

I shkreti Nasi, më shumë hëngri te ne asaj vere, se në shtëpi të vet. Kishte turp të hajë në sofrë me ne, apo shtirej të kishte turp: merrte ç'ti jepte nëna ime dhe shkonte ta hajë në kasolle të vet. Ndofta e ndante me ndonjë të shtëpisë.

Përveç konakut që na lëshuan me qira, Toçtë kishin edhe dy kasolle. Në njëerën rrinin vetë, tjetrën ia lëshuan me qira një tregëtari të pasur elbasanas.

Ç'them i pasur: ai tregonin se ishte krymbur në flori. Pa, sikur ta shihje si vishej dhe të mos e dije se cili që, të vinte mëshirë për të: dukej më i varfër se Toçtë. Kishte një palë rrobe të arnuara një qind herë dhe hiqte zvarrë një palë nallane. Akoma më trokasim në vesh nallanet e tij. Në krye

mbante një qeleshe të zezë, të cilës dielli i kishte dhënë një si ngjyrë ndryshku të keq dhe djersa i kishte bërë një rreth tri gisht të zgjyrosur.

Mëngjes, drekë, darkë, dajë Lami, — si i thoshin tregëtarit, — hante te dera e kasolles një copë bukë misri të verdhë me një kokër qepë ose një shkrep djathi. Ky ishte ushqimi i tij. Dhe i shijonte fort. I qeshte fytyra kur kafshonte misërniken dhe i dukeshin disa dhëmbë të rrallë e të krymbur, si çaponj të zez:

Që brenda kasolles, dëgjohej një kollë e thatë. Ishte e shoqja e dajë Lamit. Për të kishte ardhur dajë Lami në Shelcan, se gruaja qe turberkuloze.

— E kam sjellë për hava, thosh dajë Lami.

Në të vërtetë, ai e kishte varrosur të gjallë të shkretën në një kasolle dhish.

Ajo kollej atje brenda, dajë Lami hante misërniken me qepë te praku, ne vleroseshim në dhomën tonë.

Unë tani i kuptoja mirë disa padrejtësi të jetës. E kisha marrë mëri keq atë koprac të ndyrë, me një turi të kuq derri, me dy sy të vegjël e dy buzë të trasha. Një herë e kisha goditur me gur që prapa një gardhi. Guri e qëlloi mu në mes të kurrizit dhe dajë Lami desh u përmbys pa frymë. Briti e shau, shau e briti, po nuk e mori vesh kush i ra...

Nuk më harrohet një ditë midis të tjerave.

Kishim dalë shetitje te një burim diçka larg shtëpisë. Atje hëngrëm edhe drekën. Erdhi mbrëmja dhe morëm udhën të kthehemi. Babai me nënën nuk ecnin dot si unë, sepse kishin dy të vegjë-

lit. Tani, familja jonë ishte shtuar: përveç motrës që kisha, u bëra edhe me një vëlla. Prindët ecnin pas mengadalë, unë shkoja përpara, mblihdhja lule, këputja ndonjë degë me thana, që kishin filluar të piquen, këceja gardh më gardh e kapërcyell më kapërcyell.

Në shtëpi, arrita i pari dhe u ngjita menjëherë lart, u ula në majë të shkallëve që të shlodhem.

Nasi kishte qenë i sëmurë atë ditë. Ai ishte shtrirë te dera e kasolles përjashta, përdhe, me kokën te praku. Kishte mbyllur sytë dhe po flinte. Këmisha e lerosur dhe felë e grimë, i qe hapur fare. Përmbi rrathët e brinjëve të tij, endeshin mizat. Këto endeshin edhe nëpër buzët dhe faqet e tij, dhe e zgjuan.

Nasi u zgjua me një rënkim. Pastaj e dëgjova që thirri t'ëmën:

— Nëno, moj!

— Ou, u përgjigj plaka nga brenda.

— Dua bukë, moj.

Nëna nuk foli, po, pas një çikë, u duk te praku.

Ishte një grua e vogël e vogël, më e zezë e më e thatë se qeprat e kasolles. Koka e saj e pakrehur do t'i përngjante një bashke prej leshi dhie, sikur plaka të mos i kishte lidhur flokët e rrallë e të thijnur me një rryp pëlhure, që mund të kishte qenë dikur i bardhë e që i rrinte si çallmë.

— Na, i zgjati ajo të birit një copë misërnike të verdhë çerjepi, dhe hyri prapë në kasolle.

Nasi rrotulloi disaherë bukën nëpër gishta dhe pastaj tha me zërin e tij të shuar:

— Po ku hahet kjo malukat buke thatë, moj nënë?

Plakëruqja nuk u ndje.

Edhe Nasi heshti. Ai provoi ta kafshonte bukën, provoi edhe ta përçapte, po e shihja se kishte zor.

— Nuk hahet thatë, moj nënë! rënkoj Nasi.

E ëma nuk u përgjigj. Në kasolle tringëlliti një tigan. Pastaj, herë pas here, dëgjova zërin e gërvishtur të Toçes që fliste me vete:

— Hë, posi! Hë, posi! Dy exheqe, posi!

Më në fund, ajo u duk te praku me një tigan të madh në dorë dhe ia vuri djalit përpara:

— Ha tani, tha e u fut përsëri në kasolle.

Nasit i shëndritën sytë. Ai u ngrit shpejt, qëndroi këmbëkryq dhe filloi të hajë bukën bajate, duke e ngjyer me dy lugë qull që avullonin në fund të tiganit.

Atë kohë, u duk te praku i kasolles tjetër dajë Lami, me copën e tij të zakonëshme të misërnikës dhe me qepën në dorë. Nisi edhe ai të hajë.

I dëgjoj si tani të dy që hanin, se u kërciste misërnikja nëpër dhëmbë.

Ahere, u kthye dhe nëna me babanë. Këtyre u erdhi shumë keq kur e panë Nasin në atë gjendje.

— Moj e shkretë! i foli nëna ime plakës së Toçit. — Po si nuk i ka dhënë një bulë qumësht këtij të sëmuri, që të njomë gurmazin?

Fshatarja uli kokën. Me qumështin e tri dhive, ajo duhej të bënte bulmetin e dimrit.

— E, moj nuse, u përgjigj së fundi shelcanakja. — Nuk i dalkan cakat dy exheqe. Të hajë caku dy exheqe? Hem bukë, hem qull?

Nasi i dëgjonte këto dhe buzëqeshte me kënaqësi. Qulli i kishte zbutur gurmazin dhe barkun.

Nëna ime nxori prej shportës së ushqimeve që kishte marrë me vete, një shishe, ku kishte tepruar pak qumësht. I mori pastaj Toçes nga dora një sopllake teneqeje, me të cilën ajo i kishte sjellë të birit ujë, derdhi ujët dhe shtiu qumështin.

Nasi e piu atë bulë qumësht si i dëshiruar.

E ëma e shihte me një si lloj gëzimi dhe çudie, duke tundur kokën e duke thënë:

— Të hajë caku tri exheqe! Bukë, qull, qumësht!

Te praku i kasolles tjetër, dajë Lami përtypte gjithëmonë misërniken dhe qepën e tij. Brenda asaj kasollje, dëgjohej kolla e thatë e të shoqes së tregëtarit.

Më kujtohet im atë që thosh:

— Ky ngordh pse s'ka, ai ngordh pse ka! Dy zorrëtharë!

Fundi i kësaj historie ka qenë kështu:

Nasi u çmend pas katër-pesë vjetësh. Të vëllezrit nuk u martuan dot asnjëri, po u plakën pa grua në shtëpi.

E shoqja e dajë Lamit nuk e ngrysi motin. Ai vetë jetoi edhe shumë vjet të tjera me misërnike dhe qepë, me një palë nallane dimër verë dhe po me atë kësulë.

Ja se çfarë kohërash kanë qenë.

CIKAT E CENIT

Në Elbasan, cika u thonë fëmijët dhive. Me këtë emër i quante dhitë e veta edhe një farë Ceni, në Shelcan.

E njohëm Cenin atyre pushimeve që kaluam në Shelcan më 1924. Nuk më kujtohet llagapi i tij dhe, pa dyshim, nuk duhet t'ia dinte njeri llagapin Cenit. Se Ceni ishte me të vërtetë një çeçit burrë.

S'mund ta harroj atë shkurtabiq të zi si cung zjarri, me dy sy që nuk të shikonin kurrë drejt, po humbisnin brigjeve e qiejve. Ia dëgjoj akoma zërin e mbytur, që i gurgullonte në krahërorin tepër të gjerë dhe të gufmuar. E dëgjoj akoma tungjatjelën që thosh majë buzëve, si me përdhunë, me një nënqeshje të çuditëshme, që ia shtrembëronte fytyrën gjithëmonë nga e majta.

Dimër verë, Ceni rronte me dhitë e tij brigjeve, i vetëm në botë. Qeveria, tregonin se nuk e njihte fare, nuk e kishte në asnjë teftër të saj. Kë-

shtu Ceni nuk paguante as xhelep, as të dhjetë, as vergji, as ndonjë taksë tjetër. Katundi vetë nuk e numuronte fare dhe nuk i kërkonte hesap për asgjë. Secili i thosh merabahun e tungjatjetën e vet, po vetëm kaq. Nuk e pyeste njeri se si rronte dhe se si rronte nuk e dinte njeri. Të gjithë e kujtonin të marrë ose, të pakën, teveqel. Askujt nuk i dhimbej për të dhe askush nuk e kishte mëri për ndonjë send. Kur e kemi njohur ne, Ceni ishte në praktik të pleqërisë.

Ceni kishte vetëm dhitë e veta për shokë, njëzet e sa krerë dhi, të gjitha shyta e lariska, bashkë me çjapin. Jo lariska bardhë e zi, po me tërë ngjyrat e përzjera si më bukur. Nuk më duket të kem parë në jetën time dhi më të bukura se të Cenit dhe aq të mbajtura mirë. Atyre dhive, jo vetëm unë, që isha fëmijë, po edhe prindët iu bënë merak.

Shkuam dhe e pamë kaq herë Cenin në Brengore, një vend i lartë, kufi midis Shelcanit e katundit të Llesharit. Atje i kulloste Ceni ciklat dhe aty pranë e kishte shtëpinë, midis një shkoze. U sollën e u përsollën babai e nëna që t'i blejnë një dhi. Po flitet me murin? Aq flitej dhe me Cenin. Për çdo fjalë, për çdo pyetje, Ceni nuk e hapte gojën. Ai përgjigjej me një «hë» nëpër dhëmbë, që i mailkuari e merrte vesh në fillim se ç'donte të thotë, — se po, se jo.

— A po na e shet një cikë, o Cen?

— Hë...

— Vetëm një, Cen, vetëm një. Cilën të duash.

— Hë...

— E mira të marrtë me këtë hë! Po çile, more, gojën! Folë!

— Hë, hë...

Me gjithë atë, po të flisje për tjetër gjë, Ceni qëllonte dhe të hynte në bisedë, sado rrallë. Babai im thosh se ai fjalën e kishte të pakë, po me vend. Ishte i rrahur në punët e Shpatit. Jetës i qëndronte larg, po, nga larg, ai vinte re çdo gjë.

Nëna çuditej:

— Ky i bekuar të çon në Shkumbin e të sjell pa ujë!

Asaj vere, ne patëm në mend të kalojmë vetëm dy muaj në Shelcan. Po cikat e Ceni na mbajtën edhe disa dit më shumë. Nëna u bë keq merak pas tyre:

— Aman, or Cen, shitma një cikë? Vetëm një!

— Hë...

Dhitë na miqësuan me Cenin.

Burri u bë më i çelur dhe më i shoqëruar me ne. Ai na tregoi se si nuk ishte vendës, po mokrar. T'anë dhe t'ëmën nuk e mbante mend fare dhe prej Mokrës nuk i kishte mbetur asnjë kujtim. E kish-te rritur një e emta prej Lleshari. Po e emta na qe me një dërrasë metë, si thoshin, dhe, sa më vinte, edhe më shumë marrosej. Cenin e rrihte për asgjë, e rrihte keq, me gjithë që ky thosh se ajo e donte si sytë e ballit. Tufën me dhi, e emta ia kish-te lënë, bashkë me dy pendë dhe në Lleshar. Ajo e kishte mësuar ta shkojë jetën brigjeve, qyqar i pamartuar si dhe vetë plaka, që kush e di se si kishte përfunduar nga Mokra në Lleshar.

Kur i vdiq e emta, Ceni më nuk i shkoi mbarë. Dhitë nisën t'i ngordhin. Kecat ia vidhnin llesharkët ose ia merrnin me zor, gjë që së emtës nuk ia kishin bërë dot sa qe gjallë. Një fqinj i tij e rrahu dy herë përpara burrave te xhamia,

kot e kot. Ceni nuk duroi më, po i ndërroi arat e veta me ato të një shoqi, të cilit i binte larg Bregorja. Aty në Bregore, Ceni bënte diçka bukën dhe siguronte bulmetin. Ai ishte i kënaqur në atë kënd të veçuar të Shpatit. Të pakën ashtu tregohej.

— Bereqaves, shelcanakët nuk më kanë rënë më afë, thosh.

Kështu na hapi barkun Ceni dhe tjetërkush nuk dinte më shumë se ne për të. U bëmë miq të ngushtë, të thuash, po jo kaq sa të na shiste një dhi.

Katundi tregonte se Cenin nuk e kishte parë njeri të shesë dhi. Dhitë plaka, ai i therrte dhe i bënte pastërma për dimër. Kecat i hante vetë stinave të tjera. Lëkurët i dërgonte në pazar, kur vinte e shiste djathë ose blinte krypë, më të rrallë. Kujdesej Ceni aq shumë për ato shyta, sa dhe i lante dhe i krihte, ai që vetë, ndofta nuk lahej kurrë e pale të krihej. Çdo dhi kishte emrin e saj e të gjitha e dëgjonin dhe e kuptonin, si oçiçe.

Aty më të ikur, nëna iu vardis edhe një herë Cenit për një dhi, po nuk ia mbushi dot mendjen. Ajo i dha me gjithë atë një kallëp sapun, se i vinte keq kur e shihte si qelbej nga të palarit. I dha edhe nj'a dy këmishë të vjetra të babait.

Ceni desh qau prej gëzimit. Kallëpin e sapunit e fërkonte e i merrte erë dhe nxirrte gjuhën e lëpinte buzët, sikur të ishte ndonjë gjë e ëmbël për t'u ngrënë. Nderin më të madh që mund t'i bëje një shpataraku, ishte që t'i japësh një kallëp sapun.

Nuk më harrohet vështrimi i Cenit atë kohë, se na shikoi sikur ne të ishim për të dhitë e brigjet. Na përcolli larg Bregores me aq ejvallah dhe

urime, sa nuk mund ta merrje me mend që të dilnin prej gojës së tij. Të nesërmen, kur po u hypnim kuajve, erdhi e na solli dy folëra, gjithëmonë po me atë vështrim të dashur dhe si të përlotur.

Iku dimri dhe hymë në prill.

Tani, cikat e Cenit kishte kohë që i harruam. Kur, një ditë pazari, një të shtunë, dikush trokiti te porta dhe, atë çast u dëgjua një më-ê në oborr. Ishte Ceni me një shytë të bukur që t'i mirrje kokën. Me turp e me shumë të vështirë, ai tregoi se na e sillte peshqesh. Kuptuam se e kishte marrë malli fort për miqtë e tij të vetëm që kishte përveç dhive, dhe se nënës sime nuk ia kishte harruar të mirën e vogël që i bëri. Nëna i dha me zor disa plaçka të vjetra dhe një kallëp sapun.

Atë mot, Ceni zbriti thuaj se shpesh në qytet, më shumë pa punë se me punë. Rrinte gjithë të shtunën pazarit dhe, kur ngrysej, në kohën që dhi-të ishin kthyer në shtëpi, Ceni trokiste te porta, futej brenda, shikonte shytën, kënaqej se e gjente mirë, lëvdonte me ndonjë fjalë bariun që na e kulloste, përkëdhelte kecin e bukur që dhia na kishte pjellë, falej e përfalej me ne njerzit e shtëpisë dhe mirrte udhën e Shelcanit.

Cika, që nuk e kishte harruar dhe që bënte edhe ajo gëzim të madh kur e shihte, duke i lëpirë dorën dhe duke kruar kokën pas tij, kur largohej Ceni, vërriste disaherë dhe pastaj nuk dëgjohej më, po lëpinte kecin e saj, tamam si një prind, që, për t'u ngushulluar nga një humbje e madhe ose për të qetuar një dhimbje që ka, nis e përkëdhel vogëlushin e vet.

R A K U

Nga tregimet e mëparëshme, unë mund të jem dukur si një djalë nga më të urtit, shenjt njeriu, si thonë. Po e vërteta e së vërtetës nuk ka qënë kështu. Kam pasur edhe unë çapkëllëqet e mia, për të cilat ndonjëherë edhe do t'ju flas.

Kur u ktheva prej Korçë në Elbasan, më kujtohet se e pata punën keq me shokët e mi të rinj. Fajin ma pat mburavecëria ime. Se, de more de, na kishte ardhur djali që nga larg dhe lëvdohej për atë qytet të bukur, në të cilin kishte jetuar katër vjet, dhe mbahej më të madh për viset e shumta që kishte njohur në udhëtimet e tij. Pastaj, kush si ai na kishte hypur në automobil? Cili kishte zënë dy koshariqe me trofta? Cili kishte qëlluar me hark? Cili ishte larë në një liqen sa një det?

Doemos, ky farë burri duhej të ishte dhe trim. Nisa t'u trimërohem kështu shokëve të rinj

të Elbasanit, se kisha çarë kaq koka, se kisha rrahur aq djem te fusha e Mitropolisë në Korçë, etj, etj.

Ndonjë trimëri të tillë edhe e kisha bërë. Nontën e sjelljes, në klasën e dytë fillore, a nuk e kisha pasur dysh, në vend të njëshit, që ishte ahëre nota më e mirë? Fajin ma pat një llastikë, me të cilën, duke shtënë në ca rabecka, godita tamam xhamin e mësuesit tim. Ky m'i hoqi kaq fort veshët të nesërmen në shkollë, sa më dhembin edhe sot.

Ata mësuesit e qëmotit nuk ia përtonin. Duhej të kishe veshë të fortë e duar edhe më të forta. Kur bënim ndonjë faj dhe mësuesi na godiste në duar me vizor, — ne i thoshim kanonkë, — sytë na lëshonin xixa dhe trupi na digjej nga mornicat. Një herë, një shokut tim, nga të keqtë, i pat shpëtuar edhe ujët e vogël, me nder jush.

Po ikën ato kohë.

Ikën, veçse kujtimet mbeten. Dhe ja që nuk më harrohet, se kam qenë ca i prapë edhe unë. Po, kur nisa t'u lëvdohem e t'u trimërohem shokëve të mi të rinj të Elbasanit, ata, në vend që të më nderojnë ose të më kenë frikë, u inatosën.

«Të jetë kaq trim sa thotë, ky tosku!» bënë ata çudi me vete, duke më vështruar kërcënueshëm nga lart poshtë dhe nga poshtë lart.

Sa isha në Korçë, më thërrisnin gegë dhe mua nuk më prishej qejfi, se gegë isha. Tani që u ktheva në vendlindje, më thërrisin toskë! Dhe jo toska, po tosku, me përçmim! Bile më thonë «tosku, marrosku!» Kjo nuk durohet!

— Kujt i thua toskë, more ti hundëkrymbur? ia pata njërit, që s'i kishte fshirë hundët ndofta që kur kishte lindur.

Ky dukej si më i vogli i të tjerëve, po edhe më xanxari.

— E di se të ha të gjallë! u mata t'i vërsulem unë e t'ia shtyp atë çikë hundë të krymbur që kish.

Atë çast, më rrethuan nj'a pesë a gjashtë shokë të tij, të tërë kokëqethur, këmishëgrisur, këmbëzbathur.

— Na mbahet tosku, se ka këpucë e rrobe të reja! E paska pashkë përditë tosku! tha njëri, përçmoi buzët dhe bëri një çap drejt meje.

— Ma lini mua, se ia ndreq unë samarin këtij, tha një tjetër, me një zë pothua se të trashë.

Ky nuk qe fëmijë si ne, po katër-pesë vjeç më i madh. Ishte një zgallo i gjatë, me kokën me qoshë, një kokë kuqalashë. Hundën me grep dhe mollzat me majë të faqeve, i kishte tërë verige. Kishte një palë pëllëmbë si putrat e ariut. Pantallonat e gjata mezi i kapërxein gjunjët dhe, atje poshtë, ishin cufla-cufla. I kishte lidhur me një tërkuzë të zezë.

Unë, aq kohë pata, sa t'i hedh një vështrim zgallos. E pashë veten shumë pisk. Hodha një sy prej lepuri të trembur përçark, lëshova kokën përpara, çava tufën e çiliminjve dhe ua mbatha me të katra.

Po një çap i zgallos ishte sa dy çape të miat. Më zuri, më hodhi poshtë, më dëndi.

Sa për rrobat e mia marinarçe dhe këpucët e bardha, më mirë mos pyesni. Ato u bënë për të mos veshur më.

Iku e vate trimëria ime. Treti si krypa në ujë.

Dy-tri dit, nuk e kapërxeva prakun e shtëpisë. Pastaj, nisa të dal, po me babanë ose me ndonjë

ƙushëri të madh. Pas një jave, arrita të pajtohem e të bëhem mik me atë zgallon: i dhashë nj'a katër a pesë detka, që kisha sjellë prej Korçe, — midis tyre edhe një detkë të madhe qelqi, prej shisheje gazozi, që m'u dhimbs fort. Po ç'të bëja?

Detkat nuk i njihnin në Elbasan dhe as lojën e detkave. Ato më miqësuan me tërë kalamanjtë e lagjes. Shpejt, unë u bëra dora e djathtë e atij më të fortit prej tyre, e atij zgallos, të cilit ia thoshin emrin Raku.

Raku qe katër-pesë vjeç më i madh se unë, po ishte në një klasë me mua, në të katrën fillore. Ishte i varfër tek më s'bëhet. Kishte vetëm nënën, e mbetur e ve që shumë vjet më parë. Ajo e rriste djalin duke punuar nëpër dyert e lagjes, duke larë robe.

Vetë Raku punonte dimër verë. Gjatë kohës së shkollës, ai mbushte ujë me pagesë. Pushimeve, hynte çirak ose, më mirë, shërbetor në dyqan të ndonjë këpucari, bënte për ustanë gjithë punët e vogla dhe pazaret, mësonte pak nga pak zanatin. Shkollën e donte dhe nuk i ndahej, po kush e di si mund t'ia sillte hera: më mirë të kish edhe një zanat.

Në fillim, Raku m'u duk si shumë rrugaçë të tjerë. Po, kur nisa ta njoh mirë, më doli ndryshe. U bëmë miq të ngushtë. Ndihtonim njëri-tjetrin në mësim dhe rrinim gjithmonë bashkë.

Raku ishte një nga nxënësit më të zot të shkollës. Më baj mend se nuk ia kalonte njeri për këndim, arithmetikë dhe bukurshkrim. Mësimet i shkruante kaq bukur, sa t'u bëheshe merak. Nuk i shkruante bukur vetëm sepse kështu i pëlqente, po dhe se fle-

toret ua shiste në vjeshtë nxënësve të pasur të klasës më të ulët.

Libra shkollore kishte shumë pak ahere dhe jo për çdo lëndë. Një pjesë të mirë të lëndëve, na i diktonte mësuesi në klasë dhe ne i shkruanim. Doemos që mësuesi kërkonte t'i shkruajmë bukur e t'i mbajmë pastër. Në këtë punë, Rakut s'ia kalonte ndofta as mësuesi vetë.

Raku i shiste fletoret e tij dhjetë-pesëmbëdhjetë korona të gjitha. Me këtë grusht koronash, ai mund të jetonte një muaj bashkë me t'ëmën.

Do të thotë ndokush se si mund të jetohet me aq pak të holla një muaj të tërë. Më mirë të më pyesni se si mund të jetojë njeriu duke ngrënë dy herë ditën një copë bukë dhe një lugë kos. Dhe çfarë kosi!

Më kujtohet se, kur blinte Raku kos, me një kusi të pakallaisur, dyqanxhiut i thoshte:

— Një grosh kos e dhjetë pare hirrë, o Rahman.

Ky vinte buzën më gaz, shtinte dy-tri lugë kos në kusitë, pastaj merrte një qepshe të madhe e ia mbushte Rakut enën me hirrë. Copat e kosit ngjiteshin lart dhe notonin, duke u mbytur ngadalë-ngadalë në hirrë dhe duke u tretur. Raku fuste dorën në një vrimë të pantallonave të tij përrallore, merrte aty groshin dhe ia hidhte kosaxhiut mbi tezgë.

— Dhjetë paret t'i kam borxh, ia bënte duke i shkelur syun, dhe dilnim.

Te praku, ai ndalonte e kthehej e pyeste:

— Sa pare të kam borxh, o Rahman?

Rahmani qeshte fort e thosh:

— Ik, more tartakut.

Me atë hirrë, të cilën ai e quante kos, ushqehj Raku me t'ëmën.

Po ai ushqehj edhe me erën e qylhanit.

Ju, sigurisht, nuk do ta besoni. Si është e mundur të ushqehet njeriu me erën e furrës, — se qylhan i thonë derës së vogël të furrës nga futen bukët, tavat e lakrorët. Po kjo qe e vërtetë. E kish-te bërë im atë, i cili, në femini të tij, kishte qenë edhe ai shumë i varfër.

Shkon njeriu në furrë, blen bukë dhe e ha bukën thatë pranë qylhanit. E përcjell bukën me erën e qylhanit dhe i duket se kjo erë e ngop. Ashtu si ngopen gjellëbërsit me erën e gjellëve që gatujnë dhe nuk i hanë. Këtë marifet e dinte dhe Raku dhe e bënte disaherë.

Kështu rronte Raku, kështu e çonte jetën, — z bathur e xhveshur, me barkun bosh, shërbetor në shtëpi të botës, duke shitur edhe fletoret e mësimëve...

Më kujtohet se një viti na ngjau një fatkeqësi e madhe.

Losnim furrash në baçe të një shoku. Kishim ndërtuar në kënd të baçes, rrëzë murit të vjetër prej qerpiçi, një furrë të vogël, po një furrë të vërtetë.

— S'ka si zanati i furrëxhiut, thoshte Raku. — Të pakën pa bukë nuk të lë, me gjithë se një çirak simitçiu thonë se ngordhi motit për një simite dhe s'e hëngri dot, kaq usta katil kishte pasur. Po ai ka qenë budalla.

Kishim ndërtuar një furrë dhe piquim aty bukë të vërteta. Miellin e sillja unë nga shtëpia dhe

e gatuaja unë me shokun tjetër. Rremën. Bukët i piqte Raku, i cili ishte ustai ynë. I piqte në disa kapakë teneqeje, prej kutiash boje për këpucë. Pjesën më të madhe të bukëve, domosdo i hante vetë. Dhe kjo kështu i vinte mirë, se ku ngopej ndonjëherë me bukë Raku në shtëpi të vetë?

Veçse ajo lojë na kushtoi fort.

Një ditë, të tre sa ishim, i harruam fletoret e librat përmbi furrë dhe, sa të piqeshin bukët, ne iu ngjitëm një mani që kishte filluar të ëmbëlsohet në baçe të Rremës. Gjatë asaj kohe, çatia e furrës batisi, bukët u frugulluan dhe, bashkë me to, u shkumbëzuan edhe fletoret e librat tona!

Ka qenë e para herë që e kam parë Rakun të mbushë sytë me lot. Kurrë s'e kisha parë të qajë. Iku mundimi i tërë vitit! Ikën koronat që do të merrte për fletoret në vjeshtë! Pa ishim edhe në mbarim të vitit, as dy javë përpara provimeve! Kush e di se ç'do të na bënte Dhaskal Dhanili të nesërmen në shkollë! Apo nuk na e kishte tërhequr më se një herë vërejtjen Dhaskali për atë furrë, që na humbte kohën, si thosh ai. Dhaskali e kishte shtëpinë tamam përballë Rremës dhe na shihte.

Të nesërmen, ai na bëri hi e njeri, po për të rrahur nuk na rrahu, edhe pse dorën e kishte më të gjatë e më të rëndë nga gjithë mësuesit e tjerë, ndofta sepse ishte drejtor i shkollës.

Ishte një burrë i shkurtër, fort i zi, krejt i thinjur, me ca leshra të qethura shumë shkurt. Dukej sikur ta kishte lyer kokën me bojë të bardhë. Kishte dy sy të vegjël kaq të ndritshëm, sa, kur të vështronte me inat, të dukej se po të përçëllon.

Na përcëlloi me ata dy sy Dhaskal Dhanili, po për të rrahur nuk na rrahu. Rrihej gjithë ai Rak?

E vërteta është se Dhaskali e donte fort Rakun. Ai vërtet na rrëzoi nga një notë në sjelljet, po na solli fletoret e veta prej shtëpie e me to dhamë provimet e vitit.

Raku më tregoi më vonë, se, asaj vjeshte, Dhaskali i kishte dhënë edhe njëzet korona...

Raku ia arriti qëllimit: ai mbaroi shkollën e mesme dhe u bë mësues. U martua dhe pat fëmijë. Nisi të njohë, si thosh, një fije lumtëri. Po erdhën kohë edhe më të vështira. Shqipërinë e rrëmbyen fashistët italianë, krisi pastaj lufta, erdhën më në fund edhe nazistët. Këta e kapën një ditë Rakun, e dërguan në një kamp çfarosje në Gjermani dhe, së andejmi, Raku nuk u kthye më... Fëmijët e tij u rritën jetimë. Po për ta pushteti i popullit e bëri jetën të sigurtë.

Tregim i dhjetë

G A R G U J T

Po, kam qenë dhe unë i prapë ndonjëherë, dhe shumë i prapë. Ja se si jam sjellë një moti me dy garguj.

Gargujt janë ca zoq të bukur, shumë më të mëdhenj se dallëndyshet, thua më të mëdhenj edhe se mullenjat. Emrin ua thonë edhe bregcë, babilë ose brojcë.

Në pendët e tyre, janë përzjerë gati gjithë ngjyrat e ylberit, edhe pse në të pamë të parë duken krejt të gjelbër. Dhe ndritin ato ngjyra të përzjera dhe ai i gjelbër i thellë. sikur zogu të mos qe veshur me pendë, po me mijra dhe miliona xhixha të vogla.

Për të kënduar, gargulli nuk di të këndojë. Ai lëshon disa si klithma. E me që gargujt e kanë zakon të rrinë shpesh bashkë, ata bëjnë kështu një

potere të vërtetë, që i ngjet diçka poteres së zgalemëve buzë liqeneve dhe deteve. Po gargulli nuk është zog uji si zgalemi. Ai nuk ushqehet me peshk. Ai është një zog toke, që ushqehet me miza dhe krymba dhe që mbron bimësinë. Si armik i bletëve, ai bën dëm.

Kur vinte pranvera, shumë fëmijë të lagjes u binin më qafë gargujve.

Këta i bëjnë çerdhet në tokë. Gërmojnë një vrimë të gjatë dhe, në fund të asaj vrime, hapin një si odë të gjerë, ku vendosin vezët dhe çelin zoqtë. Ndonjëherë, ato vrima janë galeri të vërteta nëntokëse, me disa të kthyer, si galeritë e minierave.

Nuk ishte një punë e vështirë për t'i diktuar çerdhet e gargujve. Mjafton të kërkoje buzën e ndonjë përroi ose hendeku dhe të përgjoje. Gargulli vinte, qëndronte pranë vrimës së çerdhes së tij, vështronte nga të katër anët me kujdes, se mos po e pikasin, dhe futej brenda. Ndonjëherë, që atje brenda, dëgjohej një koncert cicërimash.

Nuk ishte gjithashtu e vështirë ta kapje gargullin. Për këtë punë, kishte dy mënyra.

Më interesantja ishte kjo: të vije një pasqyrë te vrima e çerdhes. Që brenda, kur shihte veten në pasqyrë, gargulli pandehte se mos po vjen ndonjë gargull tjetër që t'i zërë folenë dhe sulej me inat të kacafytet me të. Po, një të nxjerrë kokën, — kap ti e kapje! Ai përpëlitej ahëre më kot dhe më kot kanosej me sqepin e tij të fortë.

Mënyra tjetër për të zënë gargujt, ishte të vulosje vrimën e çerdhes e ta hapje këtë me sqepar ose me ndonjë vegël tjetër, nga lart. Po kështu

edhe mund ta vrisje pa dashur zogun, duke 'goditur tokën.

Ç'i bënim ne ata zoq që zinim? Vetëm sa losnim me ta nëpër duar e i ngordhnim kot së koti. Gargulli edhe nuk hahet. Kishim qejf t'i zëmë dhe puna nuk ishte pa rrezik. Jo vetëm që humbisnim ndonjë ditë mësim, po më kujtohet një herë se, në një vrimë, kur vumë pasqyrën, në vend që të na dalë një gargull, na doli një gjarpër i madh që na llahtarisi. . .

Një herë, unë zura jo një, po dy garguj, femër e mashkull, bashkë me katër vezë të tyre, ca vezë si të pëllumbit. Ishte një fitore e madhe. Askush nuk pat shënuar një fitore të tillë në historinë e gjahtarëve të gargujve.

Në shtëpi, kishim një kafaz të vjetër. Unë e shtrova kafazin me bar, vendosa aty vezët si në një furik dhe futa çiftin brenda.

Zoqtë u vërtitën disaherë si të hutuar nëpër kafaz, nisën të lëshojnë klithma inati dhe pastaj të qukitin me zemërim telat e drurët e kafazit, gjersa përgjakën sqepët. Si u lodhën kështu së luftuari me burgun e tyre, u shtrinë dëshpërueshëm përkrah njëri-tjetrit, pranë vezëve, të cilat i shikonin dhe i shikonin, sikur të deshën t'u thonë me sytë e habitur e të zemëruar:

— S'na duheni gjë! Çdo gjë paska mbaruar për ne!

Dhe, si u shplodhën pak, sikur ta kishin bërë me fjalë, u ngritën të dy menjëherë dhe i copëtuan si të marrosur vezët e tyre. Kafazi u përlye e u bë tërë të verdhë veze dhe u përlyen edhe zoqtë e bukur.

Mua më vinte keq për ta, po nuk doja t'i lëshoj. Mezi i kisha zënë. Kur copëtuan vezët, gati m'u mbush mendja t'u hap derën e kafazit. Po isha zemërgur. Nuk i lëshova.

Thashë me vete se do të mësohen. Thashë se do t'i kishte marrë uria, prandaj dhe çanë vezët. Nisi bile të më vijë dhe inat për ta se i çanë vezët. A s'gjenden kafshë të liga që hanë këlysh të tyre? Ne kemi pasur në shtëpi një mace të tillë.

Shkova e vrava miza dhe gjeta karrema për zogjtë dhe ua solla. Po ata as që e kthyen kokën t'i shikojnë dhe t'i hanë. Kishin qenë inatçinj të mëdhenj. Më zuri inati keq edhe mua.

— E po dhe unë nuk do rri tërë ditën me ju! Po nuk hëngrët, ngordhni! u thashë dhe dola, i sigurt se gargujve do t'u apë mend uria.

Po zoqtë kishin qenë edhe më inatçinj se ç'e pandeha unë. Ata nuk i prekën mizat e karremat as të nesërmen, as të pasnesërmen.

Në krye të tri ditëve, mezi qëndronin në këmbë, nga të pangrënët dhe nga lufta që vazhdonin të bëjnë me kafazin. Po unë zemërguri e shihja luf-tën e tyre të dëshpëruar, dhe nuk i lëshoja. Inat për inat, unë doja t'i detyroj që, ja të mësohen në kafaz, ja të ngordhin. I tillë zemërgur u bëra!

Në krye të katër ditëve, gargujt i gjeta në mëngjez të shtrirë në kafaz, me syun përgjysmë të mbyllur, si në gjumë. Njëri zog hapi fletët, sikur të shtrigjej, po nuk u çua në këmbë. Kur i mbylli fletët, ana e tyre e djathtë mbuloi gargullin tjetër. Ndofta zogu që hapi fletët që mashkulli, i cili pandehte të mbrojë kështu femrën nga egërsia e

çunit të shkollës, që i kishte kapur zoqtë me të pa-
besë dhe i kishte futur në burg.

Po çuni i shkollës nuk e kishte ndjerë fajin që-
bëri. Ai nuk donte t'i lëshojë zoqtë, me të cilët u
lëvdohej gjithë shokëve të lagjes. Ai i la në kafaz
dhe mori udhën e shkollës.

Kur u kthye në drekë në shtëpi, gargujt i gje-
ti të ngordhur. Mizat ishin grumbulluar në fytyrat
e tyre të gjakosura. Macja e shtëpisë i përgjonte
në këndin e oborrit, ku ishte varur kafazi, me-
shpresë se i zoti do t'ia apë asaj zoqtë e bukur.
Lëngëzohej macja me kokën përperjetë.

Unë e ndjeva atë çast kaq fort fajin tim, sa
m'u përsëndye vetja. Po inatin ia shkarkova ma-
ces, që hëngri një shqelm dhe këceu dy metra tutje.

Gargujt i mora dhe i varrosa në një gropë të-
thellë që çela në oborrin e shtëpisë. Dhe, që ahëre,
nuk më kujtohet të kem zënë më zoq.

NJË NGJARJE E LLAHTARËSHME

Nuk duhet të kem qenë më shumë se dhjetë-njëmbëdhjetë vjeç ahëre.

Ishim duke ngrënë darkën në shtëpi të zjarrit, një nate maji me shi. Era vërshëllente nëpër hatulla, drurë e tela, si në shëndre. Babai nuk di cilin qërtonte, mua ose time motër, se po e zinte gjumi me lugën e përsheshit në gojë.

Kur, mbi tavanin e çardhakut, sa të kapërxesh prakun e shtëpisë së zjarrit, nisi një trokëllimë e çuditëshme: tok-tok-tok-tok-tok... Nisi e fortë, zgjati disa sekonda dhe u shua pak nga pak, gjersa heshti. Dora e njeriut nuk do të kishte trokëllitur më mirë.

Ne ngrimë të gjithë. Babai ishte bërë më i verdhë se dylli. Nëna po dridhej. Unë e ime motër, herë shikonim babanë, herë nënën, dhe llahtari na kishte mbërthyer nofullat.

Dëgjohej vetëm gërhimë e lehtë e vëllait të vogël në djepet dhe ndonjë dru ulliri që kërciste në vatër.

Babai vuri një gotë ujë te buza, piu, e mori pak veten e tha:

— Nuk është gjë. Hani, fëmijë.

Nëna, me sytë akoma të çakaritur, u përpoq të vërë buzën më gaz e mërmëriti:

— Do na kenë bërë veshët.

Atë çast, e njëjta trokëllimë, po më e fortë në fillim dhe shumë më e gjatë, e goditi tavanin te çardhaku.

Nëna lëshoi klithmën, na rrëmbeu ne fëmijëve në gjë dhe ra përmbys te këndi i vatrës. Babai këceu në këmbë, po qëndroi i ngrirë pranë nesh. Unë qaja me zë në gjë të nënës, ime motër qante edhe më fort se unë.

Kaluan disa minuta të tmerëshme lemerie, të përcjellura nga era që nisi të qajë edhe ajo nëpër hatulla dhe të vërshëllejë drurëve dhe telave.

Kur e shikoja babanë, fërgëlloja edhe më shumë nga frika. Në dritën e pakë të zjarrit dhe të një llambe mbi oxhak, mbi fytyrën e tij të hequr lëviznin gjithëfarë ngjyrash të verdha e mavie.

— Ç'të jetë? pyeste ai veten me një gjysmë zëri, që mezi i dilte prej fytit.

Nëna bënte kryq dhe lutej:

— O zoti Krisht! O zonja Shën Mëri! dhe lotët i lanin fytyrën e tmeruar.

Era frynte pa pushim. Diku u dëgjua zëri i zemëruar i një maceje. Duhej të ishte macja e shtëpisë.

— Çohuni të flemë, urdhëroi babai dhe nisi të ndihmojë nënën për të ngritur sofrën, duke pyetur gjithëmonë po me atë zë të mbytur: — Ç'të jetë?

Nëna rudhte krahët dhe hapte sytë, ku frika, në vend që të largohej, shtoej. Ajo dridhej si purtekë dhe ne fëmijët shtrëngoheshim pas asaj e dridheshim bashkë me të.

— Kush mund të jetë, veç Andonit? pyeti im atë.

Andoni qe vëllai i tim eti, mësues edhe ai, që kishte vdekur kohë më parë. Unë ahëre isha nj'a dy vjeç.

Nuk e di përse tim eti i shkoi mendja te i vëllai dhe as te ndonjë nga motrat e shumta, as te i ati dhe e ëma, që i kishin vdekur.

Me gjithë se babai nuk besonte fort dhe në kishë më shumë shkante sa për sy të botës, ai nuk qe krejt i shkëputur nga feja dhe besimi. Në çaste të vështira të jetës, Perëndinë e kujtonte me shpresë.

Më bie ndër mend se, kur jam rritur dhe nisa të mos besoj, kur bisedonim për çështje të Perëndisë dhe të shpirtërave, im atë nuk më kundërshtonte. Ai, as nuk ngrihej kundër mendimeve të mia të lira dhe as nuk më këshillonte që të besoj. Sidoqoftë, thosh:

— E, mor bir. Shkenca ashtu e kërkon, të mos besosh. Ajo ka shpjeguar kaq e kaq gjëra dhe do t'i shpjegojë të gjitha, me radhë. Po...

Dhe ngecte një copëherë im atë me këtë «po» në gojë.

— Po..., po si të them... Të mos ketë asnjë fuqi, asnjë shpirt që ta ketë krijuar këtë botë të

nuckulueshme dhe të drejtojë punët e saj?... Si ta thuash plot gojën se s'ka fuqi të tillë? Edhe në ta thëntë mendja, zemra nuk ta thotë... S'di si të them...

Mua më vinte keq për babanë, kur e dëgjoja të kuvendojë kështu. Ndonjëherë, zemëroheshja me të:

— Mirë, mirë! Ec e ndiz ndonjë harzane të madhe në kishë dhe të qoftë ndihmë!

Ai buzëqeshte ëmbël dhe ulte kokën, duke dashur të më japë kështu një farë të drejte. Si me turp, thosh:

— Njeriu nuk duhet t'u besojë përrallave të qëmoçme. Po...

— Po? ia prisja unë, edhe më i zemëruar.

— T'i lëmë këto fjalë, i jepte ai fund bisedës dhe ngrihej e ikte, si i mundur.

Po, thellë-thellë, ai besonte. Kjo u duk mirë asaj nate maji me shi dhe erë.

Era vërshëllente pa pushim, babai ndihmonte nënën të ngrëjë sofrën e thosh:

— Kush mund të jetë, veç Andonit, moj grua?

— Nëna dhe ne të tjerët, e shikonim të habitur. Përse të ishte xhaxhai? Asgjë nuk kuptonim. Po me që ashtu thosh babai, ai duhej të ishte. Kështu na u mbush dhe ne mendja.

— Ejani të flemë, urdhëroi edhe një herë im atë dhe dolëm te çardhaku, ne fëmijët të shtrënguar pas nënës që nuk pushonte së dridhuri, babai me djepin e të voglit në duar.

Të gjithë shikonin të llahtaritur tavanin, sikur që andej të na vinte atë çast vdekja. Dera e dhomës së gjumit, matanë çardhakut, na dukej sikur të qe në fund të botës.

Dhe ja, e njëjta trokëllimë, pak më e dobët, po edhe më e gjatë se dy herët e tjera, goditi tamam mbi kokën tonë.

Ne ramë përmbys me ulërime. Po babai nuk lojti vendit. Duke shtrënguar fort djepin në duar, ai briti:

— Në qofsh ti, o Andon, aman se m'u prishe gjakun kalamanjve! Largohu, të ndritë shpirti!

Vetëm era, që qau nëpër hatulla e vërshëlleu drurëve dhe telave, iu përgjigj.

Ne e premë lemerinë, duke qëndruar gjithëmonë përmbys, pa guxuar të ngremë kokën.

Sa nderjëm ashtu, as unë s'e di. Po trokëllimë tjetër nuk u dëgjua. Ngadalë-ngadalë, nëna drejtoi shtatin, duke u lutur e duke bërë kryq:

— O zoti Krisht! O zonja Shën Mëri!

Së fundi e kapërxyem çardhakun dhe vamë të flemë. Po sa po flini ju këtë çast, aq fjeta dhe unë asaj nate! Era që nuk pushonte, im atë dhe nëna që pëshpëritën gjithë natën në shtratin e tyre, mendimet e frikëshme që më përshkonin trurin, nuk më lanë të bëj asnjë sy gjumë. Kisha mbuluar dhe kokën me jorgan, se më kallte datën çdo hije e dhomës, sidomos kur lëvizte ndonjë perde nga era që frynte përmes xhamave pak të thyera. Çdo hije ishte për mua një shpirt i hakërruar.

Të nesërmen, agoi një ditë shumë e bukur maji, plot diell. Gjelbërimi i larë i lartësive të Shpatit përballë e i gjithë maleve e kodrinave përreth, shëndriste me një gjallëri të veçantë.

Me frikë të madhe, u ngritëm nga dysheku. I pari doli prej dhomës së gjumit babai, pastaj nëna me ne fëmijët të shtrënguar pas saj.

Mbi cardhak, tavani ishte po ai, veçse ne me-
zi guxonim ta vështrojmë.

Babai nisi të bisedojë përsëri me nënën për ngjarjet e mbrëmëshme. Ai tani ishte i sigurt se shpirti i Andonit e kishte bërë atë punë. Duket se e kishte marrë malli fort Andonin për shtëpinë dhe kishte ardhur asaj nate furtune. Me t'i folur babai, Andoni nuk trokëlliti më mbi tavan, se i erdhi keq që na llahtarisi.

Kështu thosh im atë. Të këtij mendimi qenë edhe gjyshja, kushërinjtë dhe të afërmit tanë që e mësuan ngjarjen.

— Le të thonë të pabesët se nuk ka shpirt! inatosej dajë Stefani, një kushëri, më bestari i gjithë fisit tonë.

Po kaluan disa dit dhe në shtëpi filloi të mba-
jë era kërmë. Kjo erë ndjehej sidomos në çardhak.

— Do ketë ngordhur ndonjë mi në tavant, tha babai dhe vuri njeri që të hypë dhe të heqë ngordhësirën.

Njeriu që hypi, gjeti atje një gjarpër të madh shtëpie të bërë dy-tri copësh.

Ahere babai, i cili, edhe pse besonte, dëshirë kishte ta shpjegojë çdo gjë drejt dhe të besojë sa më pak, qeshi me të madhet. Ai na e shpjegoi kështu ngjarjen e llahtarëshme:

Macja jonë na paska zënë një gjarpër shtëpie. Duke u përpëlitur, gjarpëri trokiste në tavan. Ai trokiti tri herë, aq sa pat fuqi.

Po, me që babai kishte marrë nëpër gojë tim ungj, nëna ndezi nuk e di sa qirinj mbi varr të Andonit, bëri për të palakris në kishë e në varrezë. Im atë nuk qe kundër.

Tregim i dymbëdhjetë

I D U R U A R I

V erën e vitit 1925, babai na dërgoi për pushime në Belësh, katund i madh i Dumresë, një pesë orë në jugë-perëndim të Elbasanit.

Ajo krahinë është vend liqenesh. Ka më se njëzet liqene të vogla nëpër Dumre. Disa janë si hurdha midis donjë lëndine ose të fshehura pyjeve; të tjerë mund të arrijnë pak kilometra gjatësi.

Liqeni i Belshit është nga më të mëdhenjtë e Dumresë. Ai ka trajtën vezake dhe një sërë kodrinash i rrinë për qark. Sikur ta shohësh nga aeroplani, fshati do të duket si një unazë gjelbërore, me një gur në mes.

Po nuk mund të thuash se ky është një gur xhevahiri. Liqeni i Belshit, edhe pse vende-vende është i thellë, pjesën më të madhe e ka të cektë. Ai nuk është gati kurrë i kaltër sa duhet. Në verë,

ana vertore i shter dhe lluca thahet e çahet në diell, si ndonjë bukë e bërë me krunde.

Sidoqoftë, liqeni ka bukurinë e vet, veçanërisht i parë nga lart, nga kodrinat.

Majë njëres prej atyre kodrinave e kishim zënë ne shtëpinë asaj vere, një shtëpi midis kopësh-tijesh me duhan e pemë. Qershitë e kumbullat skuqnin e verdhonin në degë. Fugat këndonin fik më fik. Ne fëmija, një pjesë të mirë të ditës e kalonim pemë më pemë, kohën tjetër anës liqenit.

Laheshim me frikë të madhe, se, pas dy-tri çapeve, niste thellësira. Uleshim buzë ujit dhe laheshim me duar, si në hamam. Kështu nuk arrita të mësoj not në Belësh. Pa e kisha zili të madhe mësuesin e fshatit, që i dilte liqenit tejmatanë me not e thoshin se nuk lodhet.

Në Belësh, ahëre banonin dy familje elbasanase, që kishin në fshat dy dyqane të vogla. Njëri nga tregëtarët kishte edhe një vëlla ose kunat, — nuk më kujtohet mirë, — fatakeq njeri, Kristaqin.

Ishte një gungaç i zbetë, nj'a një pëllëmbë më i shkurtër se unë, me një hundë si mos më keq të shtypur, me një palë veshë tepër të gjatë. Çdo gjë ishte e shëmtuar te Kristaqi. Edhe sytë e tij, të turbullt e gjithë gleba, më të shumtën e herës i qanin. Dërrasën e krahërorit e kishte një pëllëmbë të gjerë dhe si me majë. S'andejmi dilte një zë, si prej një ene të çarë.

Po sa i shëmtuar ishte Kristaqi, aq i dashur ishte, të pakën me fëmijët. Kurdoherë mbante me vete një fyshek karte me sheqerka, për të njomur gojën, si thosh. Shpesh, ato sheqerka ia hanin

fëmijët e fshatit. Kur mbeste vetë pa gjë, ai vinte buzën më gaz e ia bënte:

— Kam ngrënë, unë.

Gjithë kohën, Kristaqi e çonte buzë liqenit, duke hedhur nga katër-pesë grepa për të zënë peshk. Nuk hidhte grepa të vegjël, po disa të mëdhenj, të cilët i lidhte me një si spagë të hollë e shumë të fortë. Cironkat nuk i përfillte. Donte vetëm peshqit gjysmë oke e lart.

Po e keqja e madhe ishte, se, me dit të tëra, disaherë edhe me javë, ai nuk zinte asnjë peshk. Tregonin se po bënte vite që Kristaqi nuk kishte zënë farëgjëje. Prapë se prapë, ai nuk e humbte as shpresën, as durimin.

Si ç'ishte i shëmtuar dhe si ç'janë bota shpesh zemërgurë, plot vetë talleshin me Kristaqin, duke i thënë se nuk e kishin parë ndonjëherë të zërë peshk dhe se, si peshkatar, ai nuk vlente asnjë pesësh. Kristaqi i shkretë tërbohej po ta ngacmoje kështu.

Kristaqi e dinte veten peshkatar të zotin, po, si thosh ai, peshku e ka me fat. Më kot lëvdohej Kristaqi për peshqit e shumë të që kishte zënë. Edhe ata që e kishin parë me sytë e tyre të zërë peshq, dhe jo të vegjël, bënin sikur kishin harruar ose mohonin.

Ai i shante njerzit e nuk u linte gjë pa thënë. Më kujtohet kur u bërtiste:

— Ecni e bëni çorape, si gratë! Burra jeni ju?

Në të vërtetë, në Belësh, çorape dinin të thurin vetëm burrat. Zakon i çuditshëm.

Sidoqoftë, edhe unë fillova t'u besoj njerëzve që thoshin se Kristaqi rron me ëndërra. Se ja, me

greqat e mi të vegjël, unë s'kishte ditë që të mos kap cironka, kurse kaloi një muaj që po veronim në Belësh dhe Kristaqi nuk zinte gjë. Ndofta ky liqen kishte vetëm cironka, se, fundi-fundit, liqen i vogël ishte.

Kristaqi rrinte gjithë ditën në diell, e lante dhe e shplante djersa, thahej e tretej, nxihej e bëhej edhe më i shëmtuar se ç'që hahej e brehej me veten, grindej me ngacmimtarët, hidhte në liqen grip pas gripi, — dhe peshk nuk zinte. Nganjëherë, rrinte edhe natën vonë, po më kot. E kisha parë edhe me sytë plot, veçse peshku nuk donte t'ia dijë për lotët e Kristaqit.

Një ditë, bëra një gabim të rëndë.

Dumreja, si liqen më të madh, ka atë të Seferanit një orë më tutje se Belshi. I zoti i shtëpisë ku ne banonim, shkoi një ditë në Seferan për punë. Im atë e porositi të na sjellë peshk dhe ai solli dy-tri okë. Unë, pa pyetur njeri, fshehurazi, e mora peshkun më të madh, e futa në një shportë dhe ia shpura Kristaqit buzë liqenit.

Hapa sytë nga të katër anët, se mos më shohë njeri, e i thashë:

— Na, Kristaq! Merre këtë peshk. Vëre majë gripit e thuaj se e zure. Të gjithë do ta besojnë.

Kristaqi ngriu në vend. Sa i verdhë e i zi ishte, aq edhe më shumë u zverdh e u nxi. Sytë e tij të turbullt, sikur shkrepëtinë. Ngriti dorën të më godasë, po i shpëtova. Më shau sa deshi.

Gjer atë ditë, edhe pse nuk i besoja, unë i kisha dëgjuar me durim gjithë tregimet dhe lëvdatat e Kristaqit për peshqit që thosh se kishte zënë.

Tani, me gabimin që bëra, dëftova se ndofta nuk i kisha besuar asnjëherë.

Me atë gabim, unë e përçmova Kristaqin fare. Ai e dinte se që peshkatar mbi peshkatarët dhe mërinë më të madhe e pat, se bota e kishin parë të zërë peshk, po bënin sikur jo ose mohonin.

U zemërua kaq fort Kristaqi me mua, sa nuk më foli më. Nuk më linte as t'i afrohem kur ai peshkonte, po më ndiqte me gurë.

Unë, ndonse pesë-gjashtë vjeç më i vogël se ai, po të kisha dashur, me një gur mund ta lija në vend. Po më dhimbsej, më dhimbsej shumë. E ndjeva se e kisha fyer, se isha fajtor përpara tij. Dhe, me që nuk më donte, me që nuk më fliste, i qëndroja larg, peshkoja larg tij. Dhe i shkreti Kristaq nuk zinte asnjë peshk, me gjithë grepat e shumtë që hidhte në liqen.

Një pasdreke, unë kisha hedhur grepin aty pranë çezmës së buzës së liqenit, nja një qind metra nën Kristaqin. Peshku kafshoi, unë ngrita kallamin dhe zura një cironkë të vogël si përherë.

Kur po e shkëputja cironkën prej grepit, dëgjoj një zhurmë. Kthej kokën dhe shoh Kristaqin, i cili herë tërheq dhe herë lëshon perin, duke u lëkundur me mundim sa përpara prapa, dhe duke u kollitur me të madhet.

Atë çast kishte gjetur kolla ta zinte. Kur e zinte kolla Kristaqin, e mbante një orë dhe ia shkallmonte krahërorin. Ishte tuberkuloz Kristaqi dhe po zvarriste vitet e tij të fundit buzë atij liqeni që rrallë e kënaqte.

Grepi më ra përdhe me gjithë cironkë. U mata të rend e t'i vete Kristaqit pranë, po nuk guxova,

Veç ja, ai u shtri përmbys, ose më mirë u shemb. Gunga e tij me majë e tregonte si një kërmill. E shihja se si tërhiqte dhe lëshonte me zor të madh spagën. E pashë që po rrëshqiste zvarrë drejt ujit. Kollitej si mos më keq. Nisi të bërtasë e të shajë nëpër kollë. M'u drodh zemra, renda dhe, me një frymë, i vajta pranë.

— Ke zënë një peshk të madh! Të lumtë, Kristaq! Dale ta tërheqim bashkë! i thashë unë dhe u lëshova të kap spagën.

— Ik! më gërthiti ai dhe më hodhi një vështrim të egër.

Unë iu luta përsëri, po Kristaqi filloi të më shajë e të më kërcënohet. Nuk guxova ta ndihmoj.

E pashë se si luftoi edhe një çerek ore me spagën, zvarrë. Këmbët e duart i gërvishti nëpër gurët e buzës së ujit, po spagën nuk e lëshoi. Peshku kishte qenë aq i fortë sa e tërhoqi Kristaqin brenda në liqen, ku hyri me gjithë rrobe. Trupin e vogël ia mbuloi ujët menjëherë. Vetëm koka i mbeti jashtë. Po mbytej përpara syve të mi dhe, për fat, aty pranë nuk u gjend askush.

U tmerova. U hodha edhe unë në ujë, kapa spagën me të dy duart dhe e tërhoqa peshkun me aq fuqi, sa ai, sigurisht i lodhur, nuk qe më i zoti të qëndrojë.

Kristaqi këceu menjëherë jashtë ujit. E tërhoqëm spagën bashkë.

Rrena e shejtanit, si thonë, doli nga liqeni një pendëkuq i gjatë e i trashë gati sa Kristaqi! Ky nxori prej xhepit një brisk të madh e goditi me sa fuqi pat peshkun në bark, në kokë, ku mundi.

Vendi u mbyt në gjak dhe, duke u përpëlitur, pendëkuqi na spërkati e na bëri edhe ne tërë gjak.

A ishte më e mundur që të thoshte njeri se Kristaqi nuk qe peshkatar i zoti? Ai kishte zënë peshkun më të madh të Belshit, në mos të Dumresë. Me këdo që takohej ato dit, Kristaqi i tregon-te duart e gërvishtura, pantallonët që i ishin grisur së tërhequri peshkun. Njerëzia tani e zinin prej supi, me dashuri.

Kuptohet që ne u bëmë përsëri miq të mirë me Kristaqin. Dhe, ç'prej ditës që zuri atë pendëkuqin e madh, Kristaqit i eci peshkimi: shpesh zinte peshk dhe më gostiste edhe mua herë pas here.

Po dielli, në vend që t'ia hiqte kollën, duket se ia ngacmonte dhe ia shtonte... Pas dy vjetësh, mora vesh që kishte vdekur.

Tregim i trembëdhjetë

D Ë S H T I M

Prej Belshit kam edhe kujtime të tjera. Ja një prej tyre.

Kam qenë pesë-gjashtëmbëdhjetë vjeç ahëre. Filloren e kisha mbaruar me kohë dhe tani mësoja në liceun e Korçës.

Që nga viti 1926, kur u hap rruga automobilistike e Korçës, babai na dërgonte verës në Pogradec, vend me klimë të mirë dhe shumë i dashur për tim atë, si ç'e dini. Në Pogradec, nxura të bëj not dhe u bëra një notar i zoti.

Isha guximtar dhe, — sigurisht fshehurazi prindërve, — shkoja thellë në liqen, ndonjëherë edhe një ose dy kilometra thellë. Nisesha me pash e kthehesha më kurriz, ngadalë e pa u ngutur. Po, kur kthehesha, unë e di se ç'vuaja. Më dukej se nuk do ta arrij bregun kurrë. Shtrihesha ahëre mbi

ranishte dhe rrija një gjysmë ore të pakën pa lëvizur. Kumi dhe dielli, me ngrohtësirën e tyre, më shpinin dhe çlironin muskëlat, që sikur kishin shtangur nga stërmundimi...

Atij viti, babai nuk na dërgoi dot në Pogradec që në fillim të korrikut. Nuk më kujtohet përse. Kështu, ne kaluam disa javë me vapë në Elbasan.

Kisha një kushëri mësues gjimnastike, që organizoi ahere në Elbasan një palë gara krahinore noti. Ai më dinte se isha notar i mirë dhe m'u lut që të marr edhe unë pjesë në gara.

Të them të drejtën, nuk më pëlqente të marr pjesë, sepse të tjerët unë nuk i përfillja. Më qe rritur mendja, me një fjalë. Më dukej si një gjë e lehtë të bësh not në Shkumbin, ku nuk gjen as njëzet metra vend të gjatë për të notuar dhe ku rryma e ujit të ndihmon të shkosh aq shpejt sa të duash.

Ku i përfillja notarët e Shkumbinit unë, që, kur hyja në liqen dhe largohesha në thellësi, nga bregu dukesha sa një kokër kumi? Po, kur më thanë se garat do të zhvillohen në Belësh, m'u zgjuan kujtime të përmallëshme e dhashë fjalën se do të marr pjesë.

Në Belësh, vajtëm me kamion dhe pastaj më këmbë.

Katundi ishte po ai që kisha njohur pesë vjet më parë. Liqeni kishte shteruar më pak atë vit. Sidoqoftë, m'u duk shumë më i vogël, se ç'e prisja. Bëra çudi me veten, se më ishte dukur më i madh dikur, edhe pse unë kisha njohur prej kohësh liqenin e Ohrit.

M'u kujtua ai mësuesi i Belshit që i dilte liqenit. tejmatanë me not dhe habitesha unë dhe habiteshin njerzit për atë notar të rrallë në këto vise. Notarë si ai, në Pogradec kishte me dhjetra. Mos që ndonjë gjë e madhe që ta çaje liqenin e Belshit mespërmes me not?

Nuk e bëra të gjatë, po u xhvesha, ia lashë rrobet në kujdes një shoku dhe këceva në ujë. I rashë liqenit së gjeri dhe, pas njëzet e sa minutash, kisha dalë te bregu matanë. Atje, as që u shplodha fare, po këceva përsëri në ujë dhe, pas njëzet e sa minutash të tjera, dola mëkëtanë.

Im kushëri, kur më pa, u mvrenjt. Ai i kishte mbaruar gjithë përgatitjet për fillimin e garave. Po unë, a do të isha në gjendje të marr pjesë?

— Si e ndjen veten? më pyeti, i çqetësuar.

— Shumë mirë, u lëvdova unë, pak si me inat: dhe pezmatim.

Ç'pandehte ai, se lodhesha me kaq?

— Nuk që ndonjë gjë e madhe, i thashë e nisa t'i tregoj se si në Pogradec unë kisha bërë gjer më tri-katër kilometra not vajtje-ardhje.

Pata sidomos inat se më pyeti në sy të të tjerëve. Më përçmoi përpara notarëve të lumit!

Kushëriu i ra bilbilit. Garat filluan.

Unë vura tërë forcat dhe dijeninë time që të dal i pari. Veçse tani, puna nuk ishte vetëm të dije not mirë, të qëndroje në ujë gjatë, po të rëndje në ujë me shpejtësinë më të madhe.

Tërë fuqitë e mia prej notari të spruvuar, jo në Shkumbin e në Belësh, jo «me bretkosat», —

si tallësha unë me vete, — po në Pogradec, në atë
liqen të madh e të thellë si det, tërë fuqitë e mia
mezi mjaftuan që të dal i dyti. I pari, një notar
Shkumbini, më la pesë metra pas vetes! I treti, një
notar Belshi, arriti as një pëllëmbë pas meje!«

Lëre ç'dështim!

Sigurisht, të tjerët nisën të tallen me mua,
edhe pse jo në sy. Nuk kisha ç'të bëj. Durova.

LULET DHE PATLLIXHANAT

Si mund të lëvdohem akoma se kam qenë njohës i zoti i luleve? E prapë se prapë, më vjen keq t'ia mohoj vetes këtë meritë. Se kam qenë miq i ngushtë i manushaqes e i karakaftes, i lulegre-rës e i symizës, i bathrës e i qumështores, i kaçes e i taçes...

Sikur të vazhdoj së numuruari emrat e tërë luleve që kanë qenë mikeshat e mia, si ç'janë lulet e salepit, kozmanaqet, lulebardhat, aguliçet, lulet e sapoit etj, ju mund të mërziteni. Dhe unë nuk po vazhdoj, me gjithë se nuk ma merr mendja të mos jeni dhe ju miq të luleve, të mos keni dhe ju mi-dis luleve mikeshat.

Sidoqoftë, nuk më rrihet pa ju këshilluar: të jeni miq të luleve, t'i doni lulet fort, t'i njihni lulet, — t'i njihni më mirë se ç'i kam njohur unë.

— Të njohësh kaçën, mos pandehni se do të thotë të njohësh vetëm atë lule të brishtë bojë violce. që çan dëborën dhe lajmëron e para pranverën. Të njohësh kaçën, do të thotë të njohësh fillimet e pranverës, të të sjellë hera buzë një përroi që rrëzon gazmor prej malit dëborën e shkrirë, atë ujë dëbore të kthjellët si qielli i rimë. Të njohësh kaçën, do të thotë të të sjellë hera lëndinave, ku dëbora, pulla-pulla të bardha, zbukuron qilimin e ri gjelbëror, mbi të cilin kanë filluar të lëvizin një mijë qenie nën diellin jetëdhënës, — kanë filluar të ngjallen milingonat, të shkasin zhapinjte, të këndojnë gushçkuqët, apo të dërdëllasë mullenja e marrë, apo të qukasë lis më lis qukapiku. . .

Cili nga ju ka parë një fushë mali me bathra? Një fushë e tillë është pranë Elbasanit mbi disa shkëmbenj të katundit Baltës. Me mijra dhe mijra lule, majë një kërcelli të gjatë, kthejnë nga dielli një si karafil të bardhë me zemrën të verdhë. Të duket se kundërmon natyra gjithë. Të duket se fryn një fllad i parfumuar i cili vjen që tutje, përtej malesh dhe detesh. Ahere thua me vete: sa e bukur është kjo botë! Dhe veten e ndjen kaq të lumtur dhe kaq krenar se je ti që ia shijon bukuritë natyrës sa të duket sikur po të dalin krahë dhe fletë, dhe je gati të fluturosh mbi male e pyje, mbi lumenj e dete. Si në ëndërr! Kur fryn fullimi përmbi bathra e i përzjen lulet e tyre, zhurmëron i tërë vendi si një det shkume të bardhë e duket se ai, parfum, që mbush natyrën përreth, del nga ajo zhurmërimë. . .

T'i doni lulet, ta doni natyrën shumë. Kështu do ta doni dhe ca më shumë jetën. Kështu jeta ka

për të qenë edhe më e bukur, edhe më e parfumuar.

Kush është nga Elbasani dhe nuk i lind një mall i çuditshëm në zemër, po t'i kujtosh ullishtat, karakaftet që mbijnë kodrinave të tyre, manushaqet që mbijnë luginave të tyre?

Kush i kujton krojet e malësive dhe nuk njih lulet symizë? Janë ato miozotiset e vogla bojë qielli, me një çikë të bardhë në mes. Emrin ua thonë edhe «lule mos më harro». Unë kurrë nuk i harroj miozotiset e para që kam mbledhur te kroi i Karamuçajve në Shelcan të Shpatit, bashkë me atë vërnikun tim, Nasin e Toçit, të cilit nëna i jepte zakonisht bukë thatë dhe ndonjëherë më të rrallë «dy exheqe»: Nasi dinte shumë emra lulesh, po, emrin e miozotisit nuk e dinte. Ne të dy ia vumë emrin symizë. Miozotiset të porositin të mos i harrosh se janë si mijra sy të kaltër, si mijra yj të vegjël, që mbijnë shpesh pranë burimeve, në vise hije. Aty, ku nuk hyn dielli ose hyn pak e rrallë, ato sikur sjellin dritë...

Vërtet, unë mund të flas gjer nesër për lulet, mikeshat e mia. Po a mund të lëvdohem se i njoh? Më mirë të them atë që është: i njoh pak, shumë pak...

Atij viti që bëra klasën e fundit të fillores, klasën e gjashtë, — se filloret në fëmëninë time kanë qenë më gjashtë klasë, — pranvera erdhi më e bukur dhe më e mbarë se asnjëherë. Marsi nuk solli dit të ftohta. Plakat 1) ne nuk i njohëm atë vit. Në

1) Plakat, ditët e fundit të marsit dhe dy ditët e para të prillit, quhen kështu sipas një përralle. Ato ditë, qëllon e bën ftohtë.

Shën Gjergj, të mbjellat kishin mbaruar e të gjithë gëzoheshin se qenë të begata shumë. Qingjat, që kishin dalë me të aguar viti, ishin bërë tani shelegë të vërtetë. Grunjat u korrën më tri javë qershor të gjitha. Më tri javë qershor, misrat ishin pyll, ku nuk mund të bënte gjë drapri, po ku duhej sëpata. Dhe sa për manat kumbullat e qershitë e fiqtë, për to nuk flitet! Dhe sa për lulet...

Oh, lulet! Baltasejtë e përmishiionasit 1) e mbushën pazarin me lule, jo më për të shtuna vetëm, po dhe për çdo ditë jave. Nuk rrëfehen zymbylat, bathrat, misirët e borzilokët e asaj pranvere.

Një të shtunë, unë i bëra pazaret e shtëpisë vetë, pa tim atë, i cili kishte punë të tjera. Tani isha i rritur, dymbëdhjetë vjeç, dhe kisha mësuar t'i bëj mirë pazaret. Po asaj të shtune, në shtëpi u ktheva pa vezë e pa djathë: u ktheva me dy shporta plot lule! I bëra paratë, lule, — lule e bitme lulesh, dy shporta plot!

Nëna nuk arriti të më qërtojë. Ato shporta me zymbyla e bathra e ç'të më doje e lanë me gojë hapur. Dhe ato bimë i kujtuan se ishte në faj, se nuk kishte menduar as për oborrin tonë të vogël, që duhej punuar e plehëruar, as për saksitë tona, ku nxirrte kokën ndonjë kërcell i thatë karafili, lulenishtje ose idërshahu.

Ne nuk i bëmë zë njëri-tjetrit po, që atë kohë, nisëm e punuam oborrin bashkë.

Se mos ishte dhe ndonjë oborr kush e di se çfarë. Pjesën më të madhe të tij e zinte portokalli, të cilit i ngjiteshin degët përmbi çati. Një pjesë

1) Baltasejtë e përmishiionasit, banorë të fshatrave Baltës e Përmishijon.

tjetër e zinte ftoi me pjeshkën. Për lule nuk kishte tepruar më shumë se një pëllëmbë vend. Këtë pëllëmbë vend, ne e punuam sakaq. Plehu nuk na mungonte: cikën e Cenit e kishin dhe për lulet duhet pleh dhish.

Që atë pasdreke, oborrin e pastruam, e punuam, e plehëruam dhe e mbollëm... Në mbrëmje, kur babai kërkoi të hante, në dollap nuk kishte as vezë, as djathë!

Si? As pazaret nuk kishte bërë djali? Po ç'kishte bërë gjithë ditën? Apo kishte rojtur rastin që babai nuk erdhi dot në shtëpi për drekë? Djali vetëm një orë këndim dhe një orë gjimnastikë kishte për të shtuna në shkollë. Mos kishte brendhur kot gjithë atë mal dite?

Mezi u shpjeguam me babanë. Ai nuk ishte merak pas luleve. Si për dënim, unë mora kusinë e kosit dhe renda në pazar.

Rrugës mendjen s'e kisha as te qërtimet që hëngra, as te kosi që do të blija, po te lulet që kisha mbjellë. Tani, duhej gjetur domosdo edhe një dorëzonjë, që ta mbillja te porta dhe të rritej e të mbulonte portën gjithë. Ç'erë që ka dorëzonja! E ç'lule! Bukur ia kanë vënë atë emër.

Si edhe sot, udhët e Elbasanit ishin nga të dyja anët me rema uji dhe jo pa baltë. Shkela keq dhe shkava edhe më keq. Dërmova gjurin, derdhakusinë dhe u bëra tërë baltë e kos. Kjo kështu më ngjau fare pranë shtëpisë. U mata një herë ta lë vrapin te ime gjyshe, po thashë me vete se babait do t'i vijë keq dhe nuk do të më qërtojë përsëri.

Në shtëpi u llahtarisen. Më xhveshën, më lanë, me futën në dyshek. Koka më digjej nga sik-

leti, si thonë. Më pandehën me ethe e më vunë, në shtrat pa bukë.

— Më mirë të mos hajë gjë sonte, tha babai.

Ky qe dënimi që mora. Nuk mbeta pa dënim. Apo s'ishte dënim edhe ai gjuri që vrava?

Natën ëndërrova për lule, vetëm për lule. Një dorëzonjë e madhe i ngjitej shtëpisë sonë nga të katër anët dhe varej kurorë-kurorë në çdo dritare. Në mes të oborrit, përpara syve të mi, mbiu një trëndafil i madh, të cilit në çdo degë i dolën gonxhe e lule të mrekullishme. . .

Lëre ç'kujdes që kemi pasur për lulet asaj pranvere! Po më të shumtat nuk u bënë! Nuk u bë asnjë nga lulet që vinë herët, as lulenishtet, as lulevathët. Fajin ia vumë plehut: u kishim hedhur pleh tepër. Disa thanë se nuk duhej pleh i njomë.

Në krye të muajit, dështuam aq keq, sa u dëshpëruam, si unë, si nëna. Mua m'u përsëndye vetja. Të mos isha i zoti të mbjell e të rrit lule! Nuk është turp! — Turp i turpeve!

Atë mot ra shumë herët një nga ato epidemitë e tifos që binin shpesh në Elbasan. Shkollat u mbyllën. Provimet u lanë për vjeshët. Këshu që, në fund të majit, ne u larguam nga qyteti dhe vajtëm për pushime në Shën Jon, një manastir aty pranë. Në shtëpi nuk mbeti kush, veç maces, për të cilën ngarkuam gjyshen që ta ketë kujdes. Ime gjyshe tani nuk jetonte më bashkë me ne; djali i qe rritur, punonte sheqerxhi, dhe gjyshja ishte kthyer në shtëpinë e saj. Gjyshja mori përsipër të kujdeset edhe për ato pak lule që jepnin shpresë.

Gjer aty nga mezi apo fundi i korrikut, asnjëri prej nesh nuk u kthye në Elbasan, qoftë edhe

për një ditë, me gjithë se Shën Joni nuk është më shumë se një orë nga qyteti. Babai, kur bënte pushime, nuk lejonte njeri që të kthehet në qytet. Pastaj, epidemia zgjati një dy muaj.

Im ungj vinte çdo të shtune në mbrëmje në Shën Jon, na sillte ndonjë plaçkë, kalonte të dielën me ne e kthehej në Elbasan të hënën më të aguar.

Domosdo, ne e pyesnim për macen dhe macja ishte shëndosh' e mirë. Unë nuk harroja ta pyes edhe për lulet. Ai, në fillim, nuk më dha ndonjë lajm të mirë për to. Po, pas një kohe, nisi të m'f lëndojë me të madhet. Janë bërë lulet kështu, pa ashtu, pa kanë zbukuruar oborrin, pa duhen rojtur, se macja lot nëpër to dhe i shemb...

Ja që kishim qenë të zot të mbjellim lule! Po kush e di, mbase i kishim ujitur tepër dhe ujët e tepërt i kishte dëmtuar. A nuk rrija unë po me ujitës në dorë?

Më kot iu luta tim eti, që të vete e të shoh lulet në Elbasan. Nuk më lejoi. Mos doja të marr sëmundjen? Po tërë atë udhë, nuk e bëja hesap? E kush do të më sillte të nesërmen? Po mësimin e frëngjishtes, si do ta lija? Babai më mësonte frëngjisht, se më përgatiste për liceun e Korçës, ku do të shkoja në vjeshtë.

Iu luta vazhdimisht tim ungji, të më sjellë ca lule nga tonat po ai sa herë që vinte, nuk sillte gjë. Thosh se harroi dhe betohej se nuk do të harronte më. Harroi kaq herë, po në fund, u kujtua.

Na solli një të shtune në mbrëmje një shportë të madhe me patllixhana. Midis tyre, kishte edhe disa piperka të vogla dhe të holla. Këto ishin lulet që kishim mbjellë unë dhe nëna!...

E si të lëvdohem, miqtë e mi, se i njoh lulet?
Në vend që të blej bitme lulesh, kisha blerë bitme
perimesh! Pazaraku që m'i shiti, duket se nuk kish-
te bitme lulesh, po donte të shesë bitmet e peri-
meve që kishte, dhe më gënjeu.

Sidoqoftë, ishin të shijshme fort patllixhanat
dhe piperkat tonë. Dhe ne nuk kishim qëlluar
baçevanë të këqinj. Hëngrëm patllixhana dhe
piperka gjithë asaj vere. Hëngri edhe gjyshja në
Elbasan.

KRECI I KOKONESHIT

Shën Joni është një nga vendet më të dashura të elbasanasve. E si të mos jetë aq i dashur ky vend?

Manastiri gjendet në një luginë të bukur, midis selvive dhe ullinjve, buzë një lumi që, ndonjëherë, humbet nëpër rrapishtë dhe që ia thonë emrin Kushë. Sipër manastirit, është katundi Përmishijon. Rreth e rrotull, — një çair i madh, ara, pemishte, kopshtije, burime, hije të këndëshme.

Elbasanasit e kanë pasur zakon të vinë këtu për festa e piknike. Më kujtohet se këtu e bënë festën e esnafit të tyre samarxhinjtë. Ahere gëlon-te Shën Joni i tërë nga dy palë saze.

Me që përmenda samarxhinjtë le të them se edhe mua diçka më ka lidhur me ta: kur ishim në Korçë, gjatë verës, im atë më vinte çirak te një samarxhi elbasanas, që të mos endem rrugëve...

Në Shën Jon, përveç kishës dhe konaqeve të priftërinjve, murgjëve dhe njerëzve që shërbenin aty, kishte edhe një shtëpi të madhe, ku vinin ngamot familje elbasanase, për të veruar.

Gjatë stinës së nxehtë, Shën Joni bëhej një si Elbasan i vogël. Çairi, ullishta, burimi, anët e remës, që vjen nga katundi Reçan, afërsitë e mullirit, mbusheshin tërë ditën me njerëz. Burrat vinin gotën e rakisë përpara dhe këndonin. Gratë u binin daireve. Plakat u frynin zjarreve, gatuanin gjellët dhe pinin kafe pas kafeje. Vogëlushët tërhiqeshin zvarrë nëpër gjelbërim. Ne më të rriturit bridhnim gjerdheve, pemë më pemë.

Le të ruante sa të desh Kokoneshi, — s'ishte punë. Fëmijët i hanin pemët e manastirit. E jo vetëm fëmijët, po edhe të mëdhenjtë. Kumbullat e famëshme të Shën Jonit që janë sa një grusht, nuk arrinin të piqen kurrë. Ato i hanin pa pjekur çupat dhe gratë. Kush e di sa herë kam këputur kumbulla aguridhe për çupat dhe gratë.

Fola për Kokoneshin. Ky ishte një nga shërbetorët e manastirit. Disa thoshin se kishte ardhur aty si murg, po Kokoneshi nuk vishej si murg, me rrobe të zeza, ai vishej me pendebre-kë dhe në kokën e tij të madhe sa për dy kokë bashkë, mbante takije. Të tjerë thoshin, dhe kjo duhej të ish e vërteta, se Kokoneshi dikur kishte qenë i çmendur. Të çmendurit i dërgonin në Shën Jon, ku i futnin në tramuk, domethënë i lidhnin nëpër bodrume, i ushqenin me bukë e uthull dhe i rrihnin. Qëllonte që ndonjëri shërohej. Kështu duhet të kishte qenë shëruar edhe Kokoneshi pasi kaloi nëpër tramuk.

Kokoneshi kishte dy sy të mëdhenj, që, kur inatosej, mund ta kujtoje për të çmendur. Ishte me-zatar në trup, po lart shumë i gjerë dhe poshtë si i shtrembër. Kurrë nuk e shihje të qetë. Ose do të thërriste, ose do qeshte. Kishte një britmë të shëm-tuar dhe një të qeshur si prej njeriu që nuk është në të. Për të goditur, nuk godiste.

Ky ishte rojtari i thesareve më të çmueshme të Shën Jonit, rojtari i pemëve. Dhe me që tërë di-tën bërtiste ose qeshte, me që kishte zakonin e mi-rë të mos godasë, rrallë ia patën dhe fëmijët frikën.

Mua nuk më kishte zënë kurrë Kokoneshi dhe e dinte se isha ndër fëmijët që u binin më qafë pe-mëve më shumë. E kuptoja që më ruante dhe më gjurmonte, po isha dhe unë dinak i madh.

Kokoneshi e kishte zakon të lahej përditë të rema në fund të çairit, nën ca fiq të mëdhenj. Ta-mam në atë kohë, unë kërkoja gjerdhet e tjera të çairit, ku ishin fiqtë më të mirë, disa kreca që trete-shin në gojë dhe nj'a dy arapë, që as në Kërrabë, ku është mbretëri e fikut, nuk e kisin shokun.

Përpara se të lahej Kokoneshi, shkoja unë vetë në remë. Në fillim, ajo vijë e thellë, ku këcenin bretkosa të mëdha jeshile dhe të shëmtuara, ku tho-shin se ka dhe gjarpërinj, më shtinte frikën. Po, kur pashë që Kokoneshi lahej përditë, mora guxim edhe unë. Këtë gjë nuk e dinte njeri. Sikur ta merr-te vesh im atë, pa dyshim që do të më kishte rra-hur, edhe pse asaj vjeshte do të shkoja në lice.

Pasi laheshja, shtriheshja më ndonjë hije të çai-rit, zhdukeshja në barin e lartë dhe përgjoja Koko-neshin.

Ai, herë i binte çairit mespërmes, si ndonjë

dem i rëndë, të cilin e ka zënë vapa, herë zbriste që nga ullishta, herë ngjitej nga arat nën remë. Po ngado që të vinte, bënte pötëre. Ia thosh ndonjë tropari 1) të kishës, duke e kënduar si mos më keq, i thërriste ndokujt që shihte tutje, ose bërtiste kot, sigurisht për të trembur të vegjëlit që mund të vërtiteshin pemëve. Kur lahej, ujët e ftohtë e kënaqte aq shumë sa niste dhe bërtiste «hahaha», sikur të qeshte me vete si ndonjë çilimi. Ahere, edhe zëri i hollohej.

Ky qe çasti i volitshëm për të sulmuar fiqtë. Unë, me disa të këcyera, e kërkjoja fikun degë më degë, mbushja gjinjtë plot dhe zhduksha.

Nga larg, Kokoneshi bërtiste akoma «hahaha», duke u freskuar në remë...

Fiqtë ishin më të mbaruar. Degët e ulta dhe të mesme nuk kishin asnjë kokër. Fiq mund të hante vetëm ai që kishte guxim të ngjitet në majët fare. Atje në majët, ato pemë të rralla që kishin tepruar, ishin bërë burma. Vareshin burmat në degë, rrekeshin e rrekeshin, po nuk binin. Ishte e kotë t'i qëlloje me gurë, se dhe ashtu nuk binin. Le që ashtu bëhej pötëre. Ta bënin me sy ato rreka e burma atje majë fikut. U kullonte sheqeri përfundi dhe u ndriste në diell si ndonjë bulë vese.

Një ditë, pasi rojta mirë Kokoneshin dhe e dëgjova të bërtasë në remë duke u larë, iu afrova njërit prej krecave që janë buzë çairit. Ai ishte tamam përmbi një gardh të madh ferre, i cili nuk të linte t'i ngjitesh.

Ne fëmijët ia vumë emrin Kreci i Kokoneshit,

1) Tropar, lloj kënge kishëtare.

se vetëm Kokoneshi guxonte ta vjelë atë fik. Unë ia kisha bërë kaq herë benë Krecit të Kokoneshit, po, sa kohë kishte fiq të tjerë, nuk ma mbante ta rrezikoj veten. Tani që fiqtë e tjerë ishin mbaruar, i erdhi doemos radha krecit. Burmat, që i kishin mbetur në majët, më tërhoqën si me magnet.

Bëra si bëra, u gërvishta dhe u grisa pak nëpër ferrë, po iu qepa fikut. Ai ishte sa një karatane. Kishte një degë shumë të lartë, që vetëm ta shihje nga poshtë, të dridheshin gjymtyrët, dhe jo t'i hypje. Unë më në fund mora zemër dhe nisa t'i ngjitem asaj dege.

Po ja, tek po arrij majën, ku struken burmat, një gjarpër i zi, që m'u duk më i trashë se dega vetë, po shket teposhtë. Unë ngriva. Gjarpëri ngriti kokën, hapi gojën dhe nxori gjuhën e tij të shëmtuar kërcnueshëm. Fuqitë m'u këputën. Duart m'u zbërthyen nga dega. Humba tatëpjetë dhe rashë me kaq forcë në ferrët sa fundosa në të.

As qava, as u lebetita. U hutova fare. Gjembat që më shpuan dhe që po më digjnin nëpër mishra, nuk më sollën menjëherë në vete. Më solli në vete një e qeshur e fortë, që mbushi vendin. Ishte Kokoneshi. Qeshte e bërtiste:

— Të zura, qerrata! Të zura!

Unë s'ia kisha frikën Kokoneshit, po u turpërova kaq shumë, sa i harrova gjembat dhe u përpoqa të këcej nga ferra në remë. Qe e pamundur. Ferra nuk më lëshoi.

Kokoneshi qeshte gjithmonë dhe, herë më lëvdohej se më zuri, herë i bënte zë Jonit, një shërbëtor i tjetër të manastirit, që priste drizë n'ja dy ara më poshtë.

Mezi më nxorën nga gjembat, duke prerë ferrën me kizë. Kokoneshi më kapi nga dora dhe më kot u përpoqa t'i shpëtoj. Trembesha se mos më shpjerë tek im atë. Po ai më tërhoqi dhe më shpuri nën ata fiqtë e mëdhenj ku lahej vetë.

— Xhvishu e lahu! më urdhëroi.

Unë u xhvesha e u lava. Ujë të ftohtë më pastroi të gërvishturat e më uli dhimbjet.

Kokoneshi qëronte nga gjembat pantallonat e këmishën time dhe, kur gjente ndonjë vend të çjerë në to, ia bënte «cë-cë» me keqardhje. Më këshi-llonte:

— More vesh? Në fiq të lartë të mos hipësh më! Po sikur të mos kishte qenë ferra përposh? Bobo! vinte ai duart në kokë, vërtet i tmeruar.

Dhe gudulisej kaq shumë Kokoneshi kur lahesha unë, sa niste e thërriste sikur të lahej vetë:

— Hahaha! Hahaha!

Tregim i gjashtëmbëdhjetë

TE MULLIRI NËN BAÇE

Shën Joni është një nga vendet më të dashura të elbasanasve. Dhe një prej këndeve më të dashura të tij është mulliri nën baçe.

Kënd i qetë, i gjelbëruar, i freskët. Nga lart, — baçja me lule pas konaqeve të mëdha të manastirit. Nga poshtë, — duhanore e misra. E përcjellë nga zëri i trokashkave dhe e shkumëzuar prej mullirit, rema vijon përbri arave udhën e saj drejt Rrapave të Pashës, jetër teferiç 1 i njohur i Elbasanit. Buzë remës, — një sërë karatane të ngarkuara me pjergulla, ndonjë fik e shegë, një sërë plepa.

Përkrah mullirit, ishte një man i vogël. Aty i pëlqente shpesh tim eti të dalë pasdrekeve, sapo dielli bëhej gati të zhduket pas maleve të Kërrabës.

1) Teferiç, vend për piknike e shetitje.

Aty, ai e kishte zakon të qëndrojë vetëm gjer vonë, të dëgjojë ujët gurgullues dhe trokashkat që të shtijen në ëndërrime, apo të bisedojë me mullisin për punë të qëmoçme.

Kur ishte vetëm, im atë ia mirrte ndonjë këngë të vjetër me zë pak. Kur ishte me mua, qëllonte edhe të më harrojë fare e t'ia thotë këngës, dhe unë ta ndjek, së pari me mend e pastaj me zërin tim të hollë. Babai më diktonte e më shtrëngonte në krahë. Dhe ashtu, at e bir, këndonim të shoqëruar nga gurgullima e ujit e nga trokashkat.

Një mbrëmje, tek po nisnin të ndizen në qiell yjtë e parë, babai e këputi në mes këngën e tij më të dashur.

*Rashë e vojta ranës detit,
mendja m'u ka ba veri...*

E këputi këngën në mes, më shtrëngoi edhe më shumë pas vetes, heshti një copëherë të gjatë e tha:

— E di mor bir, se këtu e la Kristoforidhi amanet që ta varrosin?

Im atë fliste shpesh për Kristoforidhin. Për të ai kishte botuar edhe një libër të vogël në vitet e fundit të sundimit turk. Kristoforidhi kishte qenë daja i nënës së tim eti. Stërgjyshja ime pra dhe ai, kishin qenë motër e vëlla.

Vitet e prasme të jetës së tij, Kristoforidhi i kaloi në Elbasan. Ai bëri mësimet e mesme në Janinë e në Maltë, dhe në Angli shkollën e lartë; pastaj punoi disa vjet mësues në Tunis, ku edhe u martua. Kristoforidhi ndejti shumë vjet në Stamboll. Këtu botoi librat e tij shqipe e erdhi herë pas here

në atdhe. Ka qenë pak kohë dy herë mësues në Tiranë dhe më vonë u vendos në Elbasan. Në qytetin e lindjes, punoi si mësues dhe fundi si gjykatës i paqit. Atje edhe vdiq më 1895, jo kaq i shkuar në moshë, rreth gjashtëdhjetë-gjashtëdhjetë e dy vjeç.

Kur mbylli sytë Kristoforidhi, im atë ishte dymbëdhjetë vjeç, tamam sa unë atyre pushimeve që po kalonim në Shën Jon.

Kristoforidhi qe fort i shkueshëm. Njerëzia e kishin nder e për nder jo vetëm se qe i ditur dhe i kishte sjellë shërbime të mëdha Shqipërisë, duke punuar gjuhën dhe duke marrë pjesë në lëvizjen patriotike, po dhe se qe fort i dashur me të gjithë. Ai qe gojëmbël, i qeshur, me shakanë te buza dhe shumë i gjindshëm. Miqtë e tij më të afërtë, qenë njerzit e thjeshtë të popullit.

Vinte shpesh Kristoforidhi te e mbesa, ime gjy-she Katerina. Ngjiste shkallët ngadalëngadalë dhe e pyeste me zërin e tij të trashë:

— A je këtu, moj Katerinë? Këtu je, moj bijë?

Mbesa e priste dajën me shend të madh, i shtronte minderin te çardhaku, i nxirrte rakinë dhe i bënte kafënë. Për të, sado e varfër që ishte, Katerina blinte dhe ruante rakinë ku të qe më e mira.

Fëmijët i grumbulloheshin Kristoforidhit përrreth e kush ta gëzonte më shumë. Më i vogli, im atë, i ulej te prehri. Ai i përkëdhelte e i puthte të vegjëlit:

— Nuset e dajës! Trimat e dajës!

Dhe u tregonte historira e përralla. Tregonte aq bukur, sa vinte veshin e dëgjonte dhe Katerina. E kishte zakon të rrëfejë për Skënderbeun dhe luf-

tat e tij, — për «Skënderbe luftëtarin, trimin e madh shqipëtarin», si ç'ka shkruar ai. Rrëfente për Gutenbergun, shpiksin gjerman të shtypëshkronjës. Fliste për udhëtimet e veta të shumta, që nga Rusia në Angli, që nga Tunizi në Stamboll. Djëmve u thosh të bëhen të ditur, se dituria u çel sytë dhe i çon përpara. Vajzat i këshillonte të venë edhe ato në shkollë.

Në shkollat greke që kishte ahere Elbasani, po niste të mësojë edhe ndonjë vajzë. Kristoforidhi e çmonte shumë këtë gjë. Bijën e tij të madhe, Anastasinë, ai e kishte dërguar të ndjekë mësimet e mesme në Rumani. Anastasia u bë më vonë mësuese në Berat, ku edhe vdiq disa vjet përpara t'et.

Kristoforidhi pat fatkeqësi të shumta familjare: i vdiqën disa fëmijë. Po ai nuk e jepte veten. Jetës i bënte ballë me karakterin e tij të vullnetshëm dhe të qeshur. Me gjithë atë, fatkeqësitë i ngjanë në prak të pleqërisë, kur nisi të drobitet dhe kur vuante ekonomikisht. Sado që u bëri ballë si burrë, prapë se prapë, ato diçka ia shkurtuan ditët.

I ra së fundi një sëmundje e rëndë, e cila e mundi disa muaj. Para se të vdesi, e la amanet që ta varrosin në Shën Jon, pranë mullirit.

Shën Joni ishte një vend shumë i dashur për të. Dhe ky mulliri në bahçe, duket se e tërhiqte fort. Vinte aty shpesh Kristoforidhi, duke u nisur nga Elbasani më këmbë ulej pranë mullirit dhe ia shtronte muhabetit me njerzit që gjente. Mbante vesh gjuhën e tyre, shënonte fjalët ose shprehjet e rralla dhe të bukura që ata thoshin, u jepte përgjigje pyetjeve që i bënin.

Ai e kishte zakon t'u shpjegojë njerëzve se si

është ndërtuar bota, se ç'janë yjtë, se si vërtiten dielli dhe hëna, përse ka dimër e verë, si shkaktohen tërmetet dhe të tilla gjëra, që të paditurit i shpjegojnë si punë të Perëndisë. Kristoforidhi i ndihmonte kështu njerzit të fitojnë një fije dituri dhe luftonte besimet e kota.

Kur gjendej vetëm te mulliri, Kristoforidhi ia thoshte ndonjë kënge të vjetër. Ahere, cilido që kalonte andej, ndalte çapin ose kthente udhën, që të mos e çqetësojë. Im atë tregonte se kish zë të bukur dhe se këngët e vjetra i dinte mirë.

Ishte dashuruar edhe Kristoforidhi me viset e Shën Jonit. Dhe atë këndin te mulliri e kishte bërë ca si këndin e tij. Andaj edhe e la me porosi që aty ta varrosin.

Po, tregonte im atë, ato dit që vdiq Kristoforidhi, në fillim të marsit, ra një shi gjerbë qiejsh. U bë kështu e pamundur që ta shpien në Shën Jon. Kristoforidhin e varrosën te oborri i kishës së lagjes sonë Kala.

I madh e i vogël, të krishterë e myslimanë, me gjithë shiun që binte, erdhën të shtien në dhe njeriun e tyre më të dashur e më të nderuar, të cilin ata e quanin «baba të gjuhës shqipe». U detyruan të vinë edhe qeveritarët turq.

Nxënësi i Kristoforidhit, Tushi i Pinës, një mësues i ri dhe patriot i flaktë, e nisi kështu fjalën që mbajti, kur i dha përshëndetjen e fundit të vdekurit:

— Qani ju male të Shqipërisë për Konstandin Kristoforidhin, babanë e gjuhës shqipe!

Njerëzia panë shoqi-shoqin, të çuditur prej guximit të madh të Tushit, që nuk desh t'ia dijë

për qeveritarët turq. Këta nxinë, ngrysën vetullat dhe ulën kokën. Të rinjtë, që kishin zënë ta mësojnë shqipen fshehurazi, patriotët që humbën mikun e tyre më të shtrenjtë, nuk i përmbajtën lotët.

— Qava edhe unë për dajë Konstandinin, tregonte im atë. — Unë isha akoma i vogël dhe, me gjithë se kisha qejf të dëgjoj mbi Skënderbeun dhe kisha nisur të ëmbëlsohem për të kënduar e shkruar shqip, nuk e kuptoja mirë se ç'ishte për vendin dajë Konstandini, ky njeri kaq i dashur i shtëpisë sonë. Tani, ju fëmijët atë gjë e dini, buzëqeshte mallëngjyeshëm babai dhe më shtrëngonte fort pas vetes. . .

— Ja këtu e la amanet Kristoforidhi që ta varrosin, tha ai dhe tregoi vendin qark e përçark me dorë.

Ujët që gurgullonte, trokashkat e mullirit, u duk sikur pohuan atë çast, edhe ato të mallëngjyera, fjalët e tij.

Pranë nesh, kishte qëndruar mullisi, i zbardhur i tëri nga mielli dhe pleqëria. Mbi vetullat e tij me strehë dhe mbi mustaqet e tij të shtrira, kishte rënë një pah dëbore. Mullisi, që i kishte dëgjuar fjalët e tim eti, tha:

— Besa ashtu, or zotëri. Do ta kishim pasur Konstandinin midis nesh përngaherë. Ç'e do se çfarë burri ka qenë! tundi kokën plaku dhe m'u bë sikur iu mbushën sytë me lot.

Nuk e di përse, po sa herë kam qëndruar më vonë te ai vend kujtimesh, më është dukur se diçka mungone. Vendi është i bukur, i ëmbël, i qeshur mund të thuash. Kështu vërtet. E me gjithë atë, si ujët që gurgullon, si trokashkat, si mani, si hijet e gjelbërimi, të kujtojnë një amanet që s'u mbajt.

Tregim i shtatëmbëdhjetë

OTELLUA DHE ROBERT GISKARDI

Elhe këto janë midis kujtimeve që më pëlqen t'i sjell ndër mend.

Aty nga vitet 1924-1927, në Elbasan erdhi një tri herë një trupë teatrale shetitse e aktorit armen Miran efendi. Nuk mund të them se nga vinte kjo trupë, nga Turqia apo Greqia. Nuk e di nëse artistët shetitnin edhe gjetiu nëpër Shqipëri. Më kujtohet se ata flisnin turqisht dhe se kishin sukses të madh. Unë s'kam lënë çfaqje të tyre pa e parë.

Çfaqjet jepeshin në një kafe të madhe, ku mund të mblidheshin një dy qind vetë. Karrige s'kishte për të gjithë, kështu që një pjesë e spektatorëve shtrohej këmbëkryq. Më kujtohet se qenë shumë të rralla gratë që vinin në teatër, vetëm dhjetë-pesëmbëdhjetë gra nëpunësish.

Trupa e Miran efendiut përbëhej nga pak vetë. Kryeartist ishte Mirani. Ai loste në tërë pjesët rolet

kryesore. Ishte Otello, mbret te drama «Gjenovefa e Brabantit» 1, Makbet e nuk e di ç'tjetër. Ai ishte edhe regjizor edhe piktor.

Miran efendiu i bënte njerzit të qajnë ose të qeshin. Kur dilte si Otello, arap i zi, me një palë vathë të gjatë floriri, me buzë të trasha dhe të kuqe, me dy sy të mëdhenj që të shtireshin natën, kur vërtitej në skenë si ndonjë luan i tërbuar, duke bërtitur e uluritur, njerzit shtrëngoheshin pas shoqi-shoqit dhe nuk dëgjohej asnjë pipëtimë.

— Dushman! bërtiste Otellua në skenë dhe salla dridhej e tëra.

Pa le kur ngrinte thikën e tij të shëndritëshme dhe e fuste atë thikë gjer në dorëz në krahërorin e bardhë si dëborë të Dezdemonës, së shoqes! Nga salla e tërë, dëgjoeshin mërmëritje tmeri, ah-e, mos-e, aman-e, që Desdemona vetë nuk ishte e zonja t'i lëshonte më të llahtarëshme.

— Aman, mos e vra!

— Mos!

Një herë, kur theri Otellua Dezdemonën, një zonje i ra të fiktë në sallë dhe u bë pështjellim i madh. Më kujtohet se pat njerëz që thanë se Otellua nuk duhej ta vriste Dezdemonën: ai po i prishte botës gjakun. U vendos bile që fëmijët të mos i qasin më në teatër, po nuk qe një punë. Rregullin e prishi i pari prefekti, pastaj ndonjë nëpunës tjetër dhe kështu me radhë.

Kur bëhej karagjoz Mirani, salla nuk e përmbante dot të qeshurën. Nuk më harrohet kurrë një skeç i tij. Këtë skeç, Mirani e kishte zakon ta

1) Gjenovefa e Brabantit është një dramë e shkrimtarit gjerman Kristof Shmid (shekulli XIX).

lozë tamam pas Otellos, sigurisht që t'ua sillte një-rëzve zemrat në vend, pas llahtarës që kishin pë-suar.

Në skenë, hynte një efendi i veshur spic. Emrin e aktorit nuk e mbaj mend. Ai ulej mbi një karrige dhe Mirani ulej mbi një karrige tjetër përballë tij, duke u kthyer spektatorëve shpinën. Pastaj, Mirani merrte një karton, dy-tri penela, bojë, dhe bënte portretin e efendiut. Ky krekozej fort, me mustaqen si bisht miu përppjetë, me një fes të kuq dy pëllëmbë të lartë, vënë më sy, me një jakë të ngrirë dhe shumë të gjerë, që ia tregonte qa-fën dy herë më të gjatë se ç'e kish.

Pa nisur mirë të pikturonte Mirani, tërë salla ia kriste gazit, nga mënyra se si ai e ulte efendiun mbi karrike, sikur të ishte ndonjë berber ose ndonjë fotograf. Efendiu u bindej tërë urdhërave të tij, po herë i binte fesi përtoqë, herë i shtrembërohej mustaqja përppjetë, herë i shkëputej jaka e ngrirë nga këmisha dhe i ngjitej me aq forcë lart, sa i kërcisnin nofullat.

Së fundi, pas tërë këtyre përgatitjeve, Mirani ulej në karrigen e tij. Po ulej aq për zgrip, sa, domosdo, rrëzohej dhe shtrihej në skenë sa gjatë gjerë. Të qeshurat këtë radhë arrinin kulmin.

Pas pesë qind belash të tilla, më në fund, Mirani fillonte të pikturojë. Kartonin e mbante në të tillë mënyrë, që salla të shihte se ç'po bën. Ai e niste punën që poshtë. Pikturonte një si kravatë, po, duke i shtuar edhe dy-tri vija, kravata bëhej zile!

Kriste gazi. Mirani kthente kokën nga spektatorët dhe u shkelte syun. Gazi bëhej edhe më i madh. Efendiu që pozonte, zemërohej, ngrihej dhe

bërtiste nëpër skenë, si një i marrë. Mirani mezi e ulte dhe mezi e bënte të pozojë si më parë.

Këtë radhë, ai e niste punën që lart. Vizatonet dy si veshë të mëdhenj e me majë, pastaj dy sy të vëngër që shikonin njëri-tjetrin me inat.

Gjatë kësaj kohe, i pispillosuri që pozonte, i vëngëronte keq sytë dhe salla ia kryste gazit edhe më fort. Ai ngrihej e marrosej dhe një herë nëpër skenë, Mirani u lutej spektatorëve të rrinë të qetë, se mos po i ikën myshteri dhe, pas kaq të luturash, efendiu ulej e pozonte përsëri.

Më së fundi, Mirani e mbaronte portretin, me katër-pesë vija të shpejta. Në karton, vizatohej një gomar i vëngëruar me zile.

Gazi ishte i papërmbajtshëm dhe salla ngrihej e tëra në këmbë e duartrokiste, sidomos kur efendiu i pikturuar protestonte se e kishte bërë Mirani mushkë me zile, kurse ky thoshte se nuk e kishte bërë mushkë, po gomar me zile. — Në sallë, kish-te gjithmonë njerëz që i shpjegonin këto gjëra me zë të lartë...

Rolin e Dezdemonës, po kështu edhe rolin e Gjenovefës së Brabantit, e loste e shoqja e Miranit, e cila më duket se quhej Fatma.

Mirani ishte i zi dhe hundëzhgabonjë, i thatë e i gjatë. Fatmaja ishte e shkurtër dhe shumë e trashë, me ca llërë si trarë, me një gushë me pesë rrathë. Ishte e bardhë, me tipare pisë të zeza. Kur loste, i shkonin djersët çurg.

Kur bëhej Dezdemonë ose Gjenovefë, ajo vinte flokë të artë dhe dukej shumë e shëmtuar. Të pakën, mua nuk më pëlqente fare, sikur ta dije se Dezdemonë ose Gjenovefa duhej të ishte një nuse

delikate dhe fort e re. Po i tmerëshmi arap i Venedikut Otellua, që vërtitej si luarë në skenë, ai Jagoja shpirtkazmë, rolin e të cilit e loste bukur efendi. Oç Mirani e pikturonte si gomar me zile, tërë këto bënin të mos vihen re fort të metat e Fatmasë.

Zëre se në skenë nuk kishte Dezdemonë fare, me gjithë se Dezdemona ishte që ta çaje katërsh. Dezdemorën nuk e vinte re njeri. Ndonjëherë ia qanir hallin, kur dërsinte.

Trupa e Miran efendiut kishte edhe një «yll». Ky «yll» ishte Margarita, vajzë katër-pesëmbëdhjetë vjeçe, edhe ajo armene ezmere, me një shtat të derdhur, mezin si unazë dhe sytë si të mëshqerrës.

Margarita loste rolin e djalit të Gjenovefës, e veshur me fletë pylli. Kur dilte në skenë, ne mah-niteshim dhe mbanim frymën. Kur fliste me t'ëmën, ne mbushnim sytë me lot dhe Gjenovefën as që e vinte re njeri, edhe sikur të dërsinte.

Mjeshtëria e madhe e Margaritës, ishte të këcyerit. Ajo dilte në skenë e veshur me tyl të bardhë, si një flutur e vërtetë, dhe ne shastisnim pas lëvizjeve të saj. Herë të tjera, artistja vishej me çitjanë, vinte një fes të qendisur, të ngarkuar me florinj, dhe kërcente duke përdredhur belin e qafën, duke kërcitur gishtat. Ahere, salla e tërë përpiquej të kërcasë gishtat si Margarita dhe ia bënte «hopa, hopa».

Kjo ishte trupa e Miran efendiut...

Nuk e di përse Mirani me trupën e vet nuk erdhi më në Elbasan. Po më kujtohet se, atë mot që ai nuk erdhi më, djemtë e normales vunë në skenë një tragjedi me emrin «Robert Giskardi».

Robert Giskardi na paske qenë një princ nor-

mand nga Franca, aty e nëntë qind vjet më pare, që paske pushtuar Shqipërinë, në luftë me perandorin e Bizantit. Në tragjedi, ai binte në dashuri me një shqiptare dhe e vrisnin.

Normalisti që loste rolin e Robert Giskardit, tregonte kaq zell, sa, kur vritej me shpatë nga rivali i tij, binte në skenë si një trung dhe dërmohej me të vërtetë. Për këtë gjë, e admironin të gjithë.

— Sa bukur e lot! Dërmohet i gjallë, i shkreti!

Po ja se ç'ngjau një ditë: Robert Giskardi e lojti kaq mirë rolin e tij, sa u këput e ra me sa fuqi pat dhe koka ia bëri dang pas një binari të skenës. Binari doli vendit, skena u tund si prej tërmetit dhe u shemb e gjitha mbi Robertin.

Spektatorët u gjendën në këmbë, të shastisur. Po dikush nisi të duartrokasë, duke pandehur se kështu duhej të mbaronte pjesa, me përmbysjen e skenës dhe jo me mbylljen e perdes. Robert Giskardi i shkretë rënkonte nën pëlhura dhe nën binarë të skenës dhe gjaku i shkonte çurg.

Më në fund, njerzit morën vesh se ç'ngjau. Dikush tha:

— Ç'ke me Miran efendiun! Ai ia ngulte të shoqes thikën mu në krahëror dhe nuk i dilte një pikë gjak!

— Po ai e kishte thikën prej karte, mor tutkun! ia pat njëri.

— Mos ore! Unë kujtoja se bënte sir, 1, qerrat! u çudit tjetri.

Kështu me teatrin e qëmotit.

1) Sir, lloj magjie.

Tregim i tetëmbëdhjetë

P È R M A L L I M E

Ka qenë shumë e vështirë për mua që të ndahem nga prindët. Shtatorin e vitit 1927 e prita me gëzim dhe kureshtë: do të shkoja në shkollë të mesme, në lice. Po sa më shumë afrohej dita, aq më shumë fillonte të zgjohej tek unë një si ankth. Si do të rroj vetëm? Si do të bëj pa prindët, pa motrat, pa vëllanë? E kuptoja se nuk ishte punë e lehtë, po nuk e bëja veten. Shtatori, pastaj, ishte akoma larg.

Shtatori erdhi. Babai e kishte vendosur të më dërgojë vetë në Korçë. Tani u pa se donte të vijë edhe nëna. Ndërsa mua nuk më shkonte fare kjo ndarje, prindërve të mi u shkonte edhe më pak. U nisëm të tre bashkë. Morëm me vete edhe më të voglin e fëmijëve, një motër që kishte lindur para disa muajsh.

Në Korçë, prindët ndejtën gjithë shtatorin. Mësimet në lice fillonin në tetor. Kështu edhe në normalen e Elbasanit, ku ishte me detyrë im atë. Në fund të muajit, babai dhe nëna i hypën automobilit dhe më lanë vetëm, në internat.

Njeriu nuk është kurrë vetëm në një internat. Dhe ca më pak isha vetëm unë, që kisha disa shokë elbasanas të moshës sime dhe të klasës sime. Ndonjë e kisha dhe kushëri. Me gjithë atë, e ndjeja veten kaq vetëm, sa nuk tregohet. Qaja natë, qaja ditë. Qaja në shtrat, qaja në dhomën e studimit, qaja në rrugë, qaja në klasë. Asgjë nuk më ngushullonte. Asgjë nuk e mbushte boshin që kishte bërë familja.

Im atë, që e dinte se nuk do të mësohem lehtë larg shtëpisë, më thërriste dy herë javën në telefon, të mërkurë dhe të dielë. Ndonjëherë dilte në telefon edhe nëna ose ime motër e madhja. Unë isha i dëshiruar të dëgjoj zërin e tyre. Më kujtohet si tani, se i shkrova një herë babait, që kam harruar zërin e motrës. Se sa e vërtetë ishte kjo, nuk e them dot dhe tani nuk e besoj. Po ahëre kështu më dukej, kështu besoja.

Ato takime përmes telit, në vend që të më bëjnë në mirë, ma shtonin mallëngjimin, m'i shtonin lotët.

Gjer në moshën dy-trembëdhjetë vjeç, s'kam qenë kaq mirë me shëndet. Edhe pse isha i rritur dhe sëmundje të rënda nuk kisha hequr, edhe pse isha i guximshëm e i shkathët, malarja, që ka qenë shumë e përhapur në Elbasan, s'më kishte lënë asnjëherë rehat. Një farë të zbeti nuk largohej kurrë prej fytyrës sime. Oreksi më prishej për asgjë dhe isha ngrënëkeq.

Kështu, ca nga mallëngjimi, ca se gjellëve të internatit u bëja buzë, fillova të dobësohem shpejt. Ata muajt e parë të vitit, më shumë i kalova në shtrat, se në shkollë. Më ra edhe të verdhit e më bëri lakër.

Im atë erdhi e më pa në nëndor, u merakos shumë dhe, për pak, desh më mori me vete. Po, me gjithë se unë akoma nuk isha mësuar pa printëdet, sedrën e kisha të madhe. Pastaj, me sa më kujtohet, e kuptoja dëmin që do t'i shkaktoj vetes duke lënë për një kohë shkollën. Mendova se pushimet e Kërshëndelleve ishin pranë, e bëra zemrën gur e i thashë babait të kthehet në Elbasan, duke i dhënë fjalën se nuk do të qaj më, se fasulet e makaronat do t'i ha, se fanellën e leshit nuk do ta heq më.

Ah, ajo fanellë! Që kur isha plevitosur një herë përgjysëm në Shelcan të Shpatit, nëna më vishte fanelle leshi në misht, fanelle të trasha me lesh vendi, si ata pancirët e ushtarve të së lashtit.

Babai u nis, po unë nuk mbajta asnjë nga premtimet. Qava po njësoj, nuk hëngra asgjë dhe, sa për fanellën, isha betuar me vete, se, ta di që të vdes, fanellë nuk mbaj më. Dhe prita pushimet e Kërshëndelleve, duke i numëruar ditët me koqe misri, si thonë.

Atë mot, në Korçë bëri një dimër i madh. E jo vetëm në Korçë. Udhët u prenë kaq herë dhe nuk ishin të sigurta. Po unë s'desha t'ia di. U nisa. U nisa bashkë me një mësues elbasanas, që mori përsipër të më ketë kujdes, dhe me një dy shokë të tjerë elbasanas, më të rritur se vetja.

Kush e di sa ura i gjetëm të prishura. Kush e

di sa herë kaluam në va. Vetura jonë qëlloi vërtet e fortë. Më të dalë të Librazhdit, kamionët e kishin thelluar shumë udhën me rrotat e tyre të larta. Vendi kishte ngrirë tani dhe balestrat e veturës takonin në dhe. Na u desh të punojmë dy-tri orë, që të thyejmë akullin dhe të mbushim gropat. Duart na u bënë si copa akulli vetë.

Ca më tej, urën e Mirakës, mbi Shkumbin, nuk e gjetëm fare. Në vend të urës kishin mbetur disa trarë, që e kapërxejnë lumin tejpertej. Ecëm mbi trarët, si pelivanë, sipër ujit të turbullt e të rrëmbyer. Sa për veturën, trimëresha jonë veturë e kaloi lumin në va. Va i thënçin. Vetura, këtë radhë, u bë varkë e vërtetë dhe kot shpëtoi e nuk e mori ujët.

Kaluam! Shpëtuam! — Kështu thamë. Po vuajtjet tona s'kishin të mbaruar. Se ja, filloi një shi me stomna dhe rrëketë e maleve zunë të zbrerin nga të katër anët, si të shkalluara. Kur arritëm në Xibërrakë, një fshat nj'a tri orë më këmbë nga Elbasani, përroi i atjeshëm, i gjerë thua sa gjysma e Shkumbinit, kishte ardhur majë më majë. Ishte natë. Ishte errët pus. Ne nuk shikonim asgjë. Po poterja e madhe që bënte përroi i Xibërrakës, të shtinte datën. Thua se po shembeshin malet, po batisnin qiejt, po bëhej kataklizma. —

Atë natë e kaluam në një shtëpi jo larg përroit. Na pritën e na nderuan me gjithë të mirat, si ç'e ka zakon shqiptari: me pula të pjekura dhe me ëmbëlsirë. Më kujtohet se na bënë hasude. Nuk e harroj atë pritje. Shtëpia ishte plot kalamanj të vegjël.

Sa herë më bie puna të kaloj tani andej, e

shoh me mallëngjim atë shtëpi të gjatë, midis një çairi të madh. Shtëpia s'ka ndryshuar fare, të thuash. Disa burra lërojnë arat ose merren me ndonjë punë tjetër aty rrotull. Nusët e tyre vërtiten në oborr ose në çair. Vocërrakët e dikurshëm u bënë burra dhe u martuan. Vocërrakë të tjerë, dhe të shumtë, që u ngjasin krejt atyre të tridhjetë viteve më parë, mund të shohësh udhës e gjerdheve. Disa me çanta në sup, venë në shkollë ose kthehen nga shkolla...

Gjyshit e tyre, të nesërmen e asaj dite shëndreu të vitit 1927, na kanë kaluar përroin e gjerë të Xibërrakës, duke na marrë mbi kurriz. Kisha qejf të shoh mësuesin tim hypur mbi shpatullat e një xibërrakasi, dhe më qeshej. Edhe atij i qeshej dhe, në mes të ujit, plasi një gaz i madh, me gjithë se përroi ishte akoma i egërsuar dhe kalimi ynë nuk ishte pa rrezik.

Matanë ujit na priste një veturë e ardhur nga Elbasani. Nuk e di se si u lajmërua Elbasani që të na dërgonte një maqinë tjetër. Ndofta e vuri veten në rrezik ndonjë fshatar dhe shkoi natën në qytet. Maqinën e parë e lamë midis dy ujrash se edhe Shkumbini s'mund të kalohej më në va në Mirakë, sikur të donte vetura të kthehej prapë për Korçë. Ne arritëm në Elbasan shëndoshë e mirë, natën.

Asnjëri nuk kishte dalë të më prisi. Unë nuk kisha lajmëruar se jam nisur. Binte një shi rrus-gjerë. Asnjë fener nuk ishte ndezur. Ahere, Elbasani kishte ndonjë fener të rrallë nëpër udhë, fener me vajguri, se elektrik akoma s'kish. Përparë shtëpisë po ndreqnin një mur. U shemba mbi një kukumale balte.

Nisa të thërras e të bërtas. Më dëgjuan, zbritën me llamba në duar dhemezi më ngritën nga balta. Dhe ashtu të lerosur e të katranosur, më puthën e më përqaftuan, — kush të qajë, po dhe kush të qeshë më fort.

Ç't'ju tregoj për atë javë që ndejta në shtëpi? Nuk tregohet lumtëria ime. Më erdhi oreksi, nisën të më skuqin faqet. Dhe java iku aq shpejt sa nuk u pa si iku. Duhej lënë shtëpia! Duhej lënë Elbasani me gjithëçka kisha të dashur! Duhej marrë edhe një herë ajo udhë e gjatë drejt dimrit të madh të Korçës, drejt vetmisë!

Automobili nuk punonte në Qukës. Shkumbini kishte ardhur trap më trap dhe s'kishte lënë urë në këmbë. Gjer në Qukës, duhej të shkonim me kalë, nga udha e vjetër e karvaneve, përmbi urën e Kamarës, nëpër Shuloret e Babjes e nëpër Xhyrë, — vise të cilat i kujtoja gjithëmonë me mallëngjim. Unë tani kisha mësuar në shkollë se kjo ishte rruga e famëshme Egnatia, ndërtuar nga romakët dy mijë vjet më parë dhe që të çonte prej Durrësi në Bizant, në Stambollin e sotmë.

U nisëm. Dhe a' e dini se me cilin u nisëm? Me Hysë qiraxhiun!

Edhe tani që u hap udha e automobilin për Korçë, Hysa nuk i kishte lënë kuajt. Karvani i tij punonte herë Peshkopinë, herë Beratin. Ja, për fat të Hysës, qëlloi të prishet edhe udh' e Korçës. Qiraxhiu, me gëzim të madh, e nisi karvanin për Qukës.

Ai karvan që më parë numuronte dymbëdhjetë kafshë, tani kishte vetëm katër. Ndër'kuajt e vjetër, kishte mbetur vetëm gjoku, të cilit po unë i hypa këtë herë.

Kishte ndryshuar karvani i Hysës, ishte zvo-
gëluar shumë. Po këmborët e kuajve ishin po ato.
Me ato këmborë, u nisëm për Qukës dhe tingulli
tyre më zgjoi një qind kujtime të ëmbëla.

Hysa, që dhe ai nuk kishte ndryshuar, ngiste
gjokun dhe tregonte pa pushim historira qira-
xhinjsh. Mësuesi im, mësues i shqipës, nxirrte he-
rë pas here një radhua të vogël nga xhepi dhe 'shë-
nonte ndonjë fjalë. Duhet ta kishte gjuhën të pasur
qiraxhiu.

Kur do të arrinim te Shkalla e Mirakës, filloi
një erë e marrë. Nuk ishte e mundur të qëndroje
majë kalit dhe u detyruam të zbresim. Era frynte
në drejtim të kundërt. Unë kisha një pelerinë të
zezë prej internatisti. Atë ma hapte era, si çadëre.
Mezi bëja ndonjë çap, edhe pse ecja pas Hysës,
që më mbronte me trupin e tij të madh. Qiraxhiu
u bërtiste dhe u jepte zemër kuajve, që, edhe ata,
mezi e çanin udhën nëpër furtunë. Shkumbini,
kush e di sa metra poshtë nesh, bënte një potere
të lemerishme.

Majë Shkallës së Mirakës, tamam te kthesa,
pelerina ime u hap e tëra dhe era gati më ngriti
nga dheu, më vuri përpara, më rrëmbeu. Për një
grimë më hodhi në lumë që nga maja e shkëmbit,
po të mos më kishte zënë Hysa nga cepi i pelerinës.
Që jam gjallë, ia kam jetën borxh atij qiraxhiu dhe
kopsës që kishte qepur nëna te qafa e pelerinës. Me
gjithë forcën e erës, kopsa s'u këput.

Pjesën tjetër të udhës, gjer 'te ura e Kamarës,
Hysa më mbajti prej dorë. Pelerinën ma hoqi e e
lidhi mbi samar të kalit.

Era sa vinte, aq edhe më e marrë bëhej. Hysa lëshoi kuajt përpara mbi urë. 'I shoh si tani ata kuajt mbi harkun e hollë dhe shumë të lartë të urës. I shoh se si çapen me vështirësi të madhe, u shkasin patkojtë, janë gati më të rënë e më t'u gremisur në lumë, po mbahen, qëndrojnë, çapen. Kreshtat e tyre i përhap e i përzjen era dhe duken si krahë, me të cilët kuajt po fluturojnë mbi Shkumbinin e tërbuar.

Sa për ne, ne njerzit nuk e kaluam urën në mënyrë aq trimërore, po barkazi, rrëshqanthi. Hysa më kishte zënë nga njëra sjetull dhe më tërhiqte si ndonjë thes. Era vërshtëllente, ne tërhiqeshim zvarrë mbi kalldrëmin e urës, Shkumbini tërbohej atje poshtë, si në fund të një humnere.

Kaluam! Udha matanë ishte më e mbrojtur nga era dhe ne u hypëm kuajve, përveç mësuesit, që kishte qejf të shkojë më këmbë përpara. Kalit të tij i hypi Hysa...

Atë natë, te hani i Qukësit u ndez një zjarr i madh bubulak. Hysa dhe mësuesi pinë këmbëkryq nga një faqore me raki dhe ua thanë këngëve të vjetra. Unë u shkova pas, me sa munda.

Hysa dhe mësuesi pinë gjer më të aguar. Mua më zuri gjumi pranë zjarrit, me kokën mbështetur te një samar. Në ëndërr, shikoja një qytet me 999 minare. Kjo që Xhyra, e cila, sipas përrallës, kishte vetëm 99 minare, — Xhyra që ne kishim parë asaj dite, me shkëmbenjtë e lartë, ku bëjnë çerdhen pëtritët.

Të nesërmen, i hypëm një maqine për Korçë.

Më kujtohet se sa pa qejf u ndamë nga Hysa. Ai nuk deshë të kthehet në Elbasan, po u nis për

Korçë. Na u lut të shkojmë me të. Po duhej të bënim dy ditë udhë me kalë, kurse me automobil arrinim për tri-katër orë.

Kishte ndryshuar shumë kjo botë, thoshte Hysa me trishtim. Prapë se prapë, udhëtim më të sigurt nuk mund të bëjë njeriu, përveçse me «tabanopil», si u thoshte ai këmbëve.

Të pakën atë ditë, Hysa pat të drejtë. Automobili na u prish më të hyrë të Pogradecit dhe natën e kaluam në Pogradec te një mik elbasanas. Vetëm të nesërmen në mëngjez, arritëm në Korçë, me një makinë tjetër...

Pas katër ditësh. Hysa erdhi e më gjet në internat. Më pa se isha mirë me shëndet, më kërkoi të bëj një letër për babanë, mori letrën, më dha dorën e u nis. E përçolla te udha e, që ahëre, nuk e kam parë më. Kush e di se ç'u bë, sa rroi akoma, kur dhe ku vdiq. Mbase dhe është gjallë.

Kur hyra brenda në internat, portjeri më dha një trastë të madhe qiraxhinjsh. Trasta ishte plot me portokaj. I kishte lënë Hysa për mua. Ngashërimi më pushtoi të tërin dhe ia shkrepë të qarit. Ata portokaj nuk ishin vetëm miqësia e Hysës, po dhe Elbasani me gjithëcka kish.

N A P A E B A R D H Ë

U në e bëra zakon që Kërshëndellet t'i kaloj në Elbasan. Nuk ia përtoja udhës e nuk druhesha dimrit. Kështu bëra të katër-pesë vitet e para që mësova në lice të Korçës.

Atyre Kërshëndelleve të vitit 1929, familjen e gjeta të rritur. Tamam javës që unë u nisa për Korçë, në mbarim të shtatorit, më lindi një vëlla. Im atë më lajmëroi me telegram dhe unë e prisja me kureshtë dhe padurim të madh pushimin e tremujorit të parë, që të shoh vëllanë e panjohur.

Emrin ia kishin vënë Robert. Ishte e modës që fëmijëve t'u venë emra të huaj në Elbasan. U bënë kështu plot Robertë, Ferdinandë, Frederikë etj, në qytetin tonë. Modës nuk i shpëtoi as im atë, as nuni ynë, me gjithë se të dy ishin mësues të shqipes...

Asaj dite dhjetori në Elbasan arritëm vonë. Unë mora nëpër terr udhën e shtëpisë. Kur po afrohesha, u ndala dy-tri herë e mbajta vesh se mos dëgjoj ndonjë të qarë fëmije. Te dera, u ndala gjatë.

Lart, dëgjohej një djep që tundej. Zëri i nënës e përcillte trokëllitjen e djepit me një ninull të lehtë.

Më dukej se, po të trokas, do t'i prish gjumin kërthiut. Ngadalë, tërhoqa sixhimin dhe llozi i derës u hap me një kërcitje të vogël. Nuk dëgjoji njeri. Hyra, kapërxeva oborrin dhe nisa të ngjitet shkallët në majë të gishtave. Po shkallët tona të vjetra kërcitën aq shumë, sa nëna i ndjeu dhe i foli babait:

-- Pa shih se kush po vjen.

Ahere, unë i këceva dy e nga dy shkallarët.

Ne përqafoheshim përjashta, te çardhaku, fëmija qante në dhomën matanë, se bëhej zhurmë dhe nuk po e tundnin. Nëna tha:

— Qan Roberti. Është bërë gjithë ai djalë. Eja ta shohësh.

Nuk e di se si, po më hypi një turp i madh e nuk desha që nuk desha ta shoh. Qëndroja në një cep të dhomës, pranë tagarit prej bakri të kuqërremtë, u përgjigjesha me zë pak pyetjeve të shumta të babait për shëndetin, udhëtimin, mësimet. — dhe, me bishtin e syrit, vështroja nga djepi i mbuluar me një napë të bardhë.

Kur e kur, nëna e ngrinte napën që të shohë se a po fle fëmija. Ahere, dukej një kokëz sa një grusht, më shumë e kuqe se e bardhë, me një si push të verdhë përsipër, me një hundë pak si të shtypur. M'u duk i shëmtuar ai fëmi dhe nuk më erdhi mirë.

Po s'qe ashtu. Roberti ishte një djalë i bëshëm, tërë shëndet, shumë i lëvizshëm, edhe pse akoma shumë i vogël, tre muajsh. Ai ishte në atë kohë, kur fëmijët nisin të bëhen të vëmendëshëm, kur nisin

të njohin nënën dhe të afërmit, të ndjekin me sy lëvizjet, të belbëzojnë diçka.

Roberti kishte dy sy të kaltër, më të shumtën e herës të çuditur, po dhe të qeshur. Lëpihej me një gjuhëz të kuqe e të hollë si të maçokut. Një çikë ta prekje me majë të gishtit mbi mjekër ose faqe, fytyra e gjithë i çilej dhe i qeshte. Po ishte mësuar keq me të tundur.

Tani, familja jonë kishte katër fëmijë që po rriteshin, dhe kush ta tundte më shumë të voglin. Të mos e tundje, qante. Babai, duke dashur të tallet, thosh se do të bëhej grindavec dhe se kishte kujt t'i ngjasë. E vërteta është se unë kam qenë grindavec dhe ato fjalë të babait ishin për mua.

U bëmë miq të ngushtë me Robertin. Më njihte, më qeshte, i pëlqente ta marr në duar dhe, doemos, ta tund. Dhe unë ia bëja tërë vollet.

Kur mbaroi java e pushimeve, kur u ndava nga familja. derdha ca lot më shumë se zakonisht. . .

Iku marsi. Erdhën pushimet e tremujorit të dytë, pushimet e Pashkëve. Unë e kisha bërë zakon që të vete edhe për këto pushime në Elbasan.

Tani, vëllanë e gjeta vërtet goxha djalë. Në fillim, nuk më priti me qejf, se nuk më njohu. Po shpejt u bëmë miq edhe më të ngushtë se në dhjetor. Roberti qeshte plot zërin, si një i madh, shkulej së qeshuri po ta gudulisje. Gudulisej shumë. T'i hidhte doçkat nëpër flokë e nëpër sy, të ndukte dhe të cimbiste, të kafshonte.

Më kujtohet se babai tallej fort me të dhe herë e quante «njerith», herë «këlysh».

Doemos, me të tundurën ishte mësuar keq: po të mos e tundje, ishte ai që tundte shtëpinë.

— Lëre të qajë, se i rritet zemra, thoshte gjyshja.

Mua më dhimbsej dhe e tundja. Po më shumë losja me të, se sa e tundja. Kështu, djali çakërgjosej, i ikte gjumi dhe pastaj qante me të madhet e belbëzonte me inat, se nuk flinte dot.

Merret me mend se sa më e vështirë qe ndarja ime e dytë me Robertin. Ai ishte zgjuar që me natë, si ngaherë. Nëna më përcolli te udha, me të voglin në krahë. Unë u përqafova me të tërë, putha fort vëllaqkon dhe u nisa me sytë plot, ec e kthe kokën.

I vogli belbëzoi dy-tri herë drejt meje, duke lëvizur edhe doçkat. Pastaj, më harroi dhe kush e di se nga hutoi. Në fund të rrugës, ndala një grimë e ktheva dhe një herë kokën nga shtëpia. Nëna ishte te dera dhe ngrinte në duart e saj vogëlushin si një top të bardhë...

Në mbarim të qershorit, unë e prisja me padurim ditën kur do të nisem për shtëpi. Isha bërë edhe merak për familjen, se, tërë atë muaj, s'kisha marrë letër. Gëzimi im i veçantë, ishte se do të shoh vëllanë dhe mikun tim të vogël, Robertin. Kush e di sa do të ishte rritur tani! Fëmijët rriten shpejt.

Në Elbasan arritëm aty më të rënë të ditës. E mora udhën e shtëpisë më shumë padurim. Nxitoja dhe më zihej fryma. Hamalli që më mbante valixhen, mbetej larg pas meje dhe unë i bërtisja dhe më vinte inat i madh se duhej ta pres dhe se më vononte.

Sa më shumë i afrohesha shtëpisë, aq më shumë më rritej një si çqetësim. Dy-tri të njohur që takova rrugës, mezi i përshëndeta. Ata më shihnin

me një vështrim që sikur nuk më pëlqeu. E çqetësimi im rritej.

Te dera, ndalova e vura veshin me ankth. Në shtëpi, nuk dëgjohej asnjë zhurmë, asnjë zë. Atje tej, pas meje, dëgjohej hamalli me çapet e tij të rënda, i kërrusur nën valixhen time të madhe.

Desha të trokas, po nuk më bëri dora. Thashë me vete se do të zgjoj Robertin dhe, në këtë çast, as unë s'di se qysh, më lindi ky mendim i tmershëm:

— Po sikur të ketë vdekur?

Zemra m'u ndal në gji.

Ende s'kisha menduar te vdekja në jetën time prej fëmije. Bile edhe ato kujtime vdekje të familjes sonë, i kisha shumë të largëta. Ato po fillonin të tretën. Më kishte vdekur xhaxhai dhe, fill pas tij, një e bija, kur unë isha akoma dy-tre vjeç dhe s'kuptoja farëgjëje nga jeta.

Se si ma përshkoi trurin ai mendim i tmershëm, as unë s'e di. Po babai, që ishte shumë i rregullt në letërkëmbim, më kishte harruar një muaj të tërë! Pastaj, ata njerëz të njohur që më kishin takuar udhës, se si më vështruan!

Tërhoqa me forcë sixhimin dhe u sula në oborr, duke britur:

— Nëne!

Kur po vija këmbën të ngjitem në çardhak, atje lart, në krye të shkallëve, u duk nëna e trembur. Një napë e bardhë i mbulonte kokën dhe supet.

Unë kuptova gjithëçka dhe ia shkrepva vajit.

Në Elbasan, ahëre, gratë e kishin zakon të mbajnë zi të bardhë, me një napë mbi krye. Roberti kishte vdekur përpara disa ditësh nga barku i verës.

MANDOLINA E BRAKTISUR

Që vitin e parë që shkova në lice, nisa të mësoj mandolinën. Unë do të kisha dashur të mësoj violinën ose, të pakën, kitarën. Po mësuesi ynë nuk e njihte si duhet violinën dhe, për kitarën, i kisha gishtat akoma të shkurtëra. Kitara të vogla nuk kishte. Mësova mandolinën pra. Dhe më hypi një e' tillë dëshirë për të, sa isha gati të lë pas dore mësimet e tjera për t'i rënë mandolinës.

Ishte fundi i vitit, kohë provimesh. M'u desh ta lë veglën muzikore dhe të kem kujdes më shumë mësimet. Po, me të mbaruar provimet, rroka përsëri mandolinën dhe nuk qe një punë që ta lëshoj nga dora, natë ditë.

Fillova të mërzit botën. Se, jo vetëm që nuk kisha mësuar t'i bie ndonjë kënge për të qenë, po bëja ushtrime pas ushtrimesh. Këto ushtrime ishin

të lodhëshme e të mërzitëshme për të tjerët. Për mua, — aspak.

Dhe kjo nuk qe gjë. E madhja qe kur u ktheva për pushime në shtëpi. Shkova drejt e në Pogradec, ku kishte ardhur e gjithë familja për verim. Që më të aguar të ditës e gjer sa bëhej natë e madhe, pesë-gjashtëmbëdhjetë orë me radhë, veç kohës kur lahesha në liqen, mandolina ime nuk pushonte së rëni. S'kishte mundësi të flejë njeri vapës.

Tani, unë kisha filluar të mësoj këngë pas kënge. Më kishin sjellë nga Italia një tok valse, polka e mazurka dhe, çdo ditë mësoja nga një këngë të re. Pas një muaji, nisa nga serenadat, që nga ajo e Tozelit, gjer te ajo e Shubertit, gjithë serenadat me radhë. E pasi mbarova me serenadat, zura këngët e operas, që nga «Vilhelm Teli» i Rosinit, gjer te «Tanhauzeri» i Vagnerit, që nga «Bohema» e Puçinit, gjer te ariet e famëshme të Pergolexit. Në repertorin tim kishin hyrë «Barkarola» e Çajkovskit, «Ëndërrimi» i Shumanit, pjesë nga «Rapsoditë hungareze» të Listit, valcet spanjolle të Albenicit, «Kënga e Solveigut» e Grigut dhe shumë të tjera, — këngë valce, mazurka, marshe, arie, gjer edhe menuete, si menuetet e famëshme të Bokerinit dhe Paderevskit.

Sigurisht, kjo punë nuk u bë për një muaj e dy, për një verë, po gjatë dy-tri viteve. Dhe gjatë këtyre dy-tri viteve, unë mërzita botën të tërë, përveç që rashë edhe nga shëndeti.

U bëra një mandolinist i zoti. Dashuria e muzikës kish ndezur në mua një ndjenjë shumë të madhe, që më pushtoi të tërin. Po shkuan dy-tre vjet dhe nisa të punoj më pak me mandolinën. Tani,

kohën më të madhe ma hante kopjimi i notave. Çdo këngë të re, çdo pjesë muzike të panjohur, e kopjoja. Kisha bërë kështu një koleksion prej shumë qindra këngësh. Edhe kjo punë, sadopak, më pengonte në mësimet. Im atë, nëpër letrat e tij, më tërhiqte vëmendjen se nuk isha i pari i klasës dhe as ndër të parët.

Erdhi dita dhe zjarri im për të mësuar muzikën nisi të fashitet. Flakët e tij të fundit, me sa më kujtohet, kanë qenë disa këngë që bëra vetë, — një valc, një marsh dhe nuk di çfarë tjetër. Valci i pëlqeu një pjanistje të qytetit, po ma kritikoi se kalonte në një vend në oktavë në mënyrë të panatyrshme...

Erdhi dita që unë nuk kopjoja më nota dhe mandolinës i bija më rrallë, kur isha i mërzhitur apo në mbrëmjet e dëfrimit të shkollës, apo kur bënim ndonjë serenadë në liqen të Pogradecit, nën dritën e hënës, me varka.

Së fundi, mandolinën e braktisa fare. Duhet të kem qenë ahëre nj' a gjashtë-shtatëmbëdhjetë vjeç,

Tani, mërzhitesha unë me një tim kushëri që i binte violinës ditë e natë pranë shtëpisë sonë. Ai ishte dhe më i fortë se unë.

Po kishte edhe më të fortë. Ishte Sulejmani, një elbasanas që mësonte në Itali për muzikë. Vegla e tij qe tromba. Kur kthehej për pushime, Sulejmani, që e kishte shtëpinë pranë sahatit të madh, me trombën e tij nuk linte të flejë gjatë vapës gjysmën e qytetit.

Po kishte edhe njerëz që u bënë meraçkinj pas asaj vegle. Drejtori i kinemasë, një kinema e vogël, ku të merrej fryma, e paguante trombistin tonë

që t'i bjerë përpara se të fillojë filmi. Sulejmani u binte pjesëve më të njohura, si serenadave të Tozelit dhe Shubertit, «Endërrimit» të Shumanit dhe sidomos aries së «Toskës» së Puçinit: «Po vdes i dëshpëruar». Këto janë të gjitha pjesë të ëmbëla, melankolike. Po, nëpër trombë, ato buçisnin si mos o Zot! Përplaseshin tingujt e trombës përmbi mure, sikur të luftonin me to për të shpërthyer jashtë, tronditej kinemaja e gjithë nga tromba. Sulejmani frynte bullçitë, kullonte në djersë, po i binte kaq thekshëm trombës, sa, nga sytë e tij, mund të shihje të shkasë ndonjë pikë lot dhe të humbasë nëpër çurgjet e djersës.

Unë kisha mëshirë për të, më shumë se për veshët e mi. Dhe e shikoja të cfilitet nëpër atë pisk vape, duke sjellë ndër mend veten time, kur i bija mandolinës ditë e natë. I fortë kisha qenë dhe unë! . . .

Shkuan vitet pra dhe unë e lashë mandolinën fare. Tani, më kishte gllabëruar një tjetër art. — vjersha.

Një verë, vajta nga Pogradeci në Elbasan për punë. Vajta të fle në shtëpi. Familja ishte e tëra në Pogradec. Ajo shtëpi pa njerëz, pa zhurmë, me dritare të mbyllura, me një erë të rëndë pluhuri, sikur ma lëndoi zemrën. Vetmia më peshoi përbrenda menjëherë. . .

Nuk e di se si, po më shkoi mendja te mandolina. Këceva nga shtrati dhe nisa ta kërkoj. E kërkova shumë dhe, më në fund, e gjeta rrëzë një sobalke.

Aty, midis vjetërsirash, — pjata, shishe, kutia, — qemë dy-tri togje të pluhurosura të kolecioneve

të këngëve që kisha kopjuar vetë. Minjtë kishin bërë punën e tyre, se vendi që plot çikla karte. Përmbi këngët e mbuluara nga pluhuri dhe të brejtura nga minjtë, mandolina ime dukej sikur të që mbërthyer në vend nga fijejt e panumurta të merimangave.

Zoqtë e saj prej fildishi, të shkitur prej dërrasës, mënt po binin përdhe. Sytë e tyre të venitur prej fildishi, m'u duk sikur më shikuan me mall e me qërtim nëpër një vel pluhuri. Përmbi ta, telat e këputura dhe të ndryshkura të mandolinës, vareshin të dredhura dhe të shtrembëruara si mos më keq. Telat kishin heshtur me kohë. Malli i pashuar i këngës i kishte brejtur aq fort, sa i kishte këputur.

Nuk di se si e ndjeva veten. Nuk di se ç'ma vrau zemrën më shumë. Pata turp nga vetja ime, se më ishte vakur aq fort ai mall i madh i muzikës. M'u duk sikur mandolina, me zoqtë e saj të heshitur prej fildishi, me telat e saj të këputura, më qërtonte rëndë e më thosh se i kisha dalë i pabesë. Kishte të drejtë.

Përrjashta, nisi të fryjë dhe të bjerë një shi i rrëmbyer vere. Ishte mes korriku. Kokrrat e breshërit nisën të kërcasin mbi dritare. Ufmi në sobalkë u bë i padurueshëm. Zoqtë e fildishit nisën të më shohin me një sy dhe më të mjerë.

Hapa me të shpejtë dritaren. Kisha nevojë të marr erë. Era hyri në dhomë me aq eshem, sa e bëri vendin duman. Dhe, nëpër atë duman, telat nisën të tringëlljnë me një zë të çjerrë, që nuk tregohet.

Unë dola jashtë, rëmoval dollapët, arkat, kutiat e shtëpisë dhe, më në fund, gjeta një palë tela të reja. Ia vura mandolinës, e kurdisa veglën dhe i rashë.

I rashë «Këngës së Solvejgut» të Grigut, pastaj «Barkarolës» së Çajkovskit, «Valëve të Danubit» të Jovanoviçit, marshit të «Karmenit» të Bizetit. Dhe kështu, duke u nisur nga këngët melankolike e duke përfunduar te këngët më të gëzueshme, mandolina ime u ringjall.

Gishtat më dhembnin, se po bëja kohë që s'i kisha rënë mandolinës, po unë kujtoja këngë pas kënge dhe nuk e lëshoja veglën nga dora.

Gjumi më kapiti vonë, kush e di me çfarë melodie.

Në mëngjez, kur dielli më ra te shtrati, unë u zgjova. Mandolina ishte aty, pranë meje. Zoqtë e fildishit mbaheshin akoma fort pas asaj dhe sytë e tyre, nën rrezet e nxehta, ndriçonin me një gëzim të patregueshëm.

Tregim i njëzetënjëtë

FYELLI I MARSIASIT

Si ç'ju kam treguar, kur ishte duke m'u shuar zjarri për muzikën, nisi të më gllabërojë një tjetër art, — vjersha. Kur them «të më gllabërojë», kjo është fjala e vërtetë. Sikundër i bija dikur mandolinës ditë e natë, tani vjershëroja natë e ditë.

Po tani, nuk mund të qahem më njeri se e mërzitja, si dikur. Vjershat, zakonisht, shkruhen pa zhurmë, — edhe pse ka poetë poterexhinj, të cilët i thërrasin e i bërtasin vargjet e tyre. Dhe sa më shumë t'i thërrasin e t'i bërtasin, aq edhe më të bukura fillojnë t'u duken. Është bela me shumë poetë.

Sidoqoftë, shokët e mi kishin përse të qahen, jo prej zhurmës, po prej heshtjes ime. Unë fillova tani të bëhem më pak i afrueshëm, të përmblihem

në vetvete, të rroj me përfytyrimet e mia e t'i hedh këto në vargje.

Fletoret e vjershave nisën të stivosen në ban-
gon time të studimit në internat dhe në valixhen
time. Mijra vargje të çdo lloji, si dhentë, — ca të
bardha, ca të zeza, ca syska, ca bejka, ca ruda, ca
kaleshe, ca shyta, ca me brirë, do të thoshte poeti
i madh Çajup, po t'i kishte lexuar.

Doemos, mua më pëlqenin. I pëlqenin edhe
ndonjë shokut tim. Disa shokëve të tjerë edhe nuk
u pëlqenin. Do të kisha dashur t'ia tregoj babait,
i cili mund t'i gjykonte me kompetencë, po nuk
guxova menjëherë.

Mbaj mend se, një ditë, pasi kisha lexuar
nuk di cilin poet të vjetërisë, Homerin apo Vir-
gjilin, m'u shkrep të shkruaj një vjershë, për fye-
llin. Ia vura titullin «Fyelli i Mersiasit».

Ne asohere mësonim në shkollë mjaft gjëra
nga përrallat e lashta greke, nga mitologjia. Unë e
dija se Marsiasi na paske qenë një si gjysmë-perën-
di, të cilin grekët e kanë përfytyruar si një për-
bindësh me fytyrë dhe trup njeriu, po me veshë,
brirë dhe këmbë cjapi. Dhe tërë lesh.

I ziu satir Marsias, — satirë i quanin grekët
e lashtë ata lloj përbindëshash, — deshi të matet
me perëndinë e dritës dhe të poezisë, me perëndi-
në e arteve, që e kish emrin Apollon dhe që i bin-
te lirës, një vegël muzikore me tela. Si ç'mund ta
dini, lira është bërë simbol i muzikës dhe i poezisë.
Sipas përrallës, fyelli i Marsiasit nuk ia kaloi dot
lirës së Apollonit dhe, për këtë dështim, Marsia-
sin e ropën të gjallë.

Më dhimbsej shumë ai fyelltar fatkeq i përrallave. të cilin e ropën të gjallë sepse pande hu që mund t'i bjerë fyellit më bukur se Apolloni lirës.

Mbase kjo ishte një shenjë modestie tek unë. Mua nuk më dukej të isha ndonjë talent i madh, të këndoja si më të mëdhenjtë e poetëve, si Apollonët. Po mos ish e thënë. vallë, që tërë poetët të bëhen të mëdhenj dhe ata që bëjnë vepra më të dobta se Apollonët, duhet t'i rjepin të gjallë, si Marsiasin? Aspak!

Unë s'e gjeja të drejtë dënimin e satirit të shkretë. edhe pse atij iu rrit mendja fort një ditë.

Nuk më kujtohet në se ia qaja apo jo hallin Marsiasit në vjershën time, po mbaj mend se këngën ia lëvdoja dhe, le ta lëvdonin sa të donin Apollonin. për mua edhe Marsiasi kishte kënduar bukur. Bile, thosha unë, ka të ngjarë që të ziun Marsias e ropën të gjallë, se mund të ketë kënduar edhe më bukur se Apolloni. Të tilla kohë qenë. Kush mund të matej me perëndinë e arteve pa rrezik koke?

Kjo, nga ana ime, nuk ishte sigurisht një shenjë modestie. Unë kështu u thosha poetëve të mëdhenj:

— Mos e mbani kokën aq përpjetë. Fyelli im nuk bie më poshtë se lira juaj.

Vjersha ime kishte gati tridhjetë strofa, të cilat i këndonin fyelltarit magjik. Ishin të mbushura ato strofa plot najada dhe driada, hamadriada dhe nimfa, hyjni përrallore të lashta, që u ngjasin orëve dhe zanave tona dhe që e çojnë jetën burimeve dhe përrrenjve, pyjeve dhe lëndinave, në këngë e në valle.

As Apolloni vetë nuk mungonte në vargjet e mia. Ai, si në poezinë e lashtë, krahasohej me agimin dhe diellin. të cilëve nuk u çmohet bukuria dhe mirësia.

Këtu, unë tregohesha edhe një herë modest, duke dashur t'u them poetëve të mëdhenj, se drita e tyre u ndriçon edhe të tjerëve udhën.

Shkurt, vjersha ime desh të thotë këtë: ka poetë të mëdhenj, ka dhe të vegjël; as të vegjëlit nuk bëjnë dot pa të mëdhenjtë, as të mëdhenjtë nuk bëjnë dot pa të vegjëlit. Kjo është e vërtetë për gjithë fushat e jetës.

Më pëlqente shumë vjersha ime. Më dukej se askush nuk kishte kënduar si unë për fyellin. Se mos ishte më i mirë «Fyelli» i Naimit, apo «Fyelli i bariut» i Çajupit? Një vjershë të Asdrenit mbi fyellin, as që e numuroja midis konkurrenteve të veprës sime.

«Fyelli i Marsiasit» ka qenë i pari krijim letrar që i tregova babait.

Im atë kishte bërë studime greke. Ai e njihte letërsinë e lashtë dhe mitologjinë. Marsiasi im, nimfat, driadat dhe shoqet e tyre, perëndia diell Apollon, pastaj vetë fakti se i biri po i bëhej poet, ia prishën mëndjen për disa ditë tim eti. Ai u prek nga vargjet e mia, u entusias mund të them dhe m'i lëvdoi. Kjo ngjau një ditë që babai kishte ardhur në Korçë për punë.

Ishte sukcesi im i parë si poet.

Po gëzimi nuk zgjati shumë. Pas ca kohësh, im atë ia tregoi «Fyellin e Marsiasit» një poeti shumë të njohur, një Apolloni. Ky e lexoi me kurreshtë dhe dashmirësi, u mendua pak e tha:

— Nuk është pa talent djali. Po ç'i duhet të këndoje për Marsiasin? Ç'janë tërë këto driada dhe hamadriada? Kështu shkruhej qëmoti. Sot, kështu nuk shkruan njeri.

Babai nuk m'i tha këto të gjitha. Ta merr mendja se ai m'i tha me fjalët e tij, me të butë dhe marifet. Po unë isha aq i zgjuar sa të kuptoj se nuk ma kishte pëlqyer këngën Apolloni.

Ky kishte pasur të drejtë, po ku dëgj-oj-a unë me atë vesh! Motin e jetës kështu kanë bërë Apollonët me Marsiasët e mjerë, rënkova unë dhe e ndjeva veten aq fatkeq sa s'bëhet, sikur të më kishin rjepur të gjallë.

Për çdo gjë, fundi-fundit, unë edhe mund të pajtohesha me Apollonin, po, që të mos këndoje për Marsiasin, për najadat e nimfat, këtë nuk e kuptoja. Përse ahëre t'i mësonim gjithë ato gjëra në shkollë?

«Fyelli i Marsiasit» nuk qe sukcesi, po dësh-timi im i parë si poet!

E keqja e madhe, ishte se, me sa fillova të kuptoj unë, edhe im atë dukej se nuk e shihte me syun e parë vjershën time, sado bir që më kish. Kjo gjë më vuri në mendim...

Shkuan muajt. Një ditë, shetitnim në atë kohë mbrëmje anës liqenit të Pogradecit. Po dilnim te ranishtja e Starovës, kur u dëgjua një fyell. Fyell-tari i binte shumë bukur dhe ne qëndruam e vumë veshin.

Zëri nisi të afrohet dhe, pas një gardhi, çqoi koka e një bariu me fyellin te buza. Leshrat e tij të zeza e të paqethura prej muajsh, e tregonin si një iriq të vërtetë. Kishte një fytyrë të vogël, që

mezi i dallohej në mes të shkorretit të flokëve dhe të një mjekre po aq të zezë, të parruar prej javësh.

Im atë mbase nuk e pa bariun. Ati i vajti mendja gjetkë. Vuri buzën me gaz me ëmbëlsi, po jo pa ironi, e tha:

— Fyelli Marsiasit!..

E kuptova menjëherë se ku rrihnin këto fjalë. Bëra dhe unë buzën më gaz e thashë, pas një heshtje:

— Demek, nuk qe gjë fare ajo vjershë!

Babai më vështroi në sy, më zuri prej krahu dhe m'u përgjigj:

— S'ishte gjë për të qenë... Po ti do të bësh plot vjersha të mira, nisi ai të më japë zemër. — Mos u merakos. Veç mos harro se arti është i vështirë.

Unë isha pezmatuar fort, me gjithë se isha i sigurt që babai thotë të vërtetën.

Bariu nuk e hoqi fyellin nga buza. Ai doli te rruga e madhe e u ul mbi një trung plepi të rrëzuar përdhe. Ishte një burrë i shkurtër, zhelemel, — si ç'u thonë të reckosurve shkodranët, — me një palë poture që nuk i mbulonin as gjysmat e kërcinjve tërë lesh.

M'u bë se ky këmbëlesh i ngjante satirit Marsias. Apo nuk i ngriheshin edhe flokët anësh e lart si veshë me majë dhe si brirë?

Kam menduar shpesh më vonë tek ai bari. Ja, për atë bari duhej të kisha shkruar, të kisha kënduar unë, për atë Marsias të kohës sonë. Kush e di çfarë jete kishte ai, kush e di ç'tregonte kënga e fyellit të tij!

NË VEND TË EPILOGUT

(dhe të prologut)

Kisha dalë shëtitje buzë një uji. Nuk e dija as unë se ku gjendesha. Po hëna shkëlqente dhe pasqyrohej në valët e lehta të ujit, që shushuriste sikur fërfëllin një pyll me fletë.

Unë shetisja dhe kush e di se çfarë mendoja. Në qiell, hëna, hyr e dil nëpër re, dukej sikur ndiqte çapin tim.

— Ç'ka kjo hënë, që nuk më ndahet sonte? Unë eci, ajo 'ecën!

U ndala, u ndal dhe hëna. U nisa, u nis dhe hëna, me çapin tim.

Ishte vërtet për të bërë çudi!

Pastaj, ai ujë, në të cilin pasqyrohej hëna, herë më bëhej si liqeni i Pogradecit, herë si lumi i Shkumbinit. Kur dilte hëna nga retë, më çfaqej përpara Mali i Thatë, Shën Naumi, Tushemishti.

Kur hynte hëna në retë, më çfaqej përpara Buka-
niku i Shpatit, Shelcani. Shushica.

Ec e merr vesh!

Dhe ja, kur isha duke u shastisur kështu me
hënën, ujët, malet dhe viset përreth, në ujë nisi të
këcejë një peshk. Këcente një metër, mbase dhe
dy metra lart, si një gur i argjendtë, që shëndriste
nën rrezet e hënës, dhe — pllum, zhytej prapë në
ujë. Ujët bënte rrathë të argjendtë, që hapeshin
e hapeshin dhe arrinin bregun, ku tringëllinin si
argjend i vërtetë. — tring, tring, tring.

Një peshk i vogël të bëjë kaq zhurmë, të kë-
cejë kaq!

Çudirat s'kishin të mbaruar për mua atë natë,
buzë atij uji, që shejtani e merrte vesh se ç'qe, —
liqeni i Pogradecit apo lumi i Shkumbinit.

Tek isha duke u çuditur kështu, ai peshku i
vogël këceu dhe një herë mbi ujë, po sa? Jo, një,
jo dy, po tri, po katër metra përpjetë. Dhe kur ra,
ra si një kokër plumbi. Dhe në vendin ku do të
zhytej peshku, ujët na ngriu, na u bë si një tepsi
e argjendtë. Peshku i vogël, kur ra mbi atë tepsi të
argjendtë, tepsia tringëlliti një herë dang dhe
pastaj tringëllimën e saj e përsëriti me valë naty-
ra përçark, da-a-a-ang!

Zgjati kjo ushëtimë një copëherë dhe u duk se
mbaroi tamam në qiell, ku, në atë çast, retë që ki-
shin zënë hënën, u përndanë, sikur t'i kishte dbuar
dikush, dhe tepsia e argjendtë farfuriti mreku-
llisht.

Po, edhe pse farfuriti aq shumë tepsia e ar-
gjendtë, ai peshku i vogël që kishte rënë në të,
shëndriste edhe më fort.

Ec e mos u mahnit!

Tek po mahnitesha unë 'kështu, peshku nisi të më flasë:

— Si. nuk më njohe, or mik dhe armik i vjetër? më tha ai me një zë shumë të hollë dhe diçka të çjerrë.

Unë vura duart te veshët, se m'u duk që m'i shpoi.

— Të shpova veshët, hë? Hihih! qeshi peshku i vogël. — Pa shih si e kam të çarë grykën këtu, tha dhe hapi veshin e tij të kuq, ku vërtet pashë një si të çarë. — Nga kjo plagë më ngjiret zëri dhe të shpohen veshët zotrisate. Këtë dëm, ta dish, ma ke bërë ti. Ti ma ke bërë! Me që nuk më njohe, ja ku po të paraqitem: jam ai Gurnecka, or mik e armik i vjetër, Gurnecka që zure një herë e një mot me atë grepin që të bleu ai zemërgur xhaxhi Markua prej Podgozhanit të Mokrës.

— Si është e mundur! hapja sytë unë. — Unë Gurneckën e shtrydha në dorë, i nxora zorrët!.. Ç'është kjo natë e çuditëshme? Demek, këtu qenkemi buzë liqenit të Pogradecit? pyeta me një gjysëm zëri.

— E pse jo buzë lumit 'të Shkumbinit? ia pat Gurnecka. — Që nga liqeni në Shkumbin, nuk është ndonjë udhë e gjatë. Ke borxh të marrësh lumin e Pogradecit përpjetë, të këcesh pastaj përrua më përrua, të kaptosh një qafë dhe të dalësh në Mal të Lenies, dhe që nga Lenia të këcesh poshtë në Shkumbin. Ja kështu! briti Gurnecka dhe këceu kaq lart, sa, për pak, u zhduk përpjetë, dhe ra pastaj me kaq forcë mbi tepsinë e argjendtë, sa tri-

ngëllima e kësaj mbushi natën me një mijë ushëtimë, anëmbanë.

— Jam edhe në Pogradec, edhe në Shkumbin! thashë unë me vete dhe mirë që nuk më lojti tepeleku i kokës.

— Po mirë, or zot, vijoi Gurnecka. — Si më paske zënë pendën e më paske shkruar një qind e një gjëra, që nuk janë të vërteta, duke më marrë nëpër gojë edhe mua në ato shkrime? Po ti, mor zot, m'i ke ngatërruar të gjitha!

Unë mblodha krahët. desha s'desha.

— Si të mos i kem ngatërruar? nisa t'i jap të drejtë Gurneckës. — Unë s'jam i zoti të di se ku jam sonte. . . Po jo, mor, jo! Nuk i kam ngatërruar! i mëshova më në fund zërit me inat.

S'desha ta njoh veten fajtor.

— S'i ke ngatërruar? m'u vërsul Gurnecka. — Po ja, të marrim një shembull: të marrim punën e atyre dallëndysheve, që ke treguar se si ranë nga teli në Fushë të Domosdovës. Tri ishin ato? Ishin katër. Bile pesë. Pesë!

— Tani më duket se nise ta teprosh, ia pata unë Gurneckës. — 'Ç'ke me dallëndyshet ti? Ti as që ishe në Domosdovë. Shiko punën tënde! Mos u ngatërro me to!

— Si ç'kam? Nuk je ti që, në të dytën fillore, e kishe njësh notën e sjelljes dhe, në të tretën, dysh? Pse ke shkruar të kundërtën, sikur ta kishe dysh në të dytën? Nuk je ti që harkun e Mokrës e humbe në Podgozhan më të kthyer e që na thua se iu lëvdove me të djemve të Tushemishtit? Thoni, or djem të Tushemishtit, nuk është e vërtetë kjo që them unë? Solli ky ndonjë hark në Tushemisht?

Hëna doli nga retë, Tushemishti u çfaq atje tej dhe, që nga Krasta, u dëgjuan një qind zëra fëmijësh:

— E vërteta e së vërtetës! Asgjë nuk solli!

— Të vura me shpatulla në mur! këceu Gurnecka dhe qeshi hihhi, hihhi.

Ktheva kokën, — mur s'kishte pas meje. Me gjithë atë, nuk losja dot vendi, sikur të më kishin mbërthyer vërtet pas një muri.

Ç'më gjet mua!

— Nuk je ti, që Dhaskal Iftimiun e bëre Dhaskal Dhanil? Nuk je ti që Isakun e bëre Raku? Nuk je ti që... , m'u lëshua Gurnecka dhe goja s'i mbyllej.

Unë veten e ndjeja dhe nuk e ndjeja fajtor.

— Ju s'keni pasur ndonjëherë cikë Ceni në shtëpi, vijonte dhe s'pushonte Gurnecka. — Dhe sa për patllixhanat, nuk qenë patllixhana, po domate, ato që mbolle një moti në vend të luleve.

Unë isha krejt i sigurt se kishin qenë patllixhana.

— Tani e teprove fare! u bëra xhind. — I kam ngrënë unë apo i ke ngrënë ti ato patllixhana? Patllixhana ishin!

Nisëm të bëjmë potere të madhe: Gurnecka thuj se qenë domate, unë thuj se qenë patllixhana.

Më në fund, Gurnecka m'u hodh:

— Mor po ti i ngatërron të gjitha. Më mirë lëre pendën, se sa shkruan kështu!

— Do të shkruaj dhe të tjera! iu keqa fort unë.

— Ti, more, ti, që e bëre pendëkuq atë krapin

e Belshit? Ai nuk ishte as një okë dhe ti na e bëre sa një njeri! vijoi edhe më fort Gurnecka.

Me këto fjalë, ujrata u përzhënë kaq shumë, sa shkumëzuan njëra njëzet çape më tej. Dhe nxori kokën e hapi gojën një pendëkuq i madh, tamam sa ai që Kristaq kurrizua zuri në Belësh. Mos ishte Pendëkuqi i Belshit? Dora vetë, ai ishte!

Ec e mos e humb toruan fare!

— Po këtu qenkemi në Belësh! Ja kodrinat rreth e rreth! Ja dyqanet! Ja çezma buzë liqenit! thashë unë.

Gurnecka ngriu. Unë shastisa. Pendëkuqi doli nga ujët me një turfullimë dhe eci rëndë-rëndë drejt nesh.

Sa e vogël që ishte, aq edhe më e vogël katan-disi Gurnecka. Pendëkuqi, me një sulm, këceu mbi të, që ta përpijë, po s'e kapi dot. Gurnecka ik, Pendëkuqi ndiq, — nuk i pashë se nga humbën tutje e më tutje...

— Jo, moj deli ëndërr! thashë unë kur çela sytë dhe e pashë veten me kokë mbi tavolinë.

Përpara meje, ishin përndarë dorëshkrimet e këtij libri. Atë minutë, vendosa t'i vë librit titullin Gurnecka. Sot po ia ndërroj, që të mos më zemërohet Pendëkuqi.

Tiranë qershor 1962.

TREGIME TË TJERA

M E S H I K A T

O! kush do ta rrëfejë gjithë bukurinë e mëndafshinave të dikurëshme, tek s'e kënduan poetët e brezave që kaluan?

Kur çilet ndonjë arkë e moçme, parfumi i mëndafshinave që ajo ruan akoma ose ka ruajtur, më deh dhe më trishton, si më magjeps, po edhe më vret drita që buron nga ajo arkë.

Më kujtohen ahere dhomat e ngrohta, ku zhurmërinte krymbi i mëndafshit, dhomat ku duhej folur me zë pak, që të mos «trembej» krymbi, dhe ku nuk duhej të hynte cilido, që krymbi të mos «merrej më sysh». Pastaj, — mëshikat, që zinin vendin e krymbave të shëmtuar si gjithë krymbat, mëshikat si lule të bardha ose të verdha përmbi gjethet e brejtura të manit, me të cilin ishin ushqyer krijuesit fatkëqinj të tyre.

I mbyllur brenda mëshikës, me shpresë që të dalë më vonë si flutur, krymbi dënonte veten. Atë nuk e linin të flutërohet, se burgu që i kishte krijuar vetes, duke endur i palodhur, me dit e me net, ai burg ishte thurur me një fije të çmueshme.

Ja, — mëshikat i kanë futur në një kusi me ujë të përvëlur. Gishtat e lehta të grave dhe të vashave do të çendin fijen e tyre, fol e qesh, trego përralla e historira, shpotit e mbaj botën nëpër gojë, ngre e vë botën, si thonë tek ne. Dhe krymbat e ngordhur, do t'i hedhin si fundërina.

Të vesh mëndafsh, është një angari e madhe. Në shtëpinë tonë, nuk më kujtohet t'ia kenë hyrë më shumë se dy tri-herë asaj angarie. Mjaft sa unë të kem disa kujtime.

Mbaj mend se për mëshika na ka ardhur çdoherë Jaja Donë, të cilën bota e njihnin sidomos me emrin Jaja e Mëshikave. Ka qenë një plakë e moçme, po e mbajtur mirë. Ishte e madhe, me tipare dhe kocka burri. Një mustaqe e vërtetë i nxinte buzën e sipërme. E kishte dhe Dona atë ves, — të ngrejë e të vejë botën.

Dua t'ju tregoj një nga historitë që kam dëgjuar prej saj për mëshika. Është historia e një fisi të lagjes sonë, e Sotirve, të cilët, në fëmëninë time, gati ishin shuar.

Sotirtë ishin tre vëllezër. Kishin një motër më të vogël dhe nënën plakë. Shkuan dhe s'u trashëguan. E përse? Sepse ishin kopracë, kopracë si bota s'ka parë të tjerë. Jaja e Mëshikave rrëfente se, çanak, ata kishin vetëm një në shtëpi, dhe vetëm një lugë druri. Ta merr mendja se nuk kishin më shumë se një tavë dhe një kusi. Tre burra ishin,

po kishin vetëm një palë opinga dhe një kësulë të tre. Dhe e kishin me dit dhe me orë të caktuar kohën, kur secilit i binte radha të veshë të vetmet opinga dhe të vërë të vetmen kësulë. Sa për gunë, — gunë s'kishin, le të bënte dimër sa të desh.

Kishin edhe një ves: duhanin e pinin. Jo më shumë se tri cigare ditën, pas buke. E dridhte Ndrioja, i madhi, i cili e ndizte dhe e pinte ai i pari; e thithte pastaj disaherë Giga, i mesmi, dhe i shuhej në buzë më të voglit, Nanushit. Jaja rrëfente se ky duhan i shkretë ishte një shkak i vazhdueshëm grindje midis vëllezërve. Kur e thithte Ndrioja, e përgjonin të zilepsur Giga dhe Nanushi.

— Paf-puf, ti Ndrio, paf-puf ti! Po e pive të tërë, mor që të piftë stroka, të piftë!

Ndrioja nuk donte t'ia dijë, si më i madhi që ish. Atij, duhani nuk i dilte keq për hundësh.

Kur e thithte Giga, Nanushit i prishej gjaku fare.

— Paf-puf, ti Gigë, paf-puf ti! Po e mbarove, mor që mbarofsh! Po mjaft, mor lugat, se mbarova i gjallë!

Kur e thithte Nanushi, dy të tjerët e hanin me sy të pangopur:

— Po na hëngre shpirtin, mor që të ngrëntë ndonjë murtajë, të ngrëntë! Paf-puf, paf-puf, cigarja po këtij këlyshi i mbetet!

Nanushi, me bishtin e nxirë të cigares në gojë, grindej e kanosej si ai qeni që druhet se mos i marrin kockën që ka rrëmbyer. Nanushi e thithte cigaren gjer në grimën e fundit të duhanit. Atij i

rrinin kurdoherë të përzhitura mustaqet, dhe njëra anë e zezë e tjetra e ndryshkur.

Duhet shënuar se Sotirtë cigaren nuk e dridhnin me letër, po me gjethe duhani. Letrat duheshin blerë; duhanin e bënin vetë, në oborrin e shtëpisë.

Ishin a s'ishin fort të pasur Sotirtë, këtë nuk e thosh dot as Jaja e Mëshikave. Po në shtëpi, ata kishin pesë lopë, të cilat dimër verë, i kullosnin ullishtës vetë. Ullishta e tyre kishte një qind rrënjë. Edhe këto, Sotirtë i kishin kujdes vetë, si për të punuar tokën, si për të shkadhitur drurët, si për të shkundur, përqokur e mbledhur ullinjtë. Me këtë pasuri, që s'ishte as e madhe as e vogël, mund të rronin si njerëz. Sa për arkat, vrimat dhe uxheret e shtëpisë së tyre, ato nuk i dinte njeri se ç'mund të fshihnin.

Gjë nuk blinin kurrë në pazar Sotirtë, veç krypës. Kafën e sheqerin, ata s'i njihnin. Qumësh-tin e shisnin, gjalpin e shisnin; po kështu dhe djathin e gjizën. Vetë hanin hurrën, — mbase dhe ndonjë shtrep djathti që u mbetej pa shitur. Prej ullinjve ruanin dy kosha plot dhe këtë kishin ushqim kryesor të vitit, veç bukës së misrit, që siguronte një tjetër pronë e tyre, një arë që punonin po vetë. Vetëm «cuca», — si i thërrisnin ata së motrës, — hante rrallë e tek ndonjë qull më shumë a ndonjë vezë. Dhe dashuria e tyre për motrën mund të matej me atë qull e me atë vezë. Ajo dashuri mund të matej edhe me diçka tjetër.

Të tre vëllezrit, në ullishtë shkonin e zhgryenin, dhe jo në shtëpi, le të bënte ftohtë ose vapë sa të desh. Ullishta donte pleh. Dhe kur nënës i

digjej shpirti që t'i bëjë së bijës ndonjë qull më shumë ose t'i japë ndonjë vezë, të tre djemtë hidheshin si të marrosur:

— Kërkon të na prishësh katandinë? Po, Sina në ullahtë s'vete; cuca e ka ullahtën në shtëpi! Dhe na dashka qull e vezë përditë! Mos ke lojtur nga mëntë, nëno!

Për «ullahtë», ata kuptonin me këtë rast vendin e punës, po edhe të plehërimit. Shkonte kot gjithë ai pleh! Do të deshën vëllezrit ta shohin motrën të marrë si ata udhën e ullahtës, gjysmë ore udhë, një ose dy herë ditën, që të plehërojë edhe ajo, — le të binte shi, breshër a dëborë, apo dhe gozhdë prej qiellit të binin. Po, fundi-fundit, Sotirtë të motrën e deshën dhe atë mundim nuk e detyronin ta bëjë. Sa për t'ëmën, asaj nuk i ishin grindur me sa duket kurrë për atë punë.

Kështu e kuptonin dashurinë ndaj prindit e motrës të tre Sotirtë. Me që vrisnin veten, u dukej gjë e madhe fort, e jashtëzakonëshme, jashtë çdo mase, që nëna dhe motra të kishin ndonjë privilegj të tillë, — si do të shpreheshim ne sot. Pastaj, ato ishin dhe femra.

— Femra, moj korba! thosh Jaja Donë, duke tërhequr fijet e mëndafshit prej kuisë me mëshika. — Zoti na ruajtë!

Çështja e pajës së cucës kishte qenë «masllahat i madh fort», thosh Jaja. Nënës iu kish dashur të shkojë me vjet për mëshika. Bashkë me të bijën, asaj i mbeti boshti në dorë e iu thye shpina mbi vegjë, duke tjerë mëndafsh e duke endur pëlhurë për botën. Ato kështu mundën të fitojnë dhe të punojnë edhe një grimë për vete, me shpresë që

vajza të pajohet e të martohet, shpresë që i ngjiste fort asaj të krymbit të mëndafshit. E shkreta nënë e dinte se si ia kishte dalë që t'u shpëtonte hesapeve të pamëshirëshme të djemve.

Vajza u pajua, po vitet shkuan dhe rënduan mbi atë genie të brishtë. Nga ana tjetër, bota s'e kishin fort me qejf të marrin nuse te Sotirtë. Sina u bë nuse vetëm duke u martuar me dheun. Se vdiq, vdiq e zeza Sinë. vdiq nga një «kollë e thatë», si thoshin.

— Nuk qe më shumë se njëzet e pesë vjeç, e shueta! Dhe sa e bukur, dhe me ç'yll! Si rrusp! tregonte Jaja. — Po e thatë, e thatë, e dëshiruemja, si kallam! Flokët e saj, flokët e saj! Florir' i derdhur!

— Mirë që nuk ia prenë vëllezrit e t'ia shisnin talleshin gratë.

Jaja qepte buzët. Vështrimi saj humbiste diku nëpër kujtime. Një lot ia njomte cepin e syve dhe rrokullisej pastaj nëpër një rrudhë të thellë, që ia priste fytyrën prej atij cepi, te cepi i buzëve.

— Ç'yll që kishte, ditëzeza! psherëtinte Jaja, duke ngrënë atë lot, ane gazi binte, gratë heshtnin, duart çendnin mëshikat si pa dashje.

A mund të kishte fat me të zi? Të rritesh me të tillë vëllezër, të bëhesh njëzet e pesë vjeçe dhe të vdesësh pa martuar!

Jaja tregonte se si e kishte qarë Sinën e ëma dhe se si kishte plasur prej vajit. Të pasnesërmen, jo më tej, e kishin shpënë edhe atë në varr.

Nëna e kishte veshur të bijën si nuse, me mëndafshinat dhe florinjte e pakë që ajo i bëri pajë në të fshehtë. Dhe kur djemtë kishin parë me sy

atë pasuri që do ta mbulonte dheu, duke qarë edhe ata të motrën, kishin thënë:

— Po si do treten me ty gjithë këto bukuri, moj cucë? Po shpia jonë e shkretë u gremis sot, moj cucë! Po si do rrojmë, si do rrojmë ne, moj Sinë? Po si do bëjmë ne të varfërit, ne të këputurit pa ty, moj e mjerë?

Jaja tregonte se, që atë ditë, «krymbi i keq» u hyri thellë Sotirve. Në krye të motit vdiq Nanushi: pas ca muajsh vdiq edhe Giga. Mbeti Ndrioja vetëm, kërcu. Sa do të ish ai ahëre? As dyzet vjeç. Po ja ashtu si dera e tyre nuk nxori nuse, ashtu edhe nuk futi. Nanushi e Giga vdiqën pa martuar; Ndrioja i mbylli ditët qyq.

Sa pa vdekur Giga, të dy vëllezrit vijuan edhe një mot jetën e tyre të mëparëshme në shtëpi dhe në ullishtë. Po që kur u vdiq nëna dhe motra, pastaj edhe Nanushi, ata u bënë të heshtur si varri dhe u ndanë fare nga njerzit. Bota i mëshironin ose i tallnin, po as u afroreshin, as me gojë nuk u flitnin.

Kur vdiq Giga dhe Ndrioja mbeti vetëm, ai nuk u pa më të dalë me lopë ose të punojë në ullishtë. Lopët ngordhën. Ullishta, kur bënte, — mirë; kur nuk bënte, — po mirë. Për sevap qëllonte kurdoherë dikush që të mblidhte ullinjtë e Ndrios dhe t'ia çonte në shtëpi. Më vonë, ai zaten e shiti ullishtën, në kohë të zisë, për disa karroqe misër. Dhe sa për arën, atë nuk dihet pse e shiti shumë vjet më parë.

Ndrioja dukej mbudhë vetëm tri herë ditën: një herë shkante në pazar dhe dy herë në furrë. Nga pazari sillte një kusi të vogël me kos, një franxholle, pak mish e zarzavate; në furrë çonte e

merrte një tavë të vogël balte. Shkonte dhe tri-
katër herë në mot në kishë, — Pashkëve, ditën e
emrit ose dhe për Shaje, kur ndizte nga një qiri
për të vdekurit e vet.

Ndrioja mezi lëshonte pra hijen përmbi dhe.
Rronte vetëm, nuk punonte, nuk kursente më, har-
xhonte pak nga pak ato që kish.

Jaja Donë ish e sigurt se ai bënte edhe të mira,
po shumë fshehtazi, pa e marrë vesh njeri. Katër
vajza të varfëra të lagjes, të gjitha kushërira të
largëta të Ndrios, ishin martuar pasi kishin gjetur
një mëngjezi brenda derës së shtëpisë së tyre, një
qese të vogël me florinj. Të gjithë besonin se mi-
rëbërsi i panjohur ishte Ndrioja. Po Ndrioja nuk
fliste, Ndrioja sikur nuk njihte më kërkënd, Ndrioja
sikur ishte ndarë me gjallje prej kësaj bote.

E mbaj mend mirë të fundmin e Sotirve. Ka
qenë një plak i hollë dhe i gjatë, i veshur si motit,
me jakuce e pendebrekë xixë, me brez të kuq, me
qeleshen borë të bardhë, sikur të vinte ngaditë një
qeleshe të re. Kishte një fytyrë prej ashketiu,
po të pastër si qelibari. Duart e tij kishin mbetur
po ato: të mëdha e të gjera, plot nyje dhe të çara,
duar punëtori të ullishtës. E mbaj mend me kusinë
e kosit ose me tavën në dorë, kur shkonte rrugës
i pandjerë, duke shkelur gur më gur. Kokën e
mbante pak ulur dhe sytë gjysmë të mbyllur. Sy-
të s'ia kisha parë ndonjëherë. Kur qëllonte ta
përshëndesë njeri, ai vinte dorën në zemër, ulte
dhe më shumë kokën dhe përgjigjej si pleqtë
motit:

— Falem!

Jetoi shumë Ndrioja, mbase i kaloi të nëntëdhje-

tat, duke bërë po ato tri rrugë në ditë, — nga shtëpia në pazar e në furrë. nga furra e pazari në shtëpi.

Disa javë përpara se të vdesë, më kujtohet ta kem gjetur një të shtune te sheshi i Bezistanit, në rrëpin e madh, ku shiten edhe sot plaçkurinat. Ndrijoja ishte ulur këmbëkryq mbi një hasër. Përpara tij, ishin hapur disa mëndafshina dhe, midis tyre, qëndronte një jelek prej kadifeje të kuqe, i stolisur me pak ar. Mëndafshina më të bukura s'kam parë në jetën time. Linja, shamia, dyshje, çerve, — të bardha, me ndonjë vijë të verdhë e me ndonjë azhur të lehtë. Të gjitha të qëndisura anësh me gjymysh e tentene, si fletë fluttrash, që u jepnin një jetë të mahnitëshme. Rrezet e diellit pasqyroheshin në to me tërë ngjyrat e ylberit dhe me ndriçime të praruara që të rrëmbenin sytë. Jeleku i kadifejtë e i artë qëndronte në këmbë, sikur të shtrëngonte akoma belin e ndonjë nuseje përballash.

Jaja tregonte se këto ishin të fundit gjëra që kishin tepëruar në shtëpi të Sotirve nga paja e Sinës. Ndrijoja i shiti ato kujtime të dhimbëshme vetëm kur s'i kishte mbetur më asgjë për të jetuar. Ai çoi edhe disa javë dhe, më në fund, ra këmbana edhe për të fundmin e Sotirve. Plaku s'ishte dukur pesë dit mbudhë. Në krye të pesë ditëve, e gjetën të vdekur në shtëpi, rrëzë vatrës, mbi një hasër të vjetër. Në vatrë, ishte një çanak me dy thërrime buke. Aty ishte bosh kusia e kosit dhe tava thatë. Ndrijoja kishte vdekur urie...

E kujtoj disaherë të fundmin e Sotirve, kur më shkon mendja te fëminia ime. Dhe nuk e kujtoj

dot pa më dalë përpara sysh edhe Jaja Donë, mëshikat e mëndafshinat.

Oh! mëndafshinat e dikurëshme! Më të bukurat që kam parë, qenë ato të pajës së Sinës, që shiste Ndrioja në Bezistan dhe që s'e ushqyen dot pesë dit më shumë. Oh! se ç'historira fshehin nëpër fijet dhe gjymyshin e tyre mëndafshinat e dikurëshme! Një krymb i endte burgun ose, më mirë, varrin vetes, me një pe të mrekullishëm, me shpresë që të dalë flutur, po që nuk flutrëzonte veç rrallë, kur lypsej për të përtërirë farën e mëndafshit.

1958.

L Ë M S H A S I

Ja dhe një histori që kam dëgjuar për mëshika. Jaja Donë e tregonte shpesh, qoftë se u pëlqente njerëzve, qoftë se Jaja, edhe pse ishte grua me frikë Perëndie, priftërinjtë kish qejf t'i mbajë fort në për gojë. Është historia e një prifti të Shpatit, të cilit s'i është shuar akoma kujtimi. Emrin ia thoshin papa Harallamb.

Si përherë, papa Harallambi kishte zbritur në pazar asaj të shtune të fundit të muajit. Pasi kishte shitur gjithë vezët e pulat që i dhanë gjithë muajin besëtarët, urata i kishte hypur gomarit në atë kohë pasdrekje dhe kishte marrë të përtpjetën e Shelcanit me xhepin plot. . .

Papa Harallambi nuk qe dhe shumë plak. Prapë, veten nuk po e ndjente mirë ato pesë a gjashtë vjet të fundit. Një herë, ishte rënduar nga këmbët,

pastaj i mbahej dhe fryma keq dhe zemrën s'e kish aspak më të. Meshën mezi e nxirrte në ato kishë-za të Shpatit, që nuk bëhen as një hasër vend dhe ku të mbytet era e qirinjve me grahmat e njerzve.

Urata kishte tridhjetë e sa vjet që rendte sa në një fshat e në një tjetër dhe s'e dërguan e s'e dërguan në Elbasan, të binte i qetë në lagje të vet, në shtëpi të vet. Po dhe lagjeja s'e kishte dashur për prift, se papa Harallambi s'kishte të pamë dhe zë nuk kishte.

Dikur, e shoqja i hante shpirtin së grinduri, se nuk qe i zoti për prift Elbasani. Tani, papa Harallambi po bënte vjet që kishte mbetur vetëm dhe «kishte shpëtuar prej asaj kukudh priftëreshë», si thosh. Po i ziu uratë na kishte mbetur vetëm filli. Edhe një djalë që pat, i shkoi në Amerikë dhe u martua dhe u ngul atje. Rrallë e kujtonte me letra i biri. Papa Harallambit i copëtohej zemra për atë djalë dhe nuk gjente ngushëllim as te Zoti vetë më.

I vrarë dhe i rosbitur, prifti e kishte vendosur të mos luajë më nga Shpati, ku kishte kaluar gjysmën e jetës, degë më degë dhe rripë më rripë. Këndej e shihnin mirë dhe i ishte bërë si vendi vet. Në Shpat kishte ndarë edhe para me faiz...

Gomari hidhte dy-tri çape, i merrej fryma dhe qëndronte. Edhe gomarin e kishte mplakur pa kohë ajo e përpjetë e Shelcanit që mbante dy orë të mira, përveç të përpjetave të tjera. Urata e shponte, i bërtiste «ush» dhe, me vete, bënte hesapet e faizeve që i kishin mbetur pa marrë atij viti. Njëri s'i kishte larë as faizet e vjetme; tjetri i kishte dhënë vetëm një napolon dhe i kishte pesë; një

tjetër dy muaj me radhë po e mbante me sot e me nesër; një, po bënte gjashtë muaj që s'e shihte në kishë dhe s'e gjente në shtëpi.

Më djall punë se kjo punë e parave nuk kishte. Sa e donin dhe e mbanin për nder priftin në Shpat, zor ta bënëin gjetiu. Po dhe papa Harallambi fjalën e pat të ëmbël, i përtueshëm nuk qe, nuskat tregonin se i zënë fort dhe faizin nuk e ngrinte kurrë mbi njëzet përqind. Urata ia dinte gjithë hallët asaj gjindje hallemadhe, me të cilën po rronte tri-dhjetë e sa vjet. Atje ku duhej fjala e mirë, këshilla, ndreqja, pajtimi ose ngushëllimi, papa Harallambi ia dilte në krye. Atje ku nuk pat dhënë Zoti, as prifti nuk mernte shpërblim. Po në punë të parës që ipte, ai nuk donte shumë fjalë dhe rrallë i shpëtonte gjë nga dora ose falte gjë. Kështu që, sa fort që i dukej se e donin shpatarakët, të cilët, thosh urata, ia dinin dhe për nder se u ipte para, — se njërin e shpëtonte nga buka, tjetrin nga xhelëpi, këtë e bënte me lopë ose me kalë, — prapë se prapë, kur vinte dita për të paguar, shpatarakët i bënëin të një qind e një dredhat priftit dhe ky s'e kishte më atë fuqi që t'i ndjekë si dikur.

Vërtet, më djall punë se kjo punë e parave nuk kishte. Ta binte shpirtin mu në majë të hundës. Të lodhesh që të mbledhësh paratë e tua! Dhe priftin e lodhnin më shumë ato para dhe faize të uruara se punët e kishës...

Duke ngjitur të përpjetën e Shelcanit, «ush» këtu, «ush» aty, hesap pas hesapi, papa Harallambi e ndjeu veten shumë keq dhe desh u gremis nga gomari: e theri fort në zemër. Gomari ndaloi. Urata i zbriti me të vështirë të madhe e u shtri në hijen

e një shkoze. Pasi u shplodh mirë dhe mori frymë më lehtë, bëri tri herë kryq dhe pëshpëriti:

— Lavdi më ty, o Zot Perëndia jonë! Të paçim bekimet ne mëkatarët!

Dhe iu shkëputën dy pika lot.

— Nuk do ta shoh më me sy! psherëtiu prifti dhe iu shkëputën edhe dy pika lot.

Papa Harallambit i vajti mendja tek i biri në Amerikë, e tha se nuk do ta shihte më me sy, dhe as nusen, as të dy nipat e vegjël që kishte atje larg në Amerikë, dhe që s'i kishte parë kurrë, veçse në fotografi.

Urata psherëtiu me lot mbi faqe dhe me sy nga Zoti, dhe, për të parën herë në pleqëri të vet, mendoi se as krerët, as faizet nuk do t'i hynin për ndonjë farë pune. Se djali nuk ia kishte nevojën dhe as kishte mend të kthehet më në shtëpi.

Ai djalë, ai djalë! E kishte lënë me duar thatë dhe me plagë në zemër. Dhe urata s'kishte as motër e vëlla, as nip e mbesë. Nj'a dy kushërinj të parë që kishte, nuk donte t'i shohë me sy: ata veç për një gjë luteshin, — që papa Harallambi të këpuste qafën sa më shpejt prej kësaj bote dhe të trashëgonin ata.

Papa Harallambi u mendua mirë. Ai bëri hesap një për një tërë faizet që kishte mbledhur gjatë jetës së vet dhe bëri çudi: faizet ua kapër Xenin pesë herë krerëve, dhe urata vetëm nj'a dy herë kishte marrë mbi njëzet përqind, si bënin bota.

— S'kam qenë njeri pa zemër, tha me vete prifti dhe i qeshi buza.

Sidoqoftë, «hakun e vet» e kishte marrë pesë herë. Paratë e veta i kishte gëzuar pesë herë. Tani

i duhej të mendonte edhe për të prapmen, se dita po afrohej. Dhe e prapmja nuk është fundi në këtë dhe, po fillimi në atë qiell! Dhe Zoti do t'ia peshonte të gjitha në kandar, sa të kishte bërë dhe si të kishte bërë!

Papa Harallambi vrau mendjen fort e fort. S'kishte bërë ndonjë të ligë të madhe, sa t'i keqej Zoti aq fort, kur të dilte dhe të gjykohej përpara tij. Po kreshmët s'i kishte mbajtur gjithëmonë si duhen mbajtur, dhe as agjërimet Dhe ishte prift! Punës nuk ia përtonte, po i kishte lënë kaq herë të vdekurit pa trisaji, dhe të gjallët e kishin paguar. Dhe ishte prift! Edhe kishën i kish qëlluar ta thotë disaherë shpejt e shpejt. Dhe ishte prift!

Të tilla faje na kishte bërë urata. Ish zënë edhe me dhespotin nj'a dy herë dhe e kishte sharë andej e kënde, sepse nuk e dërgoi në Elbasan. Edhe me piftëreshën ishte zënë disaherë, po këtë e dinte Zoti vetë se çfarë kukudhi kish qenë. Ç'kishte bërë urata më? Ku ta dinte dhe ai? Tërë fajet e robit i di vetëm Perëndia me të madh të vet, Perëndia që na gjykon. Ku t'i dijë robi tërë fajet që bën? Ja, papa Harallambi pinte dhe raki dhe i qëllonte të dehet dhe t'i rrëshqasë goja, të shajë gjer dhespotin, se gojë është e shkreta, nuk mbahet, rrëshqet!

Urata vrau fort mendjen. Pa faj nuk ishte. Po kishte bërë edhe të mira. Një herë, fshatarët që kishte shpëtuar me paratë që kishte përndarë. Kujt s'i kishte bërë mirë? Të gjithë i kërkonin paratë e tij e thoshin se e ka dorën të mbarë. Vërtet, njëri kishte shitur shtëpinë dhe mallin, po ai ishte krymbur në borxhe edhe gjetiu. Uratës njëzet napolona të shkreta i kish dhe ai e kishte pritur thua se tre

vjet për faizet. Edhe një tjetër kishte mbetur pa gjë të gjallë. Po ç't'i bënte urata se me ato para bleu një kalë dhe kali i ngordhi? Ai i kishte bërë nder, po Zoti s'kishte dashur. Për paratë e faizet, urata u shtrëngua dhe i shiti bagëtinë. Po ama, pesë vjet e kishte pritur. Edhe nj'a dy a tre të tjerë po kështu. Veç të qajej njeri, — jo! Njëherë, kishte bërë fjalë një trepsanishtas, po dhe këtij nuk i pat faj urata: të gjithë e dinin se ç'grindavec i prapë ishte dhe se sa shpifte. Të tjerët e donin dhe e nderonin. Se, kush pajtoi më shumë gjaqe se papa Harallambi atij Shpati? Po krushqi, kush ndreqi më shumë? Po nuskat, që kishin shpëtuar kaq njerëz? Dhe sa e sa herë kishte ngritur panai dhe kishte bërë palakris as për një kokër ve? Dhe sa e sa herë kishte marrë udhë të gjatë, nëpër shi dhe nëpër borë, nëpër vapë dhe nëpër athtim, për një lindje a për një vdekje? Dhe sa më? Sado të këqia të bëjë një prift, një shërbëtor i Zotit, ai është kurdoherë më pranë Zotit, më pranë shenjtërisë së tij, sa dit ka moti, në kishë dhe gjetiu. Dhe të mirat s'i kanë të numuruar.

Kështu e vrau fort e fort mendjen papa Harallambi. Po, të mira kishte bërë vërtet, veçse..., veçse edhe ndonjë të keqe e kishte bërë. Kishte sharë disa herë. Dhe ishte prift! Zoti do t'ia peshonte të gjitha në kandar, sa të kishte bërë dhe si të kishte bërë. Dhe dita po afrohej!

Urata s'e ndjeu veten të larë përpara Zotit Perëndi dhe shikoi si me frikë retë që hapeshin e mblidheshin fqolla-fqolla në qiell.

Pasi vrau mendjen mirë, papa Harallambi, me zemër të dridhur, i dha fund që, me krerë, me

faize, ç'pare të kishte përndarë në Shpat, t'ua falte borxhëlinjve të vet. Dhe uratës i qeshi menjëherë buza, fërkoj mjekrën e gjatë thinjoshe, bëri tri herë kryq me shpirtin të kënaqur, po me zemrën edhe më të dridhur, dhe u ngrit e i hypi gomarit.

— Ush, or i bekuar! i briti urata gomarit dhe, pa dashje, i vajti mendja te ajo përralla ku Nas-tradin efendiu shkon me gomar në atë jetë dhe i bërtet gomarit të tij: «Ush në atë jetë!»

Papa Harallambi, me shpirtin të kënaqur, po me zemrën të dridhur, vuri buzën më gaz e i briti dhe ai gomarit të vet:

— Ush në atë jetë, or i bekuar!

* * *

Papa Harallambi arriti natën në Shelcan. Që të nesërmen, dërgoi t'u thonë gjithë atyre që i kishin gjë për të dhënë, të vinë doemos asaj të diele një javë në kishë të Shelcanit, se urata ka me ta një fjalë për të mirë të tyre.

Lajmi u përhap anembanë Shpatit, se kështu e kështu papa Harallambi u kishte dërguar e thënë borxhlinjve të vet dhe, asaj të diele një javë, në kishë të Shelcanit, u mblodhën më shumë njerëz se ç'ishin mbledhur atyre pashkëve të Shën Mërisë së gushtit. Po nga borxhlinjtë e papa Harallambit nuk erdhi asnjë, as ata të Shelcanit vetë.

Urata u inatos shumë, sa, për pak, desh ndryshoi mendje. Po ç'të bënte? Një gjë që takset përpara Zotit, nuk lihet pa kryer.

Përpara se të hyjë dhe të nxjerrë kishën, papa Harallambi mblodhi gjindjen rreth tij, që t'i thotë

se ç'kishte vendosur. Trupi i dridhej i tëri, zemra po i shkulej vendit.

Papa Harallambi hoqi kamillafin, vështroi qiellin dhe bëri tri herë kryq. Gjindja hapte sytë. Mos kishte lojtur mendsh prifti? Tregonin se atë javë s'kishte qenë më të. Urata vuri kamillafin, futi dorën nën xhybe dhe nxori një send të mbështjellë me një shami të zezë. Zgjidhi shaminë dhe doli një shami tjetër. Kishin qenë tri shami të zeza. Kur zgjidhi të tretën, doli një paqetë me letra, e mbështjellë me kartë të trashë bojë qielli.

— Dëgjoni, or të bekuar, nisi urata. — Tërë këto letra janë senetet e parave që kam përndarë në Shpat. Gjithësej, bëjnë dy qind e shtatë napolona e tre çerekë flori.

Gjindja mërmëriti e shtangur. Dy qind e shtatë napolona e tre çerekë flori! Sa para që kishite prifti!

Urata vështroi gjindjen, vështroi senetet dhe duart që i dridheshin, mori frymë thellë e tha:

— Dy qind e shtatë napolona e tre çerekë flori! Do t'i djeg të tëra! Dhe ç'borxh të më ketë, kujt të ma ketë, me krerë, me faize, ia kam bërë hallall!

— Ou! mërmërinë besëtarët.

— U dërgova e u thashë të vinë këtu sot gjithë borxhlinjve të mi, se kam një fjalë me ta, për të mirë të tyre, po nuk më erdhi njeri. Desha ta shohin me sy. Tani, ja ku ju kam shahitë sa jeni këtu, se i dogja.

Gjindja mbeti me gojë hapur. Prifti mori frymë e tha:

— Po dua një gjë, ama. Kur të më ndjejë Pe-

rëndia dhe të vdes, dua që, sa herë të bëjnë trisaji për njerzit e tyre, të bëjnë edhe për mua; sa herë të ndezin një qiri për ta, të ndezin dhe për mua; dhe kurrë të mos ndajnë për ta, pa ndarë dhe për mua. Kush të mos e bëjë këtë, pastë mallkimin tim dhe të Zotit Perëndi! Kush ta bëjë, pastë bekimin! Thoni të gjithë me mua amin!

— Amin! thanë besëtarët të shtangur.

Ahere, papa Harallambi hyri në kishë, mori me dorë të vet një qiri të ndezur dhe, përpara gjindjes pa gojë, erdh e u vuri zjarrin seneteve.

Si u dogjën të tërë e u bënë shkrumb, urata hoq prapë kamillafin, bëri tri herë kryq me sy nga qielli e tha:

— U qofshin hallall!

Tërë gjindja bëri tri herë kryq dhe mërmëriti:

— U qofshin hallall!

Papa Harallambi shkundi xhyben e vjetër, ku i kishte ngecur pak shkrumb senetesh dhe hyri të meshojë. Trupi i dridhej edhe më fort, zemra i luftonte me krahërorin.

Dy qind e shtatë napolona e tre çerekë flori!
Dy qind e shtatë e tre çerekë! Gjithë ato para, në Shpat i kishte fituar, tridhjetë e sa vjet me radhë, katund më katund, kishë më kishë, lindje më lindje, dasmë më dasmë, vdekje më vdekje. Sikur Shpati i tëri të bënte trisaji për të, gjer ditën e fundit të botës, kur të ngrihen të vdekurit nga varret, Shpati nuk mund të prishte aq para kurrë! Dy qind e shtatë napolona e tre çerekë flori! Dy qind e shtatë e tre çerekë! I kishte bërë shkrumb e hi, me dorë të vet!

Papa Harallambi e nxirte kishën gjysma-gjys-

ma, i sëmurë, i trullosur. Herë harronte një kryq, herë një fjalë, herë një tropar të tërë. Po gjindja s'e vunë re. Të gjithë bënin fjalë, pëshpërisnin.

Shumicës nuk i dilnin nga mentë senetet që u dogjën. Po kish që bisedonin edhe për punë të tjera, për misra e të mbjella, për mera dhe pazare. Gratë kishin zënë punë më lëmshat e leshit: sa lëmsha ke bërë ti, sa ajo, sa unë.

Papa Harallambi ishte në derë të kungës. Ishte koha kur prifti këndon: «Dhoksasi, o Theos imon» 1).

— Sa lëmsha ke bërë ti, moj Sofi?

— Po ti, moj Mari, sa lëmsha ke bërë?

— Po ti, moj Kali, sa lëmsha?

Urata ngriti zërin dhe këndoi:

— Lëmshasi, o Theos imon, lëmshasi!

— Kukuku! plasi gazi ndër gra. — Tha prifti «lëmshasi», moj gra!

Urata përsëriti:

— Lëmshasi, o Theos imon, lëmshasi!

— Kikiki! plasi gazi ndër burra. — Na e bëri prifti kishën lëmsh, or shokëni!

— Lëmshasi, o Theos i... , desh të thotë edhe një herë urata, ngriti dorën të bëjë kryq dhe u përplas përtokë, i vdekur.

1938.

1) Lavdi më ty, o Zot!

P R E N D J A

Një ndër ata vjet, në Elbasan internuan disa familje nga veriu, sigurisht për arësye politike. Përballë shtëpisë sonë, në një si kotec ose ahur, u vendosën dy pleq me të bijën. Ishin nga Malësia e Madhe. Plaku, me kokën të mbështjellë në një peshqir të bardhë, si çallmë; — plaka, me një xhurdi të zezë r Rathë-rrathë. Të dy, të drejtë e të lartë si lisa, me dy vështrime të ashpëra. Ai, me një të folur të ngadalshëm e të rëndë, — e dëgjoj akoma tek pohon nën mustaqe «poë, poë», duke tundur pak çallmën majtas e djathtas; — ajo, me një zë të çjerrë dhe me ca fjalë të shpejta, që zor t'i merrje vesh.

Prendja, vajza e tyre, thosh se qe tetëmbëdhjetë vjeç, me gjithë se tregonte më e madhe. Ishte tërë ajo grua. Fustani i zi, i arnuar me kujdes dhe shumë i pastër, mezi ia kapërxente gjurin, sikur

vajza të kish lëshuar shtat tamam atë vit dhe të mos kish prerë dot rrobe të reja. E pastër ish edhe shamia e zezë me të cilën Prendja lidhte kryet. Po flokët i dilnin si t'u tekej prej shamisë, — këtu fije-fije, aty me ndonjë kaçurrel, atje matanë tufë, — thua se vajza nuk krihej kurrë. Veçse kjo pakujdesi i shkonte fort. Prendja ishte e bukur, me një bukuri të egër. Gati leshverdhë, po sytë korb të zinj. Oh! çfarë sysh të qeshur dhe krenarë! Edhe vetullat e saj të trasha, të verdha ishin. Tipare të tilla kam hasur ndonjëherë në bregdetin e jugut. Ja, për hundën e saj mund të thoshe se ishte si qiri. Buzët e fryra dhe mollëzat pak të mëdha e të dala, i kishte flakë të kuqe. E shoh akoma tek ecën dhe dëgjoj çapin e rëndë që i troket nëpër shkallët e shtëpisë sonë.

Ne Prenden e patëm një dy muaj shërbetore. Na lante rrobet dhe enët, bënte punët e vështira. Përvishtë llërët e trasha, punonte me zhurmë e rrëmbim dhe çdo gjë shkumëzonte, zbardhte, ndrinte në duart e saj. Harxhonte ujë shumë, po nuk ia përtonte të shkojë pesë herë ditën në çezmë, me nga një gjym të madh në secilën dorë e me nga një shtëmbë në secilën sjetull. Kur vinte dhe ndonjë enë mbi krye, ahëre dukej mirë se sa e gjata që ish...

Nuk më kujtohet përse, një nate dimri, babai dhe nëna dolën e u kthyen shumë vonë. Duke mos dashur të na lërë vetëm me Prenden, nëna iu lut një kushërire të rrijë edhe ajo me ne. Kushërira ishte vajzë për t'u martuar, si Prendja.

Të vegjëlit i mori gjumi herët. Unë lojta gurmacësh me vajzat gjer në një farë ore. Pastaj,

Prendja zuri çorapen, kushërira tentenenë dhe mua nisën të më mbyllen qepallat. U shtriva dhe mbësh-teta kokën në gjurin e malësores. Tek po kotë-llohem, dëgjoj time kushërirë të pëshpërisë:

— Është e vërtetë, moj e zezë, se ke vrarë me dorën tënde ti?

Prendja heshti. Gishtat e saj lëmuar pak ballin tim. Vajza kishte ulur kokën dhe më vështronte. Unë isha zgjuar, po sytë i mbaja mbyllur, aq sa të mund të shoh përmes qerpikëve.

Malësorja kishte në fytyrë një pikëllim të rëndë, të cilin s'jam i zoti ta tregoj. A mos kish edhe një inat të shurdhët në atë pikëllim? Kujtimet e mia prej fëmije nuk mund ta thonë. Buzët e vajzës u shtrënguan fort; sytë, edhe pse më vështronin mua, më mirë të thoshe se nuk vështronin asgjë, sepse kishin ngrirë. Dy rrudha ia çanë ballin tej-matanë.

Së fundi, Prendja psherëtiu thellë e tha:

— Po, moj motër. Ata na vranë tre burra dhe ne u vramë tre. Të tretin, ua kam vrarë vetë.

Ja kështu nisi të rrëfejë, thjesht, ngadalë, e menduar, me gishtat e saj që nuk pushonin së për-qethuri ballin tim. Nganjëherë, Prendja përkulej nga unë, kur lëvizja pa dashje, dhe e shuante zërin. Ndjeja atë çast frymën e ngrohtë të vashës, dhe, të mos ishte historia që ajo tregoi, më i ëmbli gjumë do të më kishte nanuritur me atë ngrohtësi të parfumuar.

Prendja kishte pasur tre vëllezër dhe një motër më të madhe. Të motrën e fejuan përtej kufirit, në Mal të Zi, në një fshat shqiptar buzë lumit të Cemit. Po në atë shtëpi, fejuan edhe Prenden. Burrat

e tyre ishin kushërinj të dytë, dhe, si ç'qe zakoni, nuk ishin ndarë, rronin në një vatër.

Motra e madhe vajti nuse, po, në krye të disa javëve, u kthye në shtëpi. Burri e kishte dbuar. Ata matanë, mbase patën shpresë që kufiri do ta pengojë sado pak gjakun të derdhet. Kufiri nuk pengoi asgjë. Plumbin e parë e hëngri dhëndërri. Dy plumba u shkurtuan jetën më pas dy burrave, njërit nga secila anë. Motra e madhe kishte vdekur ato vjet, ndofta nga hidhërimi.

Njëherë, tek ishin në stan, armiku u hyri thellë. Prendja po milte atij mëngjezi te vatha. I ati po gdhente një parmendë të re në prak të kasolles. Krisi pushka dhe këtë e mori në njëren këmbë.

— Më vrau, qeni! briti plaku dhe u hodh në kasolle.

Prendja këceu pas tij dhe dolën të dy të armatosur.

Një djalë i ri u duk të kapërxejë rrëzë një shkëmbi. At e bijë shtinë, po nuk e rrokën. Tjetri u platit dhe nisi lufta. Plakun e rroku edhe një plumb.

— «Më vrau babën!» rënkova dhe m'u pre gjaku, thosh Prendja. — Nuk më bëri dora të shtie. Sytë m'u veshën. Ai atje përballë nisi të bërtasë: «A ku je, a Gjin Pjetri, se do ta baj shpinë sall për femna!» Këto fjalë më ranë si plumb. «A sall për femna, a? Ja ku po i njeh femnat e Malcisë i cemjani!» zjeva unë... Ai, prëpremi, u trimërua e nxori kokën mbi një shkëmb. Shënova dhe nuk u dëgjua më... Ja, moj motër, deshi ta mbyllë gojën Prendja me një psherëtimë të rëndë që ia ngriti peshë krahërorin.

Time kushërira i kishte ikur gjaku: ajo dridhej me duar në gji. Malësorja rrinte e menduar, e trishtuar, me kokën ulur dhe shikimin tek unë.

Përrjashta shkrepëtiu aq fort, sa në dhomë u bë ditë. Pastaj shpërtheu një bubullimë gati mbi kokat, tona dhe që tronditi shtëpinë. Unë dhe kushërira këcyem në gji të Prendes. Dhe ashtu qëndruam të tre një copëherë, të shtrënguar.

— Nuk po flije ti? më pyeti Prendja.

— Më zgjoi rrufeja, gënjeva unë.

Ajo u mundua të më qetojë duke më puthur. Kushërira zuri vendin e vet dhe u bë një heshtje e gjatë, të cilën e prishte vetëm kërcitja e ndonjë xixë mbi tagarin aty përkrah. Pas nj'a dy shkrepëtimash më të vogla, shiu nisi të trokasë dritare më dritare dhe mua po më zinte gjumi përsëri, kur Prendja foli:

— U nisa që ta shoh, moj motër. Ma ndjellte zemra. Ai duhej të ish, im shoq, i fejuari. Pyesja veten si në ethe: «Ai të jetë, xhanëm?» dhe e dija me sak se ai ishte. Më pritëshin këmbët e s'ecja dot, për besët. Bëja pesë çape dhe më zihej frymafare. «Po sikur të jetë ai vërtet?» pyesja prapë veten, duke dashur të mbush mendjen se nuk ish ai. «Po vallë do ta njoh?» Ne ishim të vegjël, moj motër, kur na fejuan. Ja, ai ishte më i vogël se kaq, tha Prendja, lojti kokën nga unë dhe nisi të më përkëdhelë gushën. — E kisha parë nj'a dy herë përpara se të na fejonin, te një i veti në fshat tonë. Një herë më kishte kthyer edhe një viç që mori ters... Ishte voc, moj, voc. Tetë vjeç, nëntë. Dhe unë, tha Prendja duke hapur pëllëmbën, — ja kaq. Ja, sa gjysma e këtij, lojti përsëri ajo kokën

nga unë dhe iu muar gryka. — Sapo më kishin dërguar me vija... «Po sikur të jetë ai?» thosha. «A do ta njoh?» Dhe ecja, më priteshin këmbët, doja të kthehem prapë, të rend, të rend prapa mallit. — po i afrohesha, doja ta shoh!... Veç kur m'u kujtua se ai kishte një nishan të zi, ja këtu, tha Prendja dhe më vuri gishtin mbi njërën vetull. — Mu këtu. Ishte voc i bukur, për krye të vocit!... Kishte dhe atë nishan, ja mu këtu, mbi vetull... Kur më vajti mendja tek nishani, u drodha e u përplasa përtokë e s'munda të bëj më asnjë çap... Do ta njihja nga nishani!

Prendja heshti. Sytë ia mbushi vaji dhe grykën ia pushtoi ngashërима. Kurrë nuk do ta kisha marrë me mend Prenden në vajë. Dënesa e bënte të lëkundet të tërën dhe, me duart e saj të mëdha, ajo fshihte fytyrën e larë në lot.

Ime kushërirë u përpoq ta ngushëllojë, edhe ajo duke qarë. Unë s'guxoja të lëviz vendit e më dridhej shtati. Prendja, kur më ndjeu, e përmblodhi veten dhe më mori përsëri në gj. Të shtrënguar edhe një herë të tre, ne u qetuum.

Ime kushërirë, më së fundi, guxoi e pyeti:

— E pe, moj e zezë?

— E pashë... kur e bartën te një stan fqinjë, tha Prendja. — Plumbi e kishte marrë aty përmbi vetull... përmbi nishan... Ishte ende djalosh, i ngratit. Sapo i trashej mustaku i zi... Ne femrat rritemi shpejt, vërejti vasha dhe mori frymë, tanimë gati e qetë, sikur gjatë atij rrëfimi të qe shkarkuar nga një barrë e tmerëshme. — Pas gjashtë muajsh, më vranë vëllanë e vogël, tha ajo e iu egërsua zëri. — U bënë tre vjet, plot tre vjet, vërejti së fundi

me një zë të butë dhe të dy vajzat nuk këmbyen më asnjë fjalë.

Prindët erdhën shumë vonë, pas mesit të natës. Prendja me time kushërirë vajtën të flenë në një dhomë tjetër. Shiu trokiste dritare më dritare. Ndo një shkrepëtimë çante qiellin. Unë nuk gjeja dot të ngrohtë në shtrat. Nuk më zuri gjumi, e gdhiva.

S'ka disa muaj, po udhëtoja me tim bir nga Tirana në Pogradec. Në Durrës, i hypën trenit një tok malësorë e malësore, me veshjet e tyre të hijshme. I vogli u bë shumë kureshtar dhe, pyetje pas pyetje, mësoi plot gjëra të reja mbi gjeografinë dhe veshjet e Shqipërisë.

Kishim kaluar Kavajën. Djali, i mbështetur në dritare, hutoi me vështrimin jashtë; unë u zhyta sërish në një lexim. Vonë pikasa që im bir nuk ishte më aty, renda ta kërkoj kabinë më kabinë dhe e gjeta në fund të vagonit, tek po bënte muhabet e po qeshte, midis një palë kofsharësh dhe një xhurdie. Qëndrova edhe unë disa minuta me miqtë e tij të ri.

Ishin delegatë të një kooperative bujqësore, që shkonin andej nga Fieri për eksperiencë. Midis tyre, dallonte një shtatmadh e eshtërmadh, — kokën e takijen të mbështjellë në një shami bojëkafe, çibukun e sermit në gojë dhe zërin si të mveshur e të hollë. Ishte qose. Të tjerët e thërrisnin «shoku llogaritar».

Më pyetën se nga jam dhe, kur u tregova se jam elbasanas, llogaritari nisi të interesohet për qytetin tonë e sidomos për Kalanë. Tha se kishte jetuar në Elbasan.

Ai fliste dhe mua sikur diçka më përmendej e s'më përmendej, nga zëri dhe tiparet e tij.

Me kaq, treni ndali në Rogozhinë. Malësorët morën trastat dhe zbritën. Llogaritarit i shkau këmba dhe dikush i briti:

— Mbahu, Prend!

Unë shtanga. Duhej të ishte Prendja, Prendja e fëminisë-sime!

Ajo ishte, si ç'e kam mësuar më vonë.

Pas vdekjes së tet, Prendja nuk u martua, po mbet «virgjineshë». I tillë qe zakoni në shtëpinë pa mashkull. Prendja u vesh burrë dhe hyri në sërën e burrave. Kjo sërë i shkonte, — po mua m'u prish zemra duke shkruar këtë histori.

1958.

X H E L A T I

Ishite viti 1925. Zogu e kishte shpallur veten president republike dhe vriste mendjen se si të shpallet për së afërmi mbret, — gjë që ai e bëri pas tre vjetësh.

Sapo mori fuqinë në dorë, Ahmet beu ia nisi me burgime, zjarr dhe litar. Burgu i Elbasanit u mbush plot e përplot. Atë burg, unë e kisha pranë shtëpisë. Çdo ditë, sa herë që shkoja në shkollë ose në pazar, shikoja njerëz me duar të lidhura, të verdhë, të parruar, të lodhur, disaherë edhe të gjakosur. Një palë i çonin në gjyq apo i sillnin së andejmi, të tjerë sapo i kishin zënë dhe i mbyllnin,

Më kujtohet një herë kur sollën një karvan fshatarësh, më shumë se tridhjetë vetë, cili me gunë e cili pa gunë, cili me kësulë e cili pa kësulë, disa edhe zbathur. Të gjithë ishin të kapitur e të dërmuar, sikur të kishin javë e muaj që udhëtonin më këmbë.

Binte një shi i hollë, që i kishtë qullur e bërë edhe më të mjerë. I kishin lidhur dy nga dy. Pastaj, me dy litarë të gjatë sa vetë vargu i robërve, i kishin lidhur pas njëri-tjetrit. Në fund, vetëm, ecte një plakarec me duart e lidhura secila në një litar të vargut. Ai dukej sikur mbante frenat e një qerrje fantastike të zvarrisur nga pesëmbëdhjetë pendë. Ishte fort i shkurtër dhe cop' e çikë. Ecte si i dehur apo sikur ta kish zënë gjumi. më këmbë, me kokën të këputur mbi krahërorin e xhveshur dhe leshtor. Lëkundej majtas e djathtas, binte në gjunjë, hiqej pak zvarrë dhe prapë ngrihej me ofshama. Xhandari që i vinte pas, e godiste, herë me shqelma dhe herë me qytën e pushkës. Katër xhandarë të tjerë, me armët të ngrehura në dorë, mbyllnin karvanin duke qeshur...

Një natë, kisha fjetur te ime gjyshe. U ngrita herët në mëngjez dhe renda drejt shtëpisë që të marr çantën e të vete në shkollë. Sytë i lava të çezmia e Jan Dhespotit. Dhe ja, kur po i hidhja ujë fytyrës, një zhurmë çapesh u dëgjua në krye të rrugicës. Ngrita kokën, me duart akoma të çurgu. Një qenie e veshur me të bardha ishte vërsulur drejt meje. Shoh akoma dy sy si qokla, lëvizjet shumë të shpejta e si të çartallosura të duarve dhe të këmbëve, këmishën që ngrinte era, duke zbuluar një mish të verdhë. Nuk e di se si m'u dha: këceva derën e Bicëve, u struka nën çardhakun e tyre pas një trari dhe, me zemrën që po më këcente prej gjirit, guxova të shoh akoma nga dera që mbeti çelur. Qania e lugatëshme, — si mund ta quaj, — kaloi rrugicës vetëtimthi. Atë çast krisi një pushkë dhe u dëgjuan çapet e shpejtuara, po shumë të

rënda, të një njeriu. Pas një pushke tjetër, filloi të dëgjohej edhe një të gulçuar. Dhe ja, një xhandar, i trashë sa një buall, me armë në dorë, që shtiu edhe një herë. Pa kapë në krye, ai kaloi i hallakatur, duke britur:

— Mbaje, mor, mbaje!

Tjetër gjë nuk pashë. Britma e xhandarit u dëgjua edhe dy-tri herë. Po kështu dhe pushka.

Ç'kishte ngjarë?

Kishte shpëtuar nga burgu një peqinas, të cilin ose e kishin dënuar me vdekje ose ky dënim e priste, për arësye politike. Ditët e fundit, ai kishte qënë fort i sëmurë dhe shkonte shpesh në nevojtores. Kjo gjindej në fushën e burgut, rrëzë murit. Aty, peqinasi vonohej dhe fërkonte me sapun këmbët. Ca nga sëmundja që e kishte tretur shumë, ca nga sapuni që i bëri të shkasin, i burgosuri mundi t'i nxjerë prangat prej këmbe. Pastaj, me fuqinë e çuditëshme që i jep njeriut shpresa e shpëtimit dhe dëshira për të jetuar, i burgosuri çeli çatinë e nevojtores, të cilën duket se e kishte bërë gati gjifhë ato dit, hypi lart dhe u hodh nga muri në rrugë. Ashtu, në brekë e në këmishë, ai u bë erë nëpër lagje. Xhandari i rojes, që iu vu pas, qëlloi fort i rëndë dhe jo kaq i nishanit. Peqinasi pat fat, se gjet përpara një arë misri dhe u zhduk brenda. Tërë xhandërmaria që e ndoqi, nuk e pikasi dot më. Tregonin se, në ullishtë, i arratisuri i mori pushkën një beqiu që po mbushte barkun majë një fiku dhe që armën e kishte lënë përtokë. Ja, kjo kishte ngjarë.

Plot një mot, vëloi druri i xhandarëve nëpër krahinat e Peqinit, po trimi i arratisur nuk ra në

dorë. Ai ra disa herë në përpykje me ndjekësit e vet dhe bëri të kafshojnë dheun një pesë e gjashtë prej tyre. Po, më në fund, atë që s'e kreu druri e plumbi, e kreu tradhëtia. Të arratisurin e hëngri në besë një njeri i veti dhe e zunë të gjallë tek flinte natën në stan.

Unë s'e kam parë kur e sollën në qytet. Tregonin se e shetitën pazarit, duke e rrahur e duke e gjakosur si mos më keq. Ai ecte me kokën lart, duronte dhe nuk nxirte as oh as uh. Pas dy javësh, e varën përpara bashkisë, një dite pazari, që të mund ta shohin sa më shumë njerëz.

Kam parë edhe të varur të tjerë atë mot dhe më pas, po fytyra e trimit peqinas nuk më harrohet. Ishte po ajo qenie që më shtiu datën një mëngjezi tek çezmja e Jan Dhespotit. Veçse unë tani kisha dhëmshuri të madhe për të dhe jo frikë. Qafën shumë të hollë e të gjatë, mënt ia këpuste litari. Koka e tij e mënjauar, sikur të kërcënonte me sytë e dalur që diku shikonin poshtë, nga e djathta.

Tamam nga e djathta, kishte qëndruar xhelati. Ky ishte ulur mbi kasonin që i shërbeu për të hytur të dënuarin dhe për të kryer punën e zezë. Qëndronte këmbë mbi këmbë xhelati dhe pinte duhan. Tymi i dilte nga një hundë patllixhane, mbi një buzë të çarë, ku gjembonte një mustaqe e rralle. Dukej t'i dilte tymi i tëri nga ajo e çarë e buzës, prapa së cilës çquante një çatall i zi. Me një dorë, xhelati mbante cigaren, me tjetrën ai kruante herë tullën e palavosur të kokës, herë gishtat e këmbës së tij të lerosur. Edhe xhelati kishte dy sy si qokla.

Shikoheshin i varuri dhe xhelati me qoklat e syve të tyre, jo sikur të kishin mbaruar së ndeshuri, dhe njëri të ishte mundur e tjetri të lodhej, po sikur të bëheshin gati për një ndeshje të re, shumë e shumë më të egër. I varuri kishte në sy një kërcënim të ngurosur, të cilin nuk mund ta shuante asgjë, as vdekja. Xhelati kishte një inat të çqetësuar në syrin e tij. Ky inat sikur i vërshëllente nëpër buzën e çarë.

Disa vetë iu afruan pak si tepër të varurit, për të lexuar mirë letrën e mbërthyer në këmishën e tij të bardhë, që i zbriste gjer në fund të këmbëve. Në atë letër, tregoheshin arësyet e dënimit. Xhelati u bëri me dorë njerëzve të prapsen, këceu në këmbë dhe nisi të bllaçisë me të egër disa fjalë turçe. Pastaj, duke u ulur përsëri mbi kason, ai nxori prej xhepit të shallvarëve një shishe me raki, e ktheu përgjysëm, pështyu, u briti dhe një herë njerëzve dhe nisi të kruajë përsëri këmbën e tij të lerosur.

Dikush e shau:

— Turçeliu i qenit!

Xhelati këtë radhë ngriti kokën me rrëmbim, ulëriti dhe rrotulloi qoklat e syve. Deshi të çohet, po ndofta, atë çast, vështrimi i tij hasi dhe një herë vështrimin e të varurit, se sytë sikur i ngrinë andej nga e majta, të tmershëm, në mos të tmëruar.

M'u rënqeth mishtë. U largova.

1958.

MALLI I SHQIPES

S'ka shumë vjet, kureshta më shtyu të rëmoj në një dollap të vjetër të shtëpisë. M'u drodh zemra kur gjeta aty një fjalor të Kristoforidhit fletë-fletë, gjysmat të brejtura nga minjtë, të tjerat të grisura nga duar të pandërgjegjëshme. Lere ç'turp që më erdhi nga ai rrenim! I mblodha një nga një fletët që, sado pak, mund të quheshin të shpëtuarra, i futa në një zarf, ku i ruaj dhe sot, — dhe ato vijojejnë akoma të më qërtojnë që nga zarfi i tyre.

Po në atë dollap, gjeta dhe një libër të moçëm dhe shumë të vjetëruar, të lidhur fort, jo veç me një lëkurë të trashë, po dhe me hekura në të katër çipat. E hap librin, e kqyr me kujdes, gëzim e çqetësim përzjerë. Është Ungjilli i Grigor Gjirokaskaritit, — ose i quajtur i tij, se dikush tjetër duket ta ketë përkthyer, një farë Vangjel Meksi, dhaskal e mjek nga Labova e Gjirokastrës. Botim i dytë,

Athinë 1858. Botimi i parë doli në Korfuz 31 vjet më herët.

Minjtë s'kishin mundur të depërtojnë dhe kaq shumë në librin e armatosur mirë të Gregorit. Unë lexova me orë të tëra asaj dite gjuhën e tij të rëndë — se arkaike sot, — po dhe kaq të bukur.

Shqipja e lashtë, cilido e pastë shkruar, më mallëngjen. Ajo tingëllon ose, më mirë, kumbon së thelli. Dhe, nëpër atë kumbim, zgjohen shekujt e çfilitshëm të pushtimit turk, zgjohen ata pleqtë tanë aq të duruar, aq burra, që vuajtën aq dhe që ruajtën farën tonë përmes luftave dhe çfarosjeve.

Kur lexon Buzukun dhe Budin, mund të të përçfaqet gjëma që e gjet Shqipërinë pas vdekjes së Skënderbeut dhe, nëpër atë gjëmë, kryengritësit e malësive, që nga Dukagjini e Mati, në Berat e në Himarë. Ata dërmojnë turqit nëpër grykat, hedhin pashallarët në det, besëlidhen nëpër kuvende, po s'arrijnë të çlirohen dhe më kot kërkojnë ndihmë nga Evropa dhe Papa, duke u kujtuar këtyre se janë bijtë e Skënderbeut zëmadh, që mbrojti Evropën dhe Papën nga hordhitë e barbarit.

Kur lexon Bogdanin, mund të shohësh auktorin shpellave, duke tërhequr pas vetes «librarinë» e tij, si ç'na tregon ai vetë, — bibliotekën, — apo duke shënuar nëpër copa letrash të trasha «fjalët plaka», që i thosh i ungji, Andrea, dhe që po «bdareshin».

E pastaj, — pastaj Dhaskalin e qytetit tonë, Todhrin, të cilin sikur e kam përpara syve me xhybe të gjatë e me gëzof, tek vizaton shkronjat e

tij të çuditëshme shqipe dhe ua mëson të afërmëve dhe miqve. Pastaj, agoninë e tij, në Dhiavat të Manastirit ose nën malet e Xhyrës, ku e vranë për ato shkronja.

Po, librat e moçme shqipe janë shkruar me gjak, — «en së dashunit së botësë sanë», thotë Gjon Buzuku. Dhe ato libra janë tërë një botë.

Ja, në dollapin e vjetër të shtëpisë, gjeta një Grigor të braktisur. Kushedi sa njerëz e kishin lexuar shqipen e tij netëve të errta e të pasigurta, me qiri në dorë. Dylli, si lot i përvëlur, kishte pikuar dhe pastaj kishte ngrirë nëpër fletët e librit, që të dëshmonte përmes viteve mallin e madh të gjuhës së nënës.

Në kapakun e fundit, përbrenda, të zotët e librit, tri-katër vetë, kishin shënuar, me shkrime të dobta, emrat e tyre. Munda të lexoj edhe emrin e tim gjyshi, Kovit.

Ishte libri i tim gjyshi! Unë këtë gjë duhej ta kisha kuptuar. Gjithë ato njolla të tjera që kishte libri, blana të mëdha e të murrme, mbi të cilat akoma shkiste dora, ishin njolla vaji. Im gjysh, mullis vaji, mbase në mulli e lexonte shpesh Grigorin...

Mullinj të e vajt! Po çduken fare. Lagja jonë në Elbasan ka qenë plot gjurma mullinjsh të çkateruar ose të mbyllur, përpara se të ngrënë francezët fabrikën te ura e Zaranikës. E zor të gjeje shtëpi pa magripë, si zor të gjeje shtëpi pa një ullishtë, sado të vogël. Me ullinj e vaj janë mbajtur kryesisht pleqtë tanë.

Mullinjtë e vajit kanë qenë plot, po njëri prej tyre i mbush kujtimet e mia.

Merrni me mend një çun gati të dobët, bardhsh, me hundën e mollëzat plot verike. Ai kish dy sy, ku shumë kureshtje përzjehej ndofta që ahere me një çikë ironi, të cilën, për moshën, unë do ta quaj shejtani. Mbi kokën doemos të qethur, çuni kishte dy kurora dhe nëna i thosh: «Do marrësh dy nuse, mre korb!» — sidomos kur ai hante me dy lugë në sofër. Ky çun, mëngjezeve të dimrit, në njërën dorë mbante një çantë basmaje, nga ato që Korça i quan pece, dhe në dorën tjetër, shpesh, një pite valë të rrumbullaktë e të madhe gati sa fytyra e tij.

Pranë shkollës, ai ndalej te mulliri i Dajë Monit. Mullisi plak qëndronte në të hyrë, nga e djathta, në gjysmë errësirë, këmbëkryq në një si tezgë. Kokën e mbante të zgjatur nga dera, që të shohë se kush kalon udhës e cili po vjen në mulli. Veshët e mëdhenj i qëndronin gjithëmonë ngrehur. Fytyra e tij, të thoshe se nuk qe e gatuar prej mishi, po e thurur me litarë, — në ballë horizontalisht, gjetiu vertikalisht. Midis rrudhave, depërtonte çomageja e hundës dhe mbinin dy xhufkat e mustaqes së thinjur. Të gjitha këto i kuqëlonte drita e tagarit që mullisi kishte përpara dhe mbi të cilin ai nderte panxhat e duarve.

Brenda në mulli, mezi dalloheshin argatët që i jepnin zemër njëri-tjetrit, duke shtrënguar një menjene të madhe druri, që kërciste në terr. Mengeneja shtrydhte një stivë çullash të gjera dhe të sheshme, të mbushura me ullinj të shtypur. Vaji buronte anësh dhe rridhte tatëpjetë si serë. Thellë nga

e majta, turfullonte një kalë, që vërtitej rreth një strumbullari dhe bënte të vinë përçark dy mokra të mëdha, në këmbë mbi një lëmë të lartë e të ngushtë, ku shtypeshin ullinjtë. Një çun, katër-pesë vjeç më i madh se shkollari ynë, i vinte kalit pas dhe i bërtiste «hajt» me një zë të fortë që gumonte mullirin.

Kali, çuni, argatët dhe mengeneja, trarët e mëdhenj të çatisë, ku vareshin pezhishkat si rrjeta peshkatarësh, gjithëçka ishte zhytur në një si banjë të përlyrët, gjithëçka lëshonte një grahmë të përlyrët bërsish, vaji, kuqle, vjetërsire. Edhe drita e pakë, ose më mirë errësira, aty si e përlyrët ishte. Dhe shkollarit i bëhej se një fshehtësi e frikëshme strukej nëpër këndet e errta të mullirit, të cilat syri nuk ia zbulonte dot. Në një mulli të tillë kish-te punuar dhe gjyshi tij dhe, me sa tregonin, edhe stërgjyshi!

— Mirë mëngjez! bërtiste shkollari.

— Mirë mëngjez! përgjigjeshin argatët.

Dajë Moni dukej sikur dëgjonte më shumë mesytë se sa me veshët e tij të ngrehur. Ai vërtet ishte fort i rëndë nga veshët dhe bota e quanin Mon Shurdhi. Ndonjë i rrallë mund që ia dinte emrin, kurse unë s'ia di as sot. Ai ishte dhe njeri pa njeri dhe pak i përzjerë me botë.

— Si u gdhive, Daj Moni? bërtiste edhe më fort shkollari.

Mullisit i shëndritnin sytë me ëmbëlsi, si dy kandile në një kënd të errët.

— Mirë se erdhe. Qofsh bekuar, çun i dajës, përgjigjej plaku me zërin e tij të ngjirur dhe shtrinte dorën e i merrte shkollarit piten.

Mullisi rrokte pastaj një thikë të madhe, që vetëtinte në dritën e tagarit, e çante piten së gjeri, e shtrëngonte me kanxhat e gishtave dhe pitja hapëj si një guackë deti. Dajë Moni vinte thikën në prehër dhe zgjaste dorën anësh, në errësirë. Së andejmi, ai nxirrte një qepshe të vogël. Duke kthyer qepshen përmbi pite, mullisi derdhte në të pak vaj, sikur të derdhte një fije qelibari të tretur.

Çuni merrte piten dhe ia ngulte dhëmbët, me një shijë që s'tregohet. Kur i vajosej goja dhe lëfyti, një ngrohtësi e çuditëshme ia qetësonte urinë e mëngjezit.

— Faleminderit, thosh më në fund shkollari dhe i qëllonte që t'i shkojë mendja ahëre te i gjyshi e të kish qejf ta përfytyrojë si Dajë Monin, me gazin te buza e me qepshen në dorë.

Atë çast, një tjetër zë çuni dëgjohej te praku:

— Mirë mëngjez, Dajë Moni!

Në duart e mullisit vetëtinte edhe një herë thika, e gatëshme të presë edhe një pite. Mullisi nuk ia kursente askujt vajin, po uronte:

— Shëndet e bereqet, gjak e dhjamë, çunat e daiës!

Një ditë, mësuesi mungoi në orën e parafundit. Mua ma kishte ngulur uria dhe renda në shtëpi. Ndalova një minutë përpara mullirit, ku disa fshatarë po ngarkonin plot kacakë të zez me vaj. Dajë Moni thithte cigaren në këndin e tij. Unë i lashë çantën në kujdes dhe zura përsëri vrapin. Nënë e gjeta duke larë dërrasat. I kërkova dollapët vetë

dhe, më në fund, i armatosur me një squndër bu-
ke dhe me dy qofte, mora udhën e shkollës, — ec
e kafsho, ec e huto. Kur po i afrohem mullirit,
dëgjoj një zë që bërtet:

*Dallëndyshe bukuroshe,
që thua mijëra fjalë,
dhe ta kënda vahn' e lumën
dhe detin me shumë valë...*

Njoha zërin e argatit të ri. Ai e lexonte vjer-
shën duke iu mbajtur goja, si fëmijëve në klasën e
parë fillore.

Futa këmbën në mulli. Çuni ishte ulur pranë
Dajë Monit, me librin të kthyer nga drita e derës
dhe, mu në rrzëzë të veshit, i lexonte ustait të vet
me britma vargjet e Naimit. Dajë Moni i kishte
ngulur sytë e ëmbël diku në errësirën e fshehtë dhe
cigarja e tij, si një xhixhillonjë, ndizej e shuhej në
kënd të buzës, nën strehun e mustaqes. Tek gjuri,
ai shtrëngonte çantën time të çelur.

Sa fort do të dëshiroja ta gjej sot atë libër
midis librave të vjetra të dollapeve të shtëpisë!
Duart e argatit të ri dhe duart e mullisit plak e
njollosën në disa vende librin tim të leximit. Mua,
të them të drejtë, nuk më erdhi hiç mirë, se kush
dëgjonte pastaj mësuesin në shkollë dhe babanë
në shtëpi? Po fort do të dëshiroja ta gjej sot atë
libër të vajosur. Nga ai libër, përmes zërit të ar-
gatit të tij të ri, Dajë Moni ka dëgjuar shqipen e
Naimit.

Im gjysh Kovi, shtatë-tetëdhjetë vjet më parë,
sigurisht edhe ai ashtu e kishte zakon ta lexojë

Grigorin, në mulli. Argatët shtrëngonin mengenenë, kali sillte rrotull gurët, mulliri ishte i errët, i mistershëm. Ndonjëri prej djemve të vet, në mos ndonjë argat i ri me sytë si xhixha, vinte dhe i lexonte ustait librin te veshi. Kovi mallëngjehej e dëgjonte Ungjillin shqip dhe kënaqej me atë gjuhë, që sot kumbon së thelli, — prej thellësisë së kohës së errët, ku, si në një mulli, ka qenë blojtur jeta e kaq brezave... Kovi dëgjonte Grigorin. Ahers'kishte filluar të këndojë gojëmjalte Naim, apo sa kishte filluar.

1958

NJE DITË TEK NAIMI

Atij mëngjezi qershori, një shi i hollë që kish vesëlluar, disa re që s'kishin më ç'të lëshojnë mbi qytet, veç hijes së tyre, e freskuan kohën.

Poeti vajti dhe u ul pranë dritares.

Gjelbërimi i larë i kodrinave, kërmëzi i vru-gosur i çative, minaret që ngrinin në qiellin bojë hiri patërshanat e tyre të ndryshkura, i jepnin Stambollit pamjen e një qyteti, që, me vetullat mvrenjur, përpiquej të kujtonte një rini fort të largët e gati të harruar.

Po a thua se kishte qenë ndonjëherë i ri ky qytet?

Naimi e kishte vrarë shpesh mendjen për historinë shekullore të Bizantit, të Konstantinopolit e të Stambollit. Që nga Roma e lashtë, poetit i prftoheshin silueta perandorësh hijerëndë, me ko-

kat e qethura dhe fytyrat e rruara, veshur me toga shumëpalëshe apo me ato si fustanella pallaskash, që u linin këcinjtë jashtë, me vështrime të ngurta, të cilat mermeri ua ka rojtur aq mirë, vështrime që të sjellin në mend pushtime dhe çfarosje. Mos ishte kjo rinia e këtij qyteti?... Pastaj, — Bizanti me intrigat e tij, me vasilefsët që hypin e bien sa herë ndërron moti e stina, dhe: vrasje, helmatisje, mbytje. Theodorat, që me hiret e tyre vrasin; patrikët, që me dogmat e tyre helmatisin; levantinët, që me arin e tyre mbytin... Së fundi, — së fundi sulltanët, njëzet e një sulltanë, që grumbulluan tërë atë përvojë të vjetër të Bizantit e të Konstantinopolit, që i shtuan asaj gjakësinë e moçme asiatike dhe e bënë Stambollin kryeqytetin prej ku ndehjet tmeri, rrenimi, vdekja, drejt Evropës, drejt Asisë, drejt Afrikës...

Nën atë qiell plumbi, Stambolli dergjej, i shtypur nga pesha e historisë së vet.

Samiu e kishte zakon të fliste shpesh mbi këtë histori gjaku, me mënyrën e tij zemërake. Po kur të dy vëllezërve u ikte ai çast zemërimi, kur hidhnin sytë nga bukuria e vendit dhe nga bukuria e qytetit të shtjelluar kodër më kodër e liman më liman, në mënyrë të natyrëshme ata përfundonin se njerëzimi kishte krijuar përmes gjakut.

Kohrat e Justinianit e të Sulejmanit el Kanun qenë kohra gjakatare dhe ato. Po ja, ahëre u ngrit Shën Sofia, një nga të shtatë bukuritë e botës, dhe Sulejmania, që pse të mos quhej e teta? Këtë e kishite ngritur Sinani nga Vlora dhe, ndërsa turqit mburren për xhaminë e tyre, ne shqiptarët as që e dimë se kush e ka ngritur.

Ky ligj, — i krijimit përmes gjakut, — mos do mbetet i përjetshëm? Një pyetje e tillë e mundonte shpesh poetin.

Samiu, që nuk ishte më pak ëndërrtar se i vëllai të ardhëmen e shihte dhe ai të ndritur. Shën Sofia dhe Sulejmania ishin vetëm agimi i mendjes njerëzore. Dhe gjer tani vonë, njerëzimi ka qenë në foshnjëri, e kish zakon të thotë Samiu. Tani sapo ka filluar njerëzimi të dalë nga gjendja e foshnjërisë. Doemos, iu desh që të thyejë shumë, pa të ndërtojë pak. Tani ka filluar koh' e burrërisë, kur njerëzimi i pjekur po bën mrekullira me anë të shkencës. Po njerëzimi do të piqet vërtet vetëm ahëre, kur njeriu të mund të dalë prej kësaj botës së tij të vockël, të hidhet në hapësirën e pamasë dhe të njohë botërat e tjera të panumurta. Sa për perandorët, vasilefsët e sulltanët, këtyre, shekujt nisën t'ua vënë fshesën. Ata i përkasin kohës së foshnjërisë njerëzore, dhe kjo nuk është vetëm një kohë miturie, po dhe egërsie.

Kështu arësjetonte Samiu.

Naimi e dëgjonte admironjës. Mendja i ushqej me dashuri dhe besim për njeriun. Do të vijë një ditë vallë, që të urtë si Samiu të qeverisin punët e kësaj bote? — ëndërronte Naimi dhe qeshte me vete, se, po të qe sa për atë vetë dhe për poetët, bota do të ishte një Gjylistan edhe më i bukur nga ai i Saadiut, po, pa dyshim, poetët, për të ëndërruar, të zotët ishin, — për të ndërtuar, ... vallahi!...

Ej Stamboll, Stamboll, që të fut në të thella! Këtu pat sunduar Justiniani e Sulejmani, këtu pat ndërtuar Sinani, pat kënduar Baku dhe Nezimi ynë i ëmbël e çapkën, Nafizeja, që me vargjet e saj

magjepste dhe gurët. Dhe këtu rron sulltan Hamiti.

Bosfori, ai si lumë i dallgëzuar, të cilit sot i gjelbërojnë ujrat si në një ditë vjeshte, po të kishte gojë e të fliste, kush e di se ç'do t'i thosh qiellit, që duket sikur atje lart harron shpejt apo s'para ua vë veshin punëve të kësaj bote.

Të thuash se s'ka Perëndi?

Samiu, sa herë arrinte këtu, — këtu e sillte një brengë e madhe, një si mëri e thellë, të cilën më kot përpiquej t'ia fshehë vetes, dhe që Naimin e trondiste, e trembte, se ajo brengë i dukej si e përligjur.

Përse në këtë botë trëndafili dhe gjembi nuk mund të rrojnë pa njëri-tjetrin? Përse e drejta ushqehet nga e shtrëmbëra, e bukura nga e shëmtuara, jeta nga vdekja? Përse gjaku duhet të vaditë të mirën, të bukurën, jetën, që pa të as mbijnë, as rriten dot? Mos dhe Perëndia e ka zemrën ferrë e trëndafil përzjerë, që me ngjyra dhe erë na deh, po që na gjakos me gjemba? Thua se Perëndia është skllave e së ligës, duke qenë ajo e mira vetë?

— Po si të mund ta quajmë ahere Perëndi? pyeste me ankth Samiu dhe tronditej e trembej Naimi, të cilit kjo pyetje i dukej e përligjur.

U dashka që një popull të vuajë qindra e qindra vjet, që të mund të shohë një ditë të bardhë? Mos përjetësisht mirësia dhe bukuria lind e do të lindë nga dhimbja, si fëmia nga barku i gjakosur i nënës?

Ej gjithësi, gjithësi, që na mban haps në burgun tënd të madh e të mahnitshëm, prej nga shqiponja ëndërr, sado krahë të lehtë pastë, nuk na nxjer dot asnjë çast! Kup' e qeltë e qiellit s'ka

anë e fund, po gjithë e qeltë është, dhe me anë, dhe me fund, qoftë dhe për shqiponjën ëndërr...

Një fishkëllimë vapori, si një fshikull i fortë, ia goditi poetit ëndërrimet, dhe këto, të shushatura, vanë e u strukën në këndin e tyre të errët. Naimi zgjati dorën e mori një tufë letra dhe një laps mbi minder, i hodhi një sy fletës së parë, i lëshoi letrat mbi gjunjë dhe përplasi pëllëmbët.

Dera nuk u ndje fare kur u çel. Rrezet që hyjnë nga dritarja, binin të gjitha drejt te ajo derë, në fund të dhomës. Një vashëzë hyri, e mesme në shtat, e bardhë në fytyrë, me syun të zi, të qeshur dhe si të çuditur, me gërshetat mbi krahërorin e posangritur, linjën të bardhë tërë gjymysh, jelekun ari, çitjanët tyli. Kur hyri, çapi i saj nuk u ndje, po u ndje fërkimi i arit e i mëndafshit.

— Urdhërove gjë zotrote? pyeti vashëza.

— Nem edhe një çaj, moj bijë, iu përgjigj me dashuri Naimi.

* * *

Ganiu ishte një djalë i shkathët, më shumë i hedhur se i menduar, më shumë i veprimit se i ëndërrimit. Ishte korçar dhe mburrej edhe ai pak si tepër me bukurinë e qytetit të vet e me rolin që ky qytet po loste në lëvizjen kombëtare.

Po këto ishin akoma çfaqjet e miturisë së tij prej djali gjashtëmbëdhjetë vjeç. Mustaqja që kishte filluar t'i dirsë, shtati që i kishte marrë shpejt përpjetë, pëllëmba eshtërmadhe, që, kur ta jepte, të rrëmbente krahun, sytë e zez që nuk ishin më aq të lëvizshëm, flitnin të gjitha për pjekurinë që po vinte shpejt. Prapë, Ganiu ishte gjashtëmbë-

dhjetë vjeç: ai habitej akoma çdo ditë me gjërat e reja që mësonte në klasë e nëpër libra. Po përveç kureshtës, më të zhvilluar nga çdo gjë Ganiu kishte ndjenjën e drejtësisë.

Asaj dite të mvrenjtur qershori; Ganiu kishte për të dhënë të fundit provim të vitit, frëngjishten. Mësues të kësaj gjuhe kishte një çerkez të gjatë e të thatë, ezmer, me një palë vetulla tre gisht, me dy sy si gogla, që të shikonin nën gjyzykë sikur do të të goditnin. Po sa i egër paraqitej, aq i urtë ishte «mualimi», si ndonjë luan i zbutur. Kur fliste për Francën, dukej sikur po shante Turqinë, me gjithë që këtë as e shante as e lëvdonte kurrë. Këndimet i nxirte nga Volteri e Rusoi, me gjithë se këta i pat quajtur një herë «qafirë» dhe për vrasjen e Luigjit të XVI-të kishte treguar keqardhje të vërtetë. Mësimin e tij nuk e merrje vesh mirë se ç'qe, gjuhë frëngjishte apo histori e Francës. Aq sa mund të merrje vesh mësuesin vetë, se qe çerkez apo luan i zbutur. Veçse kishte një të keqe të madhe: dy fjalë të mos dije, një notë rrumbullak të rrëzonte; me gjashtë fjalë, mbeteshe në vjeshtë; me dymbëdhjetë humbje vitin. Po mësimi i tij, vetëm të ishe ndonjë kokëshkëmb që mos të të hynte në tru dhe mos të qëndronte aty përngaherë.

Ganiut, në gjithë mësimet, nuk ia dilte njeri; në frëngjishtet edhe çerkezi vetë e ndjeu veten ngushtë me këtë shqiptar. Sidoqoftë, provimi është provim, dhe nuk ishte vetëm çerkezi që do të pyeste, po një komision prej tre vetësh, sipas zakonit. Kur u gjend përpara këtij komisioni, kur zunë ta vësh-trojnë dy të panjohur nga lart poshtë e nga poshtë lart, sikur do ta bënin «okllamà» për ushtar, Ganiu diç u topit.

— Si të quajnë? pyeti rëndë-rëndë dhe me përtim kryetari i komisionit, me një hundë të kuqe e si me lule, me sytë gjysmë të çelur dhe festen që sa mezi i qëndronte mbi një si kokë ariu.

— Gani Korçari, u përgjigj nxënësi dhe u drejtua.

— Korçari? bëri si çudi hundëkuqi e ktheu kokën nga çerkezi, që shpjegoi:

— Është nga Korça e Arnautllëkut.

— Ehë, përçmoi buzët kryetari i komisionit dhe i shkeli syun shokut të tij nga e djathta, një si kokështrembër ky, që të shikonte sikur po të përçeshte, i zi e i verdhë, me një palë gjyzlykë të trashë, prapa të cilëve sytë i dukeshin si dy saçma.

Kokështrembëri u koll me një kollë të thatë, nga fundi i krahërorit të tij dy pëllëmbë, vajisi kokën, ndreqi festen që desh i ra dhe u tall me zërin si të pibzës:

— Aferim, Arnaut! Manda qitapi juti! (librat tuaja i ka ngrënë buallica!) dhe tundi një gisht si grep, duke lëvizur saçmet e syve.

Ganiut iu rrotullua dhoma. Po, hazërxevap si ç'ishte dhe që s'i bënte syu bef, ia pat:

— Manda qitapi jutmadi! (librat tona s'i ka ngrënë buallica!) dhe u drejtua dhe e hëngri me sy.

Ashtu e kishin zakon të tallen turqit me shqiptarët, duke i trajtuar si njerëz të paditur dhe pa gjuhë të shkruar.

Ai hundëkuqi ia krisi gazit. Kështu bëri dhe shoku tij, dhe ky dueto zgjati një minutë të tërë.

Çerkezi u zverdh e u nxi dhe shikonte qërtueshëm e mëshirues Ganiun, duke dashur t'i thotë:

«Po ty ç'të duhet, mor bir!»

Gazi ra dhe kokështrembëri pyeti me atë zë pibze:

— Mos vallë shkruhet arnautçja, mor i bekuar?

— Që përpara Skënderbeut! ia pat Ganiu, që kish kënduar një gjë të tillë në «Kamusin» e Sami Frashërit.

— Ç'është ai Skënderbe? pyeti hundëkuqi dhe shoku tij u mat t'ia shpjegojë në vesh, kur Ganiu u përgjigj me fort:

— Mbreti ynë!

Kokështrembëri sikur u zbut e tha:

— Ju s'keni pasur mbretëri ndonjëherë, mor bir. Skënderbeu ishte një rebel, që fshihej maleve dhe pyjeve në kohë të sulltan Fatiut. Këto gjëra as që i përmend historia.

— Po ju nga i dini? iu kthye Ganiu.

Tjetri bëri sikur nuk e dëgjoi e tha:

— Edhe gjuha juaj, mor bir, se dhe ju kenë një gjuhë, është si gjuha e shumë fiseve që rrojnë maleve dhe pyjeve, si në kohë të Nuhut, po që vetëm ata e marrin vesh dhe askush nuk e shkruan e nuk e këndon, gjuhë pa qitap, se nuk është për dituri, po për barinj, tha ai dhe vështroi nga çerkezi. Ky kishte hequr syzet, që po i dridheshin aq fort në duar duke i fshirë, sa mezi i mbante.

— Ti na u lëvdove se arnautçja shkruhet që katër qind vjet më parë, u përpoq dhe e mblodhi pak veten çerkezi dhe nisi të skuqet. — Mirë. Po me çfarë shkronjash, as na thua?

Ganiu diktoi në vështrimin e mësuesit një mëri që s'e kishte parë tjetërherë, një mëri të vërtetë hakmarrëse kundër këtyre dy edepsëzëve që po ia

mundonin aq fort nxënësin e tij më të mirë, dhe që e përçmonin dhe atë vetë, si malësor Kaukazi që ishte. Djali nuk tha asnjë fjalë, po rroku një copë shkumës dhe shkroi mbi dërrasë të zezë:

«**Shqipëria është një vend i Evropës. Shqipja është një gjuhë evropiane. Ajo shkruhet me shkronja latine.**»

I shkroi këto fjalë shpejt e si duke goditur dërrasën e zezë. Turçelit, ca nga ky rrëmbim, ca prej guximit të djalit, ca nga fakti vetë se shqipja u shkrojtka, bile dhe me shkronja latine, e humbën toruan.

— Ç'thonë ato fjalë latinçe? pyeti përsëri çerkezi, që tani e kishte marrë veten dhe i kishte vënë syzet.

Djali i përktheu fjalët turqisht.

— Përkthei frëngjisht! urdhëroi çerkezi.

Tak-e-tak, Ganiu i përktheu fjalët frëngjisht, pa pikë zori, dhe turçelit të thuash se ulën kokën. Çerkezi i lojti syun, buzagaz.

Do të kishte dashur atë çast Ganiu të fuste duart në xhepa dhe të nxirte librat e Naimit e të Samiut, që i mbushnin shpesh ato xhepa, t'ua përplaste turçelive në surrat e t'u thosh:

— Ja, more qen e bir qensh! Shqipja ka libra dhe këto libra këtu në Stambollin tuaj shkruhen! Gjuhë e një kombi nuk ndalohet dot kurrë, ka thënë Naimi ynë! Na, plasni sytë!

Kryetari i komisionit filloi ta pyesë, me për-buzje, dhe djali iu përgjigj plot zërin, inatçe. Inatçe ia pohonte të gjitha çerkezi me kokë.

Edhe një herë, nota që e shkëlqyer.

— Mirë! u çorr hundëkuqi dhe i bëri shenjë nxënësit të largohet.

Kur u mbyll porta prapa djalit, turçeliut i vënë prapë sytë mbi dërrasën e zezë, e tha:

— Sot jam i sëmurë. Vazhdojmë nesër, efen-dinj.

* * *

Ganiu doli nga salla e provimit me inatin e vrullin që kish, përplasi derën dhe i zbriti shkallët e atij kati nga dy e nga tri bashkë. Disa shokë që po i prisnin te dera e dhomës së provimeve, as që patën kohë t'i flasin.

Po kjo kështu? Si nuk i pa fare? Mos kishte marrë ndonjë notë të keqe?

— Gani! Gani! i thirri e iu vu pas Reshati, një vogëlush që nuk tregonte as katërmëdhjetë vjeç, gjithëmonë i pari në lodra e i fundit për t'u shkukur prej tyre.

Ganiu qëndroi, ngriti kokën dhe majë shkallëve pa shokët, me sytë e tij tërë lot e kanosje. Këta u stepën. Pastaj, zbritën me turr, e rrethuan dhe sekush ta pyeste më parë:

— Të hëngrën notën?

— Jo! tundi kokën ai e i hodhi krahun mbi sup Reshatit, të cilin e donte mbi të tjerët dhe e kishte nën mbrojtjen e vet në shkollë, ku zakonisht shqip-tarët nuk e ndjenin veten të sigurt midis turqish.

Dolën në rrugë e morën tatëpjetën nga Bejolli. Ganiu u tregoi ç'i kishte ngjarë me turçelit e komisionit. Kur po mbaronte ai së treguari, u gjendën në një kopësht të vogël publik.

— Ne s'kemi ç'të presim më! foli i pari Reshati, me sytë plot, dhe u ndalën. — Me turqit nuk bëhet!

— Ka dyzet vjet që këta të pabesë po na i gënjejnë baballarët tanë! u hodh Ganiu. — S'kemi se ç'të presim më! Shoqëria jonë duhet formuar që sot!

— Që tani! ia pat Shahini, i cili, në shtat e në zë, tregonte të ish më i madhi prej tyre.

— E pse mos ia apim besën shoqi-shoqit që këtu? u entusias Mihali.

— Që këtu! Që këtu! u entusiasën të tjerët.

— Të lumtë goja, o vëlla! e rrëmbeu Ganiu Mihalin dhe e puthi, duke përmbështjellë me dorën tjetër edhe Ndocin e duke e puthur dhe atë.

U ulën këmbëkryq te rrëza e një rrapit të madh, mbi lëndinë. Ganiu nxori nga xhepi një libërth me kapakun e gjelbër, e vuri mbi bar, e shtriu mbrë me dorën e tij, dhe sytë e të pestëve lexuan mbi atë libërth: «Bagëti e bujqësia».

— Ne jemi nga të tri besimet, foli Ganiu. — Po ja qitapi ynë i përbashkët. . . Pa vini dorën mbi këtë qitap, o vëllezër, e thoni pas meje: Betohem, se Shqipërinë, që kam në zemër e në shpirt, mëmën time, mëmën e Skënderbeut e të Naimit, do ta çliroj ose do të vdes për të, me pushkë në dorë!

— Betohem, se Shqipërinë, që kam. . . , përsëriti i pari Shahini dhe, me radhë, Mihali, Ndoci e i fundit Reshati, me zërin e tij të hollë prej mituraku.

Ganiu u përkul pastaj e puthi librin, që u përkulën e e puthën me radhë, i fundit Reshati, i cili e mori atë libër, çkopsiti uniformën dhe e futi në gji.

— Ma fal mua tani këtë, o Gani! u lut vogëlushi.

Ganiu u mendua e tha:

— Falë të qoftë, o vëlla, po ky është qitapi i shoqërisë sonë, qitapi që dëgjoj betimin tonë. Unë them se mbi këtë duhet të betohen gjithë shokët që do të bëjmë nesër-pasnesër.

— Edhe unë ta fala, tha Mihali, — po ta ruash, që mbi të të betohen gjithë të tjerët.

— Kështu qoftë, pranoi dhe Ndoci.

Shahini i vuri dorën vogëlushit mbi kokë dhe i ngriti perçen që i zinte sytë:

— Reshat, tha, — unë mendoj ndryshe. Sot duhet vajtur te Naimi. Këtë libër t'ia falim atij.

Nëpër sytë e pikëlluar të Reshatit, kapërxeu një shkëndijë gëzimi.

— Mirë! Po t'ia ap unë ama! Me dorën time! Të gjithë qeshën dhe secili u ngrit të përqafohet me të gjithë.

Njerzit që kaluan andej, ua patën zili këtë dashuri dhe mjaft qenë ata që u ndalën një çast.

— Po na shikojnë! përshpëriti Reshati, që vërente çdo gjë, dhe u larguan e morën udhën e Bejollit.

* * *

Kur arritën djemtë në shtëpinë e poetit, që ahëre banonte në një lagje të Ysqydarit, pranë Hajdarpashait, do të ishte ora dhjetë e mëngjezit. Shtëpia e Naimit ishte mbi një kodër, në mes të një kopështi të vogël me bajame e pjeshkë. Pjeshkët sapo kishin filluar të skuqin në degë. Shtëpia ishte gati e tëra prej çatmaje në katin e sipërmë, me dri-

tare e kafaze bojë qielli. Ai kat dilte përpara i tëri, si një verandë e madhe e mbyllur.

«Ja këtu banon mendja dhe zemra e Shqipërisë!» u mallëngjye me vete Ganiu. «Ai që duhej të banonte në një pallat edhe më të bukur se Dollma Baçeja!»

U panë një herë të pestë, se kush të hynte i pari, dhe Ganiu, me guximin e tij të zakonshëm, shtyu derën e hekurt të oborrit dhe hyri. Kur trokiti te dera e shtëpisë, një zë femre u dëgjua lart:

— Urdhëroni, urdhëroni!

Shkallët e drunjta ishin pak të errta dhe shumë të përpjeta. Djemtë u ngjitën varg, thua se në majë të gishtave dhe duke mbajtur frymën. Dhe ja, atje në krye të shkallëve, i priste një vashëz me dy sy si të habitur, me një tabaka në dorë, ku lëshonte avull një gotë e madhe çaji.

Vashëza vuri gishtin te buzët e saj të fryra dhe i bëri Ganiut shenjë që të heshtë, kur ky u mat të flasë, me dorën te jaka e mbyllur e uniformës së tij, që sikur po e mbyste.

Prapa një dera, dy çape më tutje, filluan të dëgjohen këmbët e një njeriu që ecte ngadalë.

«Po del ai vetë!» menduan të pesë shokët menjëherë dhe u ndalën zemrat e tyre së rrahuri.

I mahnitur, Shahini shihte vashëzën, që dhe ajo atë shihte dhe sikur i buzëqeshte lehtë, dhe gati sa nuk e mbështeste në kopsat e verdha të uniformës së tij tabakanë që mbante me të dy duart.

Poeti nuk doli. Çapet e rregullta e disi të rënda të tij, u bënë më të shpeshta, dhe u dëgjua zëri tij, një zë i plotë dhe i ëmbël, ndonjëherë edhe i mve-

shur. Poeti kruante shpesh gurmazin, qëndronte një grimë dhe rifillonte.

*U ngrit fat' i Shqipërisë
si i vdekuri nga varri,
mori udhën e Asisë
duke ikur si i marri...*

Vargjet ndiqnin vargjet dhe ky fati i Shqipërisë, që mori fytyrën e Gjon Kastriotit, zërin dhe zakonin e tij, si ç'thosh poeti, shkoi në Siri, tek luftonte Skënderbeu për sulltanin, e i tha trimit se Shqipëria nuk mund të priste më.

*A më sheh ti mua plaknë?
Të qënkështa si ti, djalë,
Muratit i pinja gjaknë,
sot s'gënjehesha me fjalë!...*

Ganiut i kishte hypuq një si të dredhur, shtrëngonte fort me të dy duart supet e Reshatit dhe po dridhej. Vashëza shikonte herë njërin, herë tjetrin, me syun e saj të qeshur e si të çuditur, dhe shtrëngonte fort në duar tabakanë.

— Sikur t'i ketë shkruar për sot! pëshpëriti për vete Shahini, po e dëgjuan dhe të tjerët.

Vashëza vuri dhe një herë gishtin te buzët dhe e tregoi me sy se nuk duhej bërë zhurmë.

Që përmatanë, çapet e poetit nuk u dëgjuan një çast, po u dëgjua fërkimi i fletëve të kartës që ai mbante në duar. Pastaj, nisi prapë peripatoja e tij e rregullt e disi e rëndë, që përcillte vargjet.

*Kruj', o qytet i bekuar,
prite, prite Skënderbenë!
Po vjen si pëllumb i shkruar
të shpëtojë mëmëdhenë!...*

Zemrat e djemve që kishin qëndruar të dëgjojnë, nisën të rrahin me forcë. Ata u shtrënguan midis tyre, me Shahinin në krye, që zuri të mbajë dhe ai me dorë tabakanë e vashëzës. Kjo nuk lojti, po u bë gati një grup me ta, duke u kthyer fytyrën, si roje e asaj dere, prapa së cilës poeti e kishte ngritur tani fort zërin dhe çapin e kishte bërë vërtet të rëndë.

*O moj vash' e Shqipërisë,
që më rri duke mejtuar,
pa i xhvish rrobat e zisë,
arriti dit' e shënuar!...*

Vashëzës i mbuloi fytyrën një hir i zjarrtë dhe djemtë e vështronin atë, që dukej sikur desh t'u thotë me sy:

«E dëgjoni? Po flet dhe për ne vashat!»

U bë një heshtje e gjatë. Vashëza tërhoqi tabakanë nga dora e Shahinit dhe bëri një çap nga dera. Zëri i poetit e stepi. Ai mezi dëgjohej, i ëmbël, i qetë, dhe çapi i tij ishte ndalur.

*Dhëndëri si djelli ndrinte,
edhe nuseja që prunë,
posi hëna vetëtinte,
dritënë në drit' e shtunë.
Kish leshëra prej floriri
e trupn' e kish prej ergjëndi,
ish si lulja ndaj të gdhiri,
ndrinte soje gjithë vëndi...*

Nuri i vashëzës ishte bërë flakë. Ajo kishte ulur sytë dhe shikonte tabakanë që nisi t'i dridhet në duar. I dukej sikur djemtë po e përcëllonin me sy.

Po dhe sytë e tyre shikonin dyshtemenë, dhe toga e djemve ishte mbledhur e shtrënguar, sikur të desh secili të mos digjet nga drita që lëshonte përçark vashëza e bardhë.

Poeti heshti. U bë një qetësi e madhe. Dy-tri harabela, që losnin te dritarja e vogël dhe e hapur mbi shkallë, më kot u përpoqën me cicërimën e tyre të zgjojnë të dy palët, djemtë kënde, vashëzën andej, nga mendimet e tyre. Vetëm heshtja e gjatë e bëri këtë punë.

— U ftoh fare ky çaj! pëshpëriti vashëza dhe ngriti sytë e saj të mëdhenj, u kthye shpejt e i kërcyen gërshetat.

Lehtë-lehtë, ajo çeli derën e futi kokën brenda. Ata mundën të shohin poetin e ulur në minder, me një tufë letra te gjunjët, duart kryq mbi krahëror, me kokën të mbështetur në një jastëk të lartë e të kuq, pranë dritares. Kishte mbyllur sytë dhe dukej sikur flinte.

— Zotrote kërkove çaj, foli vashëza, — po çaji u ftch!

Naimi ktheu kokën dhe i qeshi.

— Fajin e kam unë, moj Nevrez. Sille, nuk prish punë, e pi dhe të ftohtë babai.

Nevrezi nuk e mbylli derën pas vetes, po nxi-toi e i vuri t'et tabakanë mbi minder dhe djemtë e dëgjuan t'i pëshpëritë:

— Janë aty ca efendilerë të vegjël, që duan të flasin me zotërinë tënde.

— Të vegjël? bëri çudi ai.

Vashëza pohoi dy-tri herë me kokë dhe Naimi u ngrit vetë dhe hapi mirë derën, duke thënë gjithë ëmbëlsi:

— Po urdhëroni, urdhëroni, mor djem.

Ata u ulën pranë e pranë, ngushtë e ngushtë, mbi një nim që zinte gjithë anën e dhomës nga e djathta e derës. Naimi u ul në minderin e tij afër dritares. Nevrezi vajti e qëndroi te dera, ku priti, me duart në gji, urdhërat e t'et.

— Sillu këtyre miqve nga një llokume, tha poeti. — Pastaj na sill edhe nga një çaj. Po të jetë i ngrohtë, vuri ai buzën më gaz dhe vashëza uli sytë e saj të qeshur e doli shpejt.

Naimi nisi t'i pyesë me radhë e gjatë se cilët ishin dhe në cilën shkollë mësonin. Reshatit, atje në fund të nimit, iu bë sikur nuk po i vinte radha kurrë. Kur poeti mbaroi me Mihalin dhe doli mik i babait të tij, një baçevan nga Postenani, kushëri i Jani Vretos, të voglit nuk iu durua dhe ia preu fjalën:

— Unë, Naim bej, jam djali i madh i Rustem efendi Qesarakës!

Poeti ngriti kokën dhe sytë e tij të zez e të thellë, e qeshi me mallëngjim të vërtetë.

— Ja dhe një mik më shumë! ia bëri. — I Rustem efendiut je, mor bir? Po hajde të të puth!

I vogli iu lëshua e i ra në gjunjë, i puthi dorën, dhe Naimi i ngriti kokën e e puthi në ballë.

— Ti je ai Reshati, për të cilin më ka folur kaq herë Rustem efendiut? Ty të munduan ca çapkënë turq një ditë dhe të dbuan një muaj nga mësonjëtorja? . . . Po kujdes, mor djema, iu drejtua ai të gjithëve. — Mos e merrni me të rrëmbyer, se dëmtohi në mësimet. Këto punë do të ndreqen pa vonesë dhe nuk do të kemi pse të zihemi me turqit.

Ganiu u hodh e pyeti:

— Shpejt do të bëhet Shqipëria, Naim bej?

Poeti nuk u përgjigj menjëherë, po ngriti Reshatin, e uli pranë vetes, i mori kokën dhe, kur i lëmonte flokët me ata gjishtërinj të hollë e si qelibari, të voglit i kalonte një përqethje e dashur nëpër shtat.

— Shpresën e kemi të madhe, foli mendueshëm Naimi.

— Ashtu është, nuk iu ndejt Ganiut pa pohuar dhe u skuq se iu duk sikur i preu fjalën poetit, që i tha:

— Pa eja dhe ti këtu, mor bir.

Ganiu vajti e i puthi dorën, me rrëmbim e me zjarr, dhe u ul dhe ai pranë tij, nga ana tjetër.

Duke shtrënguar e duke përkëdhelur të dy djemtë, Naimi vijoi:

— Tani e kemi më të madhe shpresën. Dhe çdo ditë që shkon, bëhet edhe më e madhe. Tani, mëmëdhethi ynë s'është më ai që ka qenë. As shqiptarët nuk janë më ata që kanë qenë. Tani, jemi ca më të bashkuar se njëherë dhe shkruajmë e përhapim gjuhën tonë, që na ndriton e na bashkon. Pa janë bërë mijra e dhjetra mijra ata që shkruajnë shqip. Janë bërë dhe kaq shoqëri, që përpiqen për të bardhëzën dritë. Ato shtypin vivilla e fletore dhe kanë hapur dhe ndonjë shkollë në mëmëdhe. Po na mësojnë kështu dhe të vegjëlit shqip e po na bëhen mëmëdhetarë të vërtetë. Ja Reshati dhe Mihali, këndojnë shqip. Ajo jo? Dhe ju...

— Edhe ne këndojmë! Ka dhe shumë të tjerë si ne në Stamboll, u hodh Shahini.

— Qofshi të gëzuar, mor djem! Ka edhe vajza, buzëqeshi poeti nga Nevrezi, që hyri e solli mbi tabaka një pjatë me llokume. — Embëlsohuni, o bij, tha Naimi dhe mori e u dha vetë nga një llokume Reshatit e Ganiut.

Kur u gostitën të gjithë, Nevrezi pëshpëriti:

— Po ti, baba, nuk do të marrësh?

I jati shtriu dorën, mori një llokume e tha:

— Embëlsohu dhe ti, moj bijë, merr edhe një, i bëri ai shenjë me sy, duke parë një pluhur sheqeri që zbardhte në majë të buzëve të saj të kuqe.

E turpëruar, Nevrezi uli kokën e doli me rrëmbim.

Secili hante llokumen e tij në heshtje. Naimi, me një gëzim të rrallë, ndjente një prehje të çuditëshme, vështronte herë njërin, herë tjetrin, dhe mendja i shkonte larg, te koha kur ai mësonte në Zosimea të Janinës.

Ahere, atë e entusiasmin trimëritë e Ali pashë Tepelenës dhe të Gjolekës, që populli i këndonte dhe i tregonte aq fort. Mëria e turkut, me gjithë se kishte filluar t'i zgjohet, prapë nuk e bënte që mendja t'i fluturonte te Shqipëria e nesërme, te çlirimi i saj. Sa për libra shqipe, ai të tilla s'kish njohur ahere, veç «Hadikasë» së Dalip Frashërit. Në Zosimea, Naimin kish filluar ta bëjë për vete dituria, që i zbulonte kaq të fshehta të botës. I pëlqenin mbi të gjitha shkencat e natyrës. Po, për të magjepsur, e magjepste Saadiu. Kishte filluar kështu të bëjë edhe vjersha persisht. Shqip, vetëm ndonjë bejte thurte, më shumë për t'u eglendisur e për të bërë shaka me të vëllanë, Samiun, e me shokët e gjimnazit.

Këto kështu ngjisnin njëzet e pesë vjet më parë. Ahere filloi të flitet diçka haptazi në Janinë për shqipe e për Shqipëri. Naimi ishte djalë mbi të njëzetat, ishte burrë, se kishte shkuar shumë i madh në shkollë, nëntëmbëdhjetë vjeç. Zjarri për shqipen e Shqipërinë, që lëshoi një shkëndijë në zemrën e tij, do të merrte hamull gati dhjetë vjet më vonë.

E tillë ishte djemuria e asaj kohe. Pa shih çfarë djemurie po rritet sot! Si të mos bëhet shpejt Shqipëria?...

Shokët pritnin që ta çilte gojën i pari Ganiu për ato që kishin menduar t'i thonë Naimit, po Ganiu sikur nuk po e mbaronte dot atë llokume të shkretë.

Reshitit nuk iu durua dhe foli:

— Si thua zotrote, Naim bej, nuk erdhi koha që të rrëmbejmë të gjithë pushkën për liri të Shqipërisë?

Poeti sikur u zgjua nga mendimet. Ky djalë përsëriste tamam atë pyetje që kishte bërë kaq herë Rustem efendiu, gjithë në atë odë e mbi atë minder. Iu qesh një herë, kur dëgjoi fjalët «të rrëmbejmë të gjithë». Mituraku e fuste veten midis atyre që duhej të luftonin! Po ajo pyetje e tij, që tingëllonte më shumë se një pohim, edhe pse e thënë nga një fëmijë, e preku thellë. U mendua pak e u përgjigj:

— Po të jetë nevoja, or bir, edhe do ta bëjmë.

— Nevoja është, ia pat së fundi Ganiu. — Si thoshit ju qëparë? «Muratit t'i pinja gjaknë!»

Naimi qeshi me të madhet.

— Më paski dëgjuar që prapa derës! ngriti ai gishtin si në mënyrë qërtuese, qeshi prapë dhe qe-

shën të gjithë. — Unë flas në atë vjershë për historinë e Skënderbeut.

— Po flisni si për sot. Naim bej. tha Shahini, dhe poeti ndjeu një gëzim të madh, se vargjet e tij nuk linin dyshim, as për këta të rinj që sapo merrnin krahë.

Heshtja dhe buzëqeshja e tij qenë një pohim. Dhe kjo heshtje u zgjat. deri sa Reshati mori guxim përsëri:

— Ne jemi betuar se, ose do ta çlirojmë Shqipërinë, ose do të vdesim me pushkë në dorë, Naim bej! tha ai, ngriti kokën dhe i ndritën sytë e zez.

Naimi, që s'i priste këto fjalë, mbeti, duke shtrënguar fort Ganiuun pas vetes dhe duke i rregulluar perçen të voglit.

— Si kështu? pyeti me një gjysmë zëri.

Ahere Ganiu u shkëput prej krahut të tij, u çua në këmbë, u drejtua përpara poetit dhe, me një zë të dridhur, që shpejt u qetësua dhe u bë i fortë, i tregoi Naimit se ata të pestë kishin një muaj që menduan të formojnë një shoqëri të fshehtë për lirinë e Shqipërisë. Në atë shoqëri, do të futnin më pas edhe shokë të tjerë të mirë e të sigurtë, që nuk mungonin ndër të rinjtë shqiptarë të Stambollit. Shoqërinë do ta shtrinim pastaj kudo që kishte shqiptarë e sidomos në mëmëdhe. Shoqëria do të formohej me grupe prej pesë vetësh. Njëri grup nuk do ta dinte tjetrin. Emri i saj ishte «Skënderbeu».

Naimi i dëgjonte dhe ngashërimin që i ngjitej prej krahërorit thellë, mezi e përmbante. Edhe një herë i shkoi mendja te rinia e tij. E krahasoi atë

rini me të sotmen dhe ndjeu me një mallëngjim të madh se ç'e fuqishme kishte qenë puna që kishte bërë me ato vargjet e tij. Lotët nuk i përmbajti dot, po i shkuan çurg mbi mollëzat e zbeta dhe i shëndritën mbi mjekrën e rrallë, që kishte nisur të thinjet.

Ganiu tha:

— Për kryetar të kësaj shoqërie, të duam ty, o vjershëtori ynë, i shqipes! Po këtë do të mos e dijë tjetër njeri veç nesh që jemi këtu!... Për këtë punë kemi ardhur që të të puthim dorën e florinjtë! dhe ra në gjunjë djali e i puthi me afsh dorën poetit.

Kur u ngrit ai, vanë e i puthën dorën të gjithë me radhë, i fundit Rexhati, që nxori pastaj nga gjiri «Bagëti e bujqësinë»:

— Ja, mbi këtë librin tënd jemi betuar, Naim bej! Ta kesh për kujtim nga ne! tha Reshati e iu ul atje te këmbët poetit, si një manar i urtë e i gëzuar.

— Ju qofsha falë, o bij! mundi të thotë Naimi dhe lotët i pikuan mbi libërthin e tij të gjelbër, ku bënë dy njolla.

Atë çast hyri Nevrezi me një tabaka të madhe me gjashtë kupa të avulluara. Asaj i dridheshin duart e i dridhej shtati. Kupat tringëllinin duke goditur njëra-tjetrën. Sytë e qeshur, po dhe të çqetësuar të Nevrezit, dukeshin sikur thoshin:

«Të fshehtën tuaj e mësova dhe unë! Po njeri nuk do ta marrë vesh kurrë prej gojës sime!»

* * *

Sa pinë atë çaj, nuk këmbyen asnjë fjalë. Nevrezi priti atje te dera, me tabakanë në dorë, duke

dëgjuar buzët e tyre që thithnin çajin e valë dhe kupat që tringëllinin së përpjekuri pas pjatave. Kur vështrimi saj haste vështrimin e ndonjërit nga djemtë, vashëza qeshte me një mirësi të tillë, që djali guxonte ta shohë edhe një çikë më gjatë, pa të ulë sytë mbi kupën e tij. Sigurisht, ajo nuk do të tregonte gjë, me gjithë se femër, mendonin djemtë, jo dhe kaq të pakënaqur tani që ta dijë edhe një femër të fshehtë e burrave. Burra e ndjenin veten ata djem, dhe kryetari tyre ishte Naim Frashëri vetë!

Biseda u zgjat mbi luftën që duhej bërë për të çliruar Shqipërinë. Më shumë folën djemtë, duke përsëritur secili pothua se ato gjëra, se, fundi-fundit, asnjëri prej tyre nuk dinte se ç'duhej bërë. Ajo shoqëri miturake ishte një dëshirë e zjarrtë, mendonte Naimi, dhe kjo dëshirë, që kishte pushtuar zemrën e fëmijëve, s'kishte se si të mos shpërthente shumë shpejt nga kombi i tërë dhe të bëhej luftë e të bëhej tufan, që ta përpinte pushtuesin turk të gjallë.

Poeti mori lapsin e një letër, dhe shënoi, aty mbi gju:

*Skënderbeu është gjallë,
rron e mbretëron përjetë;
kjo fjalë s'është përrallë,
ndaj t'urtit është e vërtetë!*

Me këto vargje mund ta mbyllte «Historinë e Skënderbeut», që shkruante ahëre.

Biseda kaloi te e ardhmja e Shqipërisë. Si do të ishte Shqipëria e lirë?

Djemtë u vështruan sy më sy dhe Ganiu guxoi e tha:

— Naim bej, ne kemi ardhur edhe për një tjetër gjë te zotrote.

— Urdhëro e folë, o bir, i zuri krahun dhe e shtrëngoi pas vetes poeti.

Ganiu u ngrit përsëri në këmbë e foli, solemnisht:

— Ne do ta çlirojmë Shqipërinë. Për këtë jemi betuar. Dhe kjo ditë nuk është e largët. Shpejt do të vijë. Po, kur të çlirohet Shqipëria, Naim bej, ty të duam për mbret!

Poeti shtangu.

— Si? pyeti.

— Ty të duam për mbret të Shqipërisë! përsëriti Ganiu.

Naimi zuri kokën me duar, shtrëngoi fort ballin dhe heshti ashtu gjatë. Pastaj, duke u munduar ta mbajë veten të qetë, tha:

— Po kjo punë s'bëhet, o bij! S'ka si bëhet!

Nevrezi, që kishte hyrë të dëgjojë bisedën e tyre, u drodh. Babai ishte i sëmurë. Kishte kohë kështu. Kur e shihnin doktorët, dilnin si të trembur. Vajza kish guxuar të pyesë t'ëmën, bile dhe një nga doktorët, po i kishin thënë se s'ka gjë. Mos babai kishte frikë se nuk do t'ia arrinte Shqipërisë së lirë?

Naimi vazhdoi:

— Ajo punë s'duhet bërë, o bij! Pa shihni kënde, tregoi ai me dorë nga dritarja pranë. — Shihni si gjelbëron Bosfori i egërsuar. Ai gjelbëron, po, po ta shohësh mirë, kuqëlon. Kuqëlon nga gjaku që ka rrjedhur këtu me qindra e qindra vjet. Me

atë gjak mund të ishte bërë një det sa Marmaraja vetë. Kështu, or bij! Pa shihni ato minare dhe ato xhami, që të rralla i kanë shoqet. Ato janë ngritur që t'i falen njerzit Perëndisë. Po si të të bëjë zemra të falesh në to? Ato i kanë ndërtuar sulltanët, me gjakun e kaq kombeve, edhe të kombit tonë! Dhe ky gjak akoma s'ka pushuar së rrjedhuri nëpër gjithë Turqinë e madhe e të kuqëlojë Bosforin e Stambollin. Ky qytet ka një histori gjaku dhe kjo është, or bij, histori e Turqisë së sulltanëve, dhe e tillë është histori e mbretërive, me gjithë se ka pasur ndonjë mbret të mirë, si Skënderbeu, foli thuaj se ashpër ai dhe heshti e mori frymë.

— Shqipëri me mbret! e ngriti diçka zërin Naimi — Mos e dhëntë Zoti kurrë, kurrë mbret! Në Shqipëri të mbretërojë kombi vetë, të zgjedhurit më të mirë të tij! Mbret, kurrë!

Poeti fliste e të thuash se dridhej. Sytë e tij, që kalonin nga njëri djalë te tjetri, i bënë këta të tronditen.

— Pa shihni atë pallat, atë Jëlldis mbi një ato çuka. Atje rri një nga sulltanët më të butë që ka njohur histori e Turqisë. Ky është sulltan Hamiti. Po bishë më të egër se ky mbret i Turqisë, bota s'ka tjetër sot, o bij! Merrni me mend ç'kanë qenë sulltanët e tjerë. Kurrë mbret, kurrë!

Djemtë kishin ulur kokën, si të turpëruar, dhe Naimi u mbështet mbi jastëk. Nevrezi i erdhi pranë. Poeti ngriti sytë nga e bija dhe nisi t'i qeshë kësaj.

— Dëgjove ti, moj bijë? E sheh dot ti babanë si Naim të I-rë?

Edhe vashëza, pa dashje, qeshi, dhe qeshën djemtë, sado me të ndrojtur.

— Shqipërinë duhet ta qeverisin ca të ditur, tha Naimi. — Si të them unë? Si...

Për pak, desh tha « si Samiu», po u përmbajt e vijoi:

— Shumë të ditur, shumë të urtë të jenë ata njerëz, dhe poetë... vuri ai buzën më gaz e ngriti pëllëmbën, — poetë, besa jo!... Po ta çlirojmë një herë, o djem, Kështu më paçi uratën. Kështu?

Ata pohuan me kokë dhe me sy, gjithë të çuditur.

1957.

A P E L I

Nuk isha gjetur ndonjëherë përpara një klase të zbrazët. Ndofta se isha mësues i ri.

Jepja mësimin e shqipes dhe të psikologjisë në Normalen e Elbasanit. Shkolla ishte si një koshere e vërtetë, ku zjente puna ilegale. Një shumicë nxënësish bënë pjesë në rininë komuniste dhe më shumë akoma ishin ata që aktivizoheshin në lëvizjen nacional-çlirimtare. Disa prej tyre i njihja, sepse unë vetë drejtoja punën edukative të një dy aktiveve të rinisë komuniste. Po shumë edhe s'kishin si t'i njoh. Prapë, nuk qe fort e vështirë që të kuptoj se cili ishte apo nuk ishte me ne. Në klasë, pyetjet tendencioze qenë të shpeshta. Të shpeshta qenë edhe mungesat e disa të rinjve. Përgjigjet e këtyre në mësim, shpesh nuk qenë të kënaqëshme. Qëllonte që nxënësit të vinin në klasë me fytyrë të buavitur, pasi kishin kaluar natën pa gjumë në ndonjë akcion ose në ndonjë teknikë të Partisë.

Ashtu më vinte shpesh Sula, i lodhur, i dërmuar, i papërgatitur në mësim. Që të mund t'i vë një notë, e kisha pyetur disa herë, po nuk më ishte përgjigjur. Ai në shkollë vinte sa për sy e faqe të policisë, që të mos hetohej veprimtaria e tij e gjerë ilegale. Më kujtohet se më çoi fjalë që të mos e pyes më, po munda, sepse, kur do të përgatitej?..

Po e kisha fjalën gjetiu.

Isha mësuar me mungesat dhe mospërgatitjet e shumë nxënësve, të cilët qenë edhe nga më të zgjuarit. Punoja veçanërisht edhe unë ahëre për një akcion të madh të rinisë, për mobilizimin e saj në masë në radhët partizane. Hamdiu, sekretari i Qarkorit të Rinisë, më kishte thënë një herë, me të qeshur, se shpejt do të gjendesha ndonjë ditë përpara një klase bosh. Unë e prisja si me ankth atë ditë.

Ishim aty nga fundi i prillit 1943 dhe dita erdhi. Ka qenë për 1 maj.

Nuk më kujtohet se ç'ditë e javës ishte. Po më kujtohet se në bangot e klasës ku hyra së pari atij mëngjezi, ishin vetëm nj'a tri vajza dhe një djalë. Një qetësi e çuditëshme më priti, — tri-katër fytyra të heshtura, që më vështronin kureshtare, kush me një gëzim të pafshehur, kush me një hetim dinak («Ç'mendon profesori? Ky e ka ditur që më parë.»), dhe njëri me vetullat keq të ngrysura në fytyrën e tij thua se feminare. Ky ishte një bir beu, që, në krye të Rinisë së Ballit Kombëtar, nuk do të linte krim pa kryer në Elbasan. E pamundur të zbuloj, atë maj 1943, në atë fytyrë, kriminelin e qitur të disa muajve më vonë, vrasësin e Sulës, që rrinte në një bangë pranë tij.

Heshtja nuk u thye menjëherë. Unë u ngjita në katedër dhe mbeta aty një çast në këmbë, ashtu si kishin mbetur në këmbë edhe nxënësit e mi. Kur u ula dhe hapa regjistrin e klasës, thashë një herë të mos e bëj apelin. Po e bëra. Sa herë që shqyptoja emrin e një nxënësi që s'kishte ardhur, dhe njëra nga vajzat më përgjigjej «mungon», në zërin e saj ndjeja harenë që ushëtinte së brendëshmi dhe që pushtoi sallën. Salla u mbush me partizanë. Çeta dhe batalione të reja, në çdo «mungon», na përshëndetnin prej Çermenike, Shpati dhe Dumreje. Dukej sikur, në atë sallë bosh, po bëhej një apel i madh, i cili gjëmonte breg më breg, mal më mal, — apeli i Atdheut, apeli i Partisë. Fjala «mungon», në klasën bosh, tingëllonte me kuptimin e vërtetë të asaj dite 1 maji, — dhe me ç'forcë! — «Këtu!»

Beu mendohej, kokëulur mbi bangë, dhe diçka shkarraviste. Vajzave u shëndriste nuri në gaz dhe vështrimet e tyre ngaj mësuesit nuk kishin pasur ndonjëherë më shumë dashamirësi dhe kuptim sa atij 1 maji.

Nuk më kujtohet se ç'mësim bëra dhe në se bëra vërtet mësim atë orë. Po shoh edhe tani një sallë plot dritë dhe plot buzëqeshje. Pranvera kish-te vërshuar në klasë me ngjyrat, diellin dhe shendin e vet. Cicërima zoqsh vinin nga portokajtë e lulëzuar të një kopshti fqinjë, bashkë me parfumin e luleve. Këngë partizane oshëtinin në sallën e hesh-tur që dëgjonte. Beu dëgjonte dhe ai, përmes shka-r-ravinës së tij nervoze.

*Partizanët e bashkuar
dalin për liri...*

1961.

FLUTURAKJA

E quanin Mari, po e thërrisnin Futurake. Se flutur ishte.

Ishte një vajzë e vogël, pak si e zbetë e me dy faqe të kuqe, gjithënjë e qeshur, me një të qeshur fëmije. Njëzet vjeç po bëhej, po gjashtëmbëdhjetë nuk dukej.

E bukur si pika e lotit.

Baba e nënë s'kish. Nëna e la fare të vockël, sa nisi të ngrihet më këmbë. Babaj u martua, bëri dhe dy fëmijë të tjerë, dy djem, dhe shkoi në Amerikë për fitim. Nj'a dy vjet u dëgjua, dërgoi edhe para. Pastaj i harroi e s'u përmend më hiç. Bota thoshin se rronte, po shtëpia e qau për së gjalli.

Jeta shkoi e hidhur, e hidhur fort, pelin e vrer. Fëmijët e vegjël duan rritur.

Njerka qëlloi e zonja: bëri sa munda dhe bëri shumë. Vajzën e dërgoi edhe në shkollë. E kjo mësonte e ishte përmbi shoqet.

Po erdhi një ditë e u bë e madhe. Ashtu i thënë. Se ku ishte e madhe ajo, me atë shtat fëmije, me atë fytyrë të njomë e ata dy sy përherë të çuditur?

Me që u bë e madhe, mund të merrte edhe ndonjë zanat e të ndihmonte shtëpinë. E çuan të bëhet rrobaqepëse.

Vajza e donte shkollën fort. Po jeta ia kish çelur sytë që mituri. Kur iu desh të lërë librat e të marrë gjilpërën, nuk u qa fare. As e prishi fytyrën as e prishi zemrën. Qeshi si përherë, me ata dy sy të çuditur, mori fatin e vet në të dy duart. U bë rrobaqepëse, rrobaqepëse përmbi shoqet.

Dhe mbajti shtëpinë nder e për nder Fluturakja e vogël. Të vëllezrit i dërgoi në shkollë. Të njerikën e shpëtoi nga leshi që turrte e nga qilimat që bënte për botën.

Rrobet që qepte, nuk ishin për vajza, as për nuse: ishin për flutura.

Dhe jeta filloi t'i ketë më shije.

Kur nisi lufta partizane dhe plasi pushka qytet më qytet, fushë më fushë e mal më mal, Fluturakja dy gjëra kuptoi:

Këta italianë, që tundeshin e kapardiseshin bulevardeve, me pupla e nishane, flokët të lustruara si çizmet, mustaqen si bisht miu, pispillosur si gratë, — nuk duroheshin. Kishin zënë vendin. Veç ata dëgjoje të kakarisin e të shesin trimëri. Na kishin grabitur lirinë. Duheshin ndjekur. U duhej kthyer pushka.

Pastaj, kjo botë e zezë, që i bënte vajzat e vogla të mëdha, i bënte të lënë librat e të lënë kukullat, të marrin gjilpërën e të qorrojnë sytë për të mbajtur shtëpinë me bukë, — duhej ndryshuar. Duheshin vënë shumë punë në vend.

I njihte Fluturakja ato zonja të rënda, ngarkuar me qime e xhevahirë, e që nuk dinin më çfarë bojrash të shtojnë mbi surrat e çfarë ferrash mbi flokë. Ato, që me Italinë e italianët ishin hardallosur keq dhe nuk përmbaheshin më. Ato, që s'ia linin shtëpinë t'i mbante era ujë e gëlqere, po ia mbytnin me pudrat e kolonjat e tyre. Kur u bënte fustanet provë ose ua shihte veshur bulevardëve, i dukej të ish një mëkatore e madhe që i vishte shejtanët si engjëj, për t'i fshehur ferrin gjindjes së mjerë.

Ja, këto gjëra kuptoi Fluturakja. E partizanët do t'i ndryshonin këto.

Partizanët ishin vajza e djem si ajo, shoqet e shokët e saj. Kishin lënë gjilpërën, kishin lënë çakiçin e kudhrën, kishin lënë shkollën, shtëpinë dhe kishin marrë malin. Kish qeshur e kish luajtur me të Fluturakja. U njihte zemrën, u njihte dëshirat.

Partizanët do ta ndryshonin këtë botë të zezë.

Dhe Fluturakja bëri aq sa mund të bënte një rrobaqepëse e vogël, që mban shtëpinë në majë të gjilpërës. Përndau trakte e komunikata, u foli grave, mblodhi ndihma, preu e qepi rrobe për ata të mallit, fshehu pushkë e municion, doli edhe nëpër demonstrata.

Dhe Italia u mund.

I kish thënë një nga ato zonjat e rënda se Italinë s'e mundëm ne, po ata të mëdhenjtë. Dhe ia kish lënduar keq zemrën asaj dite. Këtë gjë nuk e kish shkuar ndonjëherë nëpër mend. U hutua e nuk iu përgjigj dot aty për aty.

Si kështu? Po ç'kishim bërë ne ahëre, që kishim luftuar? Dhe solli ndër mend se kish punuar me gjithë shpirt, se shokët e shoqet e saj kishin ngrënë barut, ishin vrrarë e ishin varur. Fshatra të tëra ishin djegur. Burgje të mëdhenj si lagje ishin plot.

Jo, se dhe ne e kishim mundur Italinë! E kishim mundur edhe ajo rrobaqepëse me ato dy duar të lehta gjilpëre. Ata të mëdhenjtë bënë luftën e tyre të madhe. Ne të vegjëlit, luftën tonë të vogël. Po sa e madhe ishte kjo luftë për ne! Kish edhe të mëdhenj që luftonin më pak se ne: ç'bënte Anglia me Amerikën? Një i madh luftonte sa tundej dheu: Rusia!

Edhe ne e kishim mundur Italinë. Edhe Fluturakja e kishte mundur.

Dhe populli që kishte fituar, u ngrit të demostrojë.

Atë ditë erdhën shoqet e i thanë:

— Ngreu Fluturake! Lere gjilpërën. Shpejt, vishu. Do demostrojmë. Italia u mund, po duhet bërë gati edhe për Gjermaninë. Do bëhet demonstratë e madhe. Ja parulla: asnjë në shtëpi, — të gjithë në bulevard!

Vajza veshi fustanin më të bukur që kish dhe vajti e puthi të njerikën.

— Do të demostroj me shoqet, mama.

E njerka u frikësua:

— Mos dil, moj bijë! iu lut. — Mos vritesh!

Vajza iu përgjigj:

— Si flet ashtu ti, mama? Të gjitha njësoj jemi. Po qe fati im, asgjë. Ne për këtë ditë luftuam. Do demonstrojmë të gjitha!

E puthi në të dy faqet dhe fluturoi.

Po te rruga vrau mendjen:

«Sikur të vritem!... Po sikur të vritem vërtet?... Do më shohi doktori. Do më gjejë për turp. pa ndërruar... Dale një herë.»

E shpejt u kthye. Veshi ato të lintat më të mira që kish.

Fytyra i shëndriti si pranverës që le dimrin pas. Do të kishte dashur të vishet me rrobe nusërie. Dhe ndjeu në zemër atë gëzim që ndjejnë vajzat kur janë të kënaqura me trupin e tyre.

Lufta e saj ishte e bukur si faqja e saj e kuqe. Fluturoi.

Të njerkës i ndolli zemra keq:

«Ç'bëra, unë e zeza!» u drithërua. «Ç'i thashë ato fjalë bijës? Si s'm'u tha goja!... Po sikur të vritet!...»

— Mari! briti dhe u nis me vrap pas vajzës.

Po kur arriti ajo te bulevardi e u mundua të çajë atë det njerzish, tankset çelën zjarrin.

Njerzit u korrën si kallinjtë e pjekur dhe ranë. Ra dhe Fluturakja atje në ballë.

Gjindja nisi të tërhiqet. Po gruaja çante përpara, kërkonte vajzën.

Si ikën të gjithë, ajo mbeti aty, vetëm, në mes të të vrarëve, në pellg të gjakut. E kërkoi dhe e gjeti atje në ballë, ku po jepte shpirt. E mori në krah, si e pat marrë fëmijë, e shtrëngoi dhe e tundi për

gjumin e vdekjes atë vajzë të burrit që e donte si bijën e vet. Qau, qau pa britma, aty në mes të ofsheve të plagëve, duke shikuar vajzat e tjera, djemtë e tjerë të vrrarë përreth.

Tankset vinin vërdallë, ulërinin e shtinin gjithëmonë. Bombat pëlcisnin e shqyenin trupat sërish. Gruaja ngriti vajzën në krah dhe u nis me të nëpër gjëmë, drejt tankseve, duke thirrur:

— Katila! Katila!

Plasi dhe një bombë. U përmbys dhe ajo në pellg të jakut.

Në mbrëmje, gjindja që erdhi të mbledhë trupat, i gjeti të dyja atje në ballë fare: njerka e plagosur shtrëngonte gjithëmonë vajzën e ftohur në krah, si të desh ta mbrojë nga furtuna e mizorit. Vështrimi i saj i mërishëm ish drejtuar andej nga qenë tërhequr tankset. Buzët e saj mërmërisnin ashpër:

— Katila!

Aty pranë, ushtarët e armikut mundoheshin të shuajnë një tanks në flakë dhe dy gra çuan një trim të vrrarë që i kishte kallur zjarrin asaj maqine.

1945.

KY ÇUNI I MADH I SALË CENIT

Sapo leu dielli.

Rakip Hasa, mësues i Vidhasit, doli prej shkollë. Pelën e kishte lidhur te dera. I këceu dhe e fshiku.

— Udha e mbarë, zoti mësues!

— Udha e mbarë, zoti Rakip!

— Udha e mbarë!

Ishin nxënësit e tij, që kishin dalë herët për t'i thënë lamtumirën mësuesit, kësaj dite të parë pushimesh të mëdha.

Kish një mot Rakip Hasa në Vidhas. Vidhasi është një katund i vogël: as dyzet shtëpi. Po me që ka edhe nj'a dy katunde të tjera të vogla pranë dhe është si mes vendi, këtë mot të parë pas luftime aty u çel një shkollë.

Shkollë s'kishin pasur tjetër herë këto katunde. E vidhanakët me fqinjët e tyre e kishin plasje

që nuk e hapën dot më parë. Po kush të linte? Kush mendonte dikur t'i hapë shkolla gjindjes?

Veç ja, lufta erdhi e punët ndryshuan. Pa pritur që të mbarojë lufta mirë, vidhanakët ia vunë themelet shkollës. E që ahëre, partizanët u dërguan edhe një mësues, i cili i mblidhte fëmijët te xhamia dhe aty e bënte mësimin. Vend më të gjerë s'kish. Si sot një mot, shkolla e re ishte në këmbë dhe mësimet nisën me një mësues tjetër, me Rakip Hasën, nga Mollagjeshi i Zaranikës.

Rakip Hasa nuk qe dhe fort i ri. Shkollë kish-te pak: një mot në normalen e parë, kur u çel në Elbasan, në kohë të Turqisë. Po për mësues e lëvdonin. Ish i përpjekur Rakipi dhe fëmijët i mësonte për bukuri. Ishte dhe burrë i ndershëm e i dashur. Si mësues i vjetër që ishte, i thonin efendi, — efendiu i Mollagjeshit.

Rakip Hasa e bëri punën për faqe të bardhë sivjet. Katundit i hyri në zemër fort efendiu, që të kënaqte me ato fjalë me qokë e që fëmijët e donin me shpirt.

— Udhë e mbarë, efendi!

-- Udhë e mbarë, zoti Rakip!

— Mos na harro!

Nuk ishin më vetëm nxënësit që kishin dalë t'i thonë lamtumirën, po edhe disa burra të katundit.

Atë mbrëmje vidhanakët i kishin shtruar një darkë mësuesit. Kishin kënduar e kishin vallëzuar deri vonë fare. Ishin rrokur në qafët e ishin ndarë të mallëngjyer. Mësuesi kishte shkuar, si përherë, në shkollë të vet, ku i kishin rregulluar një odë të mirë.

E ja se, në mëngjes, kishte që deshën të çmallen edhe një herë me të.

— Shiko se të heq kush prej Vidhasi, se ne do bëjmë të madhen! i kishin thënë. — As Mollagjeshi nuk lëmë të të marri.

* * *

Rakip Hasa kishte hyrë në zall të Zaranikës. Dielli ishte lart. Vapa kishte filluar.

Mendonte gruan që kish lënë si pa qejf një muaj përpara, kur kaloi një dy dit me leje në Mollagjesh.

Po-i afrohej mullirit të Ndreut, kur dëgjon ta thërresin. Iu duk si zë fëmije.

— Prit, efendi! Prit, efendi!

Kishte qenë një fëmijë vërtet. Po vinte pikë më pikë, me një pallto të vogël pas krahut.

— Meraba, efendi, ia bëri çuni duke marrë frymë shpejt e thellë.

— Mirëdita, o çun. Për ku kështu?

— Për Mollagjesh.

— Do qenkam me shok, tha Rakipi e vuri buzën në gaz. — I kujt je ti?

— Jam çuni i madh i Salë Cenit.

Ky çuni i madh i Salë Cenit nuk ishte më shumë se dhjetë-njëmbëdhjetë vjeç. Me shtat, më shumë nuk dëftente. Kishte një këmishë ku arna zinte arnën pesëdhjetë herë. Shallvaret i qenë bërë copë e çikë: i dilnin pulpat e kërcinjët. Opinga s'kishte në këmbë; as kësulë mbi krye.

— Ku ishe kështu? e pyeti Rakipi.

— Qysh? S'e di ti, efendi? ia bëri çuni i çuditur.

— Besa jo, tha mësuesi, që e vuri re se nuk i erdh mirë çunit. — Ne i kemi shtëpitë qosh e më qosh të katundit, tha. — A më zë besë? Kam më se një mot që s'e kam parë një herë tët atë. Ja...

— Ashtu është vërtet, ia preu çuni. — Edhe unë kush e di sa kam që s'të kam parë ty. Po unë të njoha ama.

— Fëmijët rriten e ndryshojnë e s'njihen më, tha Rakipi. — Nga po vjen kështu?

— Kam ca kohë që jam pajtuar hyzmeqar në Karakullak. Ruaj lopët. Gjashtë muaj, për nga tri napolona muajin. Deri në Shëmitër. Kur bie Shëmitri, efendi?

— Qenke lodhur shpejt, ia bëri Rakipi. — Do dhe nj'a katër muaj.

Me këto fjalë arritën te Burimi i Rrilës.

Rakipi i zbriti pelës dhe u ul e lau faqet. U shtruan për një copë herë në hije të rrapit. Çuni i vogël nxori kutinë dhe filloi ta dredhë.

— Na, merr e dridhe këtu, efendi, dhe i zgjati kutinë. — Duhan Karakullaku. Bashi i duhanit. Flori. Po me letra sapuni veç!

— Kam letra të mira vetë, tha mësuesi.

Çuni e pinte duhanin që mos e pyet. E thithte me gjithë mushkëri dhe e nxirte nga hundët, duke pështyrë pa pushim.

Rakipi dridhte cigaren dhe e shikonte djalin me një sy si të mvrejtur e qërtues.

I vogli e kuptoi, uli kryet, e la duhanin pa thithur dhe luajti pak me të nëpër gishta; mendueshëm ia bëri:

— Thonë se të prish duhani, efendi.

— Fëmijëve u bën shumë keq, o çun.

— E unë që kam vënë dhe kuti, efendi!

— S'ke bërë mirë. Hiç mirë s'ke bërë.

Çuni e la cigaren, duke vështruar larg, në brigjet matanë Zaranikës, ku misrat ishin tharë. Kishte misra të dobëta atyre anëve.

Iu kujtua Karakullaku.

«Hajde tokë!» tha me vete.

— E di se ç'tokë ka ai Karakullaku, efendi? ia bëri. — Sa një hasër shtrihet gjethja e duhanit, vallahi! Apo misri. — Mos pyet për misrin. Drapëri s'e pret; duhet sëpata, besa... Bula e shiut s'ka rënë sivjet. Po ç'e do shiun ai vend? Është kjo tokë e trashë e e butë, si tul simiteje. I hypën shtati misrit sa dy bojë njeriu, që mashalla!

Dhe çuni fliste e nuk mbaronte së lëvduari atë tokë. Fërkonte kraharorin e nxirë e të thatë. Atje thellë, sytë e zez filluan t'i shkëlqejnë.

Rakipi ia bënte herë pas here:

— Ashtu! Ashtu! dhe kishte qejf të madh ta dëgjojë atë fëmijë që ishte bërë ashik për tokë.

— E di, efendi? Unë nj'a tri katër herë i kisha dëgjuar partizanët kur flisnin për Mollagjesh, te xhamia. Kisha qejf t'i dëgjoj. Po vinë dhe ca çuna andej nga Karakullaku, që të flasin e ta fusin në trutë. Katundi hap veshët, dëgjon e bindet. Pleqtë edhe më fort se të rinjtë. A di ti se ç'na thanë kësaj jave? Do t'i ndahet toka bujkut! Do bëhet... Ç'i thonë asaj?... Ti e di, efendi. Ç'i thonë?

— Reforma agrare.

— Ajo! Formagraja! E beson ti?

— S'gënjejnë ata, tha mësuesi. — Kur e thonë, e bëjnë. Do ia ndajnë tokën bujkut sivjet. Për këtë luftuan partizanët.

— A thua ti se do marri tokë kush s'ka? Diç atë Perëndi!

— Do marri.

— E dija unë! ia pat çuni dhe rrahu fort kofshën e vet me pëllëmbë. — Kur e thanë ata çunat e shehrit një ditë te Rrapat e Pashës, unë e besova me të parën. E kisha dëgjuar se do bëhej një gjë, po pa e thënë ata s'e besoja. Tani që po e thua dhe ti, do bëhet.

— Do shpëtojë fshatarësia, tha Rakipi. — Kam dëgjuar se andej fushës thellë është bërë gëzim i madh për këtë ditë...

— Kanë hak, ia preu çuni. — Të punosh tokën e botës e të mos gëzosh gjë vetë! Është e udhës kjo?

— Jo, s'është e udhës.

— Do ta dredhësh dhe një herë, efendi? Unë s'po pi më, se më jep kollë, tha çuni e vështroi Rakipin duke u skuqur.

— Faleminderit, or çun; mirë e ke, mos e dridh më. Lëre fare, po më dëgjove mua.

Rakipi e drodhi dhe një herë. Pinë dhe nga një ujë, i hypi mësuesi pelës e morën prapë udhën nëpër vapën që po shtohet.

— E di se ku ta kisha fjalën? ia filloi çuni, mendueshëm. — Ia kam vënë syun një toke, efendi, atje në Karakullak...

— Ti u lodhe, ia ktheu Rakipi. — A s'i hypën pelës në vithe një herë?

— Jo, se lodhet pela, efendi. Është gjynah. Rakipi e ndali.

— Hypi, hypi.

Çuni i hypi në vithe pelës, që bëri pak naze, po iu desh të çapat.

I qenë afruar së përpjetës së Beraneshëve.

— E ç'tokë, efendi! S'rrefehet me gojë. Nj'a pesë pendë dhë të mira, tul i gjallë, me një çair në mes. Mot i mirë, mot i keq, pa njëzet barrë nuk del... Gjerdhet janë shkruar me fiq e me rrush, me arra. Përfundi, një radhë plepash... Tre gurë-mulliri ujë sjell rema... Ka dhe ca kasolle të mira më një qoshe të çairit, me ç'ka bërë Zoti: shegë, ftonj, mushmulla, ullinj. Ja aty, rrëzë-ullishtës! Xhenet, efendi!

— E kujt është ajo tokë? pyeti ky.

— Sikur të ma japin! ia bëri me zë të ulët çuni. — Sikur të ma japin!

— Pse mos të ta japin? i briti Rakipi.

— A thua se ma japin, efendi? pyeti çuni me një fije zëri. — Atë farë toke!

— Ta japin. Ta kërkosh.

— Ta kërkoj?

— Pse mos e kërkosh?

— Ku ta kërkoj?

— Në këshill, në qeveri. Qeveria është e jona.

— Po ku di unë i mjeri, efendi? Ku di unë!... A vjen dhe ti me mua? Aman, po marrim lalën timë e po shkojmë. Të tre bashkë, efendi! Të tre!

— Bashkë vemi, i briti Rakipi e ktheu kryet dhe i qeshi çunit.

Ky iu hodh në qafë e desh ranë nga pela.

— Ngadalë se ramë, or i bekuar!

Ia plasën gazit të dy.

— Qysh? Do ma japin? pyeste çuni.

— Pse mos të ta japin? Kujt do t'i japin po s'i dhanë Salë Cenit?

— Vallahi, më duket si ëndërr! ia bënte çuni dhe shtrëngohej pas efendiut, duke menduar te ajo farë toke atje në Karakullak.

Tre gurë mulliri ujë sillte rema!

— E kujt është ajo tokë? e pyeti dhe një herë Rakipi.

— E Demir Agait nga shehri.

— E atij qeni qenka! ia pat Rakipi.

Ky Demir Agai na e paska rjepur një moti t'anë e mësuesit: i kishte dhënë me faiz dhjetë nopolona; për dhjetë, një qind i kishte marrë.

— Edhe ullishta e tij është, tha çuni.

— Edhe ullishta do ndahet, Do t'i vijë dita dhe asaj.

— Unë ullishtë s'dua, tha çuni. — Vetëm atë copë tokë. E kam bërë hesap: nuk i bie njeriu më qafë. Ka boll edhe për bujqit që janë sot aty. Se duan edhe ata copën e tyre. Pas atyre vi unë.

Kur arritëm majë së përpjetës, te shtëpitë e para, Rakip Hasa me të birin e Salë Cenit e kishin bërë mend mirë se si do të vepronin: do të shkonin me gjithë Salën në këshill, në Elbasan, e do të kërkonin tokën. Rakipi kishte nj'a dy të njohur atje në këshill, që kur ishin partizanë dhe i kishte mbajtur në shtëpi. Çuni i Salë Cenit do ta merrte tokën e Demir Agait, pa tjetër.

Kush ishte si ata dy kalorës majë asaj pele! Çuni kishte filluar këngën:

*Lamtumirë të them, moj nane,
do shkoj partizane!
Of aman, moj nanë aman!*

Rakipi i shkonte pas, me zë të pakë.

Shtëpitë e para të Funarsit u dukën. Çuni këceu nga pela.

— Këtu duhet të ndahemi, efendi. Bëfsh udhë të mbarë.

— Të mbarë e bëfsh, o bir. Fal me shëndet Salës. Zoti të dhëntë shëndet, se mend të ka dhënë sa për një të madh. Mot me tokë.

— Ejvallah, efendi, ejvallah!

E u ndanë.

Çuni mori të përpjetën majtas dhe ia krisi prapë këngës që kishte lënë në mes. Rakipi ndoqi rrugën e madhe me zemrën sa një karpus.

Pas pak, se ç'iu kujtua dhe e ndali pelën.

— O çun! briti.

— Ç'ka, efendi?

— Si të quajnë, more, se s'ta pyeta emrin?

— Qerim, Qerim më quajnë.

— Po një fjalë s'ma the, more Qerim. Ç'do bësh ti, more, si të marrësh tokën?

Çuni qeshi.

— Tani më zure ngushtë, efendi! ia bëri nëpër gaz. — Do ta lë duhanin, do ta lë! Do vete dhe në shkollë, efendi. Atje tek ti, në Vidhas. Jemi fqinj. Më qas?

— Sa di unë, të gjitha do t'i mësosh, or bir. Paç shëndet. Hajt, udha e mbarë, tha Rakipi e sikur iu njomën sytë.

— Udha e mbarë, efendi. Mos harro fjalën!

Kur tregonte atë drekë në shtëpi Rakip Hasa se si e bëri rrugën me çunin e Salë Cenit, një i ungji ia pat:

— Ai djalë është për t'u çuditur vërtet, aq i zgjuar është. Si burrë i pjekur. Po ç'e do se ka një shejtan baba! A di ti, sa e mori vesh se qeveria do ta shkuli miletin shkrepash, që ta çojë e ta bëjë zot të fushës, ai, me ato palë mend, erdhi në këshill e na tha se nuk luan nga vendi edhe sikur ta vrasin?

— Qeveria nuk luan njeri nga vendi me pahir, tha Rakipi. — Po Salë Cenit ia mbush mendjen çuni.

1945.

RRUGA E RINISË

Rruga Kukës-Peshkopi, Rruga e Rinisë, është një rrugë e bukur, që shpesh gjarpëron pas Drinit. Tregojnë se lumi ka fuqi t'i japë dritë jo vetëm Shqipërisë, po dhe një pjese të mirë të vendeve fqinj. Ajo kohë ka për të ardhur. Sot për sot, Drini rrjedh i rrëmbyer, atje pranë kufirit. Ujrat e tij, që përshkojnë male të thepisura dhe lugina të ngushta, në zhurmën e tyre, ruajnë krismën e kaq luftave që janë bërë në atë kufi, kujtimin e potershëm të kohëve që nuk harrohen, se janë krenari e popullit tonë dhe se i mbajnë zgjuar brezat për çdo rrezik të ri që mund të vijë përmatanë atij kufiri.

Brahim Lika, i lumjan, është një nga ata burra që e mban lumi zgjuar me zhurmën e vet. Heraherën, atij i qëllon të qëndrojë atje përfund fshatit, te një breg, përmbi Drin, dhe të dëgjojë ujrat e

egërsuara ose të vështrojë malet larg nga kufiri. Zemra i pëlçet kur mendon se ka dhe andej shqip-tarë me qindra mijë, që nuk panë një ditë të bardhë këto pesë qind vet. Po kohët ndryshojnë.

Kohët ndryshojnë ngandonjëherë kaq shpejt, sa njeriu mbetet shtang. Kohët ndryshojnë. Ja Brahim Lika, që tanimë nuk habitet, nuk ka menduar gjithëmonë si ç'mendon sot. Sot, mbi këtë breg, përmbi Drin, ai kujtohet se nuk pat menduar gjithëmonë kështu.

Ja, i kujtohet kur çelte rinia udhën e saj atje poshtë, dhe ai, me të birin, shihnin së këndejmi. Djali ruante dhitë ne shkoza. Brahimi korrte arën e tij nën shkozë. Dinamiti ngrinte përpjetë dumanin dhe bënte të buçasin grykat. Ushëtimat përsëriteshin me gjëmë, gjersa humbisnin maleve përtej. Skënderi vinte dhe i lutej:

— Aman, babë!

Brahimi vihej prapë e korrte. Heshtja e tij donte të thotë jo. Djali kthehej zemërvrarë te dhitë.

E ëma e ndiqte me bishtin e syrit e i dhimbej, po të shoqit i thosh të mos i japë leje. Ajo e shih-te se burri nuk ish dhe kaq i vendosur që të mos e lëshojë djalin për të punuar te rruga.

Adilia e vogël e ngushëllonte të vëllanë, duke i thënë se duhej të priste edhe ca, gjersa të rri-tej mirë. A nuk i thosh i ati Skënderit «je i vogël»?

Me vite po, i vogël ish. Me trup, ai kishte marrë përpjetë, si një vgje i ri bjeshke, që ngri-het i bukur pranë vgjenjve të moçëm, gadi ta çojë kryet aq lart sa ata, në mos dhe më lart. Bra-himit djali po i ngjante si një vëlla i vogël. Ai

kishte nisur të veshë çakçirët dhe kuparanet e t'et. E ëma e ndjente veten krenare se po i bëhej djalë burrë. Që tani, ajo mendonte për nusen, ajo që, po të mos e dije se po bëhej me një djalë katërmbëdhjetë vjeç, mund të thoshe se qe nuse vetë.

Po Skënderi ishte djalë i vetëm, «djalë dëshiri», si thonë në disa anë të Veriut. Dhe Brahimi me të shoqen e ruanin si sytë e ballit.

Atje mbi xhade, punonin dhe plot çunakë. Kur i qëllonte Brahimit të shkojë dhe t'u shesë ndonjë shportë me kumbulla ose me qershi, — disaherë edhe s'ua shiste, po ua falte, — ai shihte në mes tyre djem të një vërse me të birin. Dhe jo veç djem, po edhe vajza. Kish disa lebër, të cilëve zor t'u jepje moshë, sepse kishin qëlluar prej vetiu të shkurtër. E pra, sa të vegjël dukeshin, për punë ata ishin të parët në gjithë atë xhade. Si djemtë, si vajzat...

Kjo puna e vajzave nuk i pëlqente fare Brahimit.

— Zjarri te baroti nuk afrohet, i thosh ai të shoqes dhe kjo ish e një mendje me burrin.

Kohët që kishin ndryshuar kaq shumë, nga kjo anë kështu s'kishin ndryshuar për mirë, mendonin ata të dy... Po e kishim fjalën te djemtë.

Çamarrokët e Labërisë punonin atje në xhade aq mirë, sa t'ua kishin zili dhe burrat. Skënderi nuk do ta turpëronte Brahimin në mes shokëve, edhe pse punë krahu s'kishin bërë gjer ahëre, po kishte vajtur në shkollë e me dhi. Veç Skënderi ishte djalë dëshiri. Pastaj, kush do t'i ruante dhitë? Adilia ishte akoma e vogël. Asaj i mjaftonin kecat.

Burri e merrte me mend se rinia tani nuk ishte duke ndërtuar një xhade të zakonëshme, po diçka të madhe fort. Një udhë e tillë hekuri ish e para në Shqipëri. Adilia s'kishte ditë që të mos e përfytyrojë në një mënyrë të re atë udhë prej hekuri dhe t'ua tregojë prindërve, të cilët kishin qejf t'i bëjnë të tyret përfytyrimet e vogëlushes.

Kaluan tre muaj dhe shumica e shokëve të Skënderit u kthyen në fshat e në krahinë. Ai vetë s'u kthye. Dërgoi letër e tha se ishte zotuar të qëndrojë edhe tre muaj të tjerë vullnetar. Shokët treguan se djali po mësonte edhe në një kurs, për punë të hekurudhës.

Brahimi u vreros. E shoqja qau. Qau dhe Adilia e vogël, që e kishte pritur me aq mall e kureshtë të vëllanë.

Burri mbaroi së korruri arën përmbi Drin dhe u nis të shohë të birin. Ai arriti në Durrës ato ditë kur lokomotiva dhe vagonat e parë zbritën në port. Ai dëgjoi fishkëllimën e lokomotivës së parë dhe pa trenin e parë që u nis nga Durrësi për Kavajë.

Një alamet maqine si ajo, Brahim Lika as që do ta kishte marrë me mend kurrë. Përbindëshat e përrallave nuk shëmbëllenin me të. Atij iu dukën asgjë kamionat dhe maqinat e tjera që vërtiteshin pranë lokomotivës. Dhe kur pa Brahim se kjo maqinë, që nxinte nga qymyri dhe që tymoste për-pjetë si njëzet oxhakë bashkë, tërhiqte një bisht të pambaruar shtëpijash, ai tha me vete se, pa dyshim, ky tren, — si i thoshin, — jo vetëm fshatin e tij që e merrte brënda, po mbase Lumën të gjithë.

Këtë radhë, rinia po ndërtonte një gjë shumë të madhe, vërtet. Këtë radhë, Brahim Lika e ndjeu edhe më mirë forcën e qeverisë e të Partisë dhe iu kujtuan partizanët. Për ta, ai dhe fshatarë të tjerë kishin thënë se ishin njerëz që mund të sheshonin edhe malet. Këta vërtet kishin për të sheshuar malet ndonjë ditë.

Brahim Lika shkoi te Shkëmbi i Kavajës, të çmallet me të birin. Shkoi me tren, përmbi një vagon të ngarkuar me binarë. E morën disa djem, që e njihnin Skënderin. I kishte nxirë dhe bërë dielli si arapë, po i kishte zgalitur era e detit dhe puna i kishte bërë të zhurmëshëm e fort të qeshur. Ata pyetën për Lumën, për fshatarët që kishin njohur verës tjetër, kur kishin punuar mbi xhade, u interesuan për gjënë e gjallë e të mbjellat, për shkollat, për organizatën e rinisë. Brahimi ndjeu zili në vetvete se ishte i një brezi tjetër, edhe pse numurohej akoma i ri: të tridhjetë e pesat s'i kishte mbushur.

Treni shkonte ngadalë. Udha s'kishte zënë vend mirë akoma, thoshin djemtë. Rrotat i rrihnin binarët si çekanë të mëdhenj, bam-e-bum, bam-e-bum. Maqina, atje në kryet, fishkëllente fort, sikur të desh ta dëgjojë bota e gjithë se po kalon treni i parë i Shqipërisë. Nga të dy anët e udhës, të rinjtë, që punonin akoma për të sheshuar ose për të pastruar ndonjë kënd, linin lopatat e karrocave dhe rendnin pas trenit me britma të gëzuara. Njerzit ngrinin shpinën nëpër ara dhe bostane e habiteshin. Përmbi detin e kaltër dhe aq të shkëlqyeshëm, sa të dhembnin sytë ta shihje gjatë, zgalemët flutu-

ronin larg, të frikësuar nga fishkëllima e egër e atij gjarpëri prej hekuri që kishte ardhur të pu-shtojë ranishtet.

Brahimi s'e gjet djalin te Shkëmbi i Kavajës. Skënderi kishte shkuar me punë në Tiranë atij mëngjezi e nuk do të kthehej për dy-tri dit. I treguan se i biri ishte bërë me famë në gjithë heku-rudhën, se gjer tani kish dalë katër herë sulmues dhe se e kishin bërë komandant kompanie. Në më-simet ishte i dalluar.

Brahimi hëngri drekën me të rinjtë. Ushqimi i pëlqeu. Pa edhe barakat ku flinin dhe s'iu du-kën keq. U qau hallin për vapën e madhe e për atë ujë të valë që kishin. Po, kur nuk dëgjoi njeri të qahet nga vapa e nga ujët dhe kur pa detin atë pasdreke të mbushet me qindra të rinj gazmorë, i përmalluar se nuk u takua dot me djalin, i hypi trenit në të kthyer e mori udhën e fshatit.

Në shtëpi, Brahimi tregoi çudirat që kishte parë. Adilia e vogël, këtë radhë sikur e pa me sy-të e vet trenin, kur i ati rrjeshtoi gruçat e misrit bisht më bisht në një varg të gjatë, dhe vuri një sopllake të madhe e të nxirë në krye të vargut.

— Zëre se kjo sopllake është një maqinë sa kjo shtëpi dhe që lëshon tym sa për njëzet oxhakë. E zëre se këta gruça janë të mëdhenj secili sa tri herë kjo shtëpi, me dyer e me dritare të mëdha. E zëre se gjithë këto ecin me rrota hekuri, që shkasin mbi dy biga të drejta hekuri, bam-e-bum e zhak-e-zhuk. Të futësh gjithë Lumën brenda, vallahi!...

Brahim Lika thua se gjithë asaj jave mbet së treguari punët e trenit nëpër fshat dhe në shtë-

pi. Kot e kishin bërë ata djem, që nuk ndejtën në hekurudhë më shumë se tre muaj. Ata s'kishin parë gjë me sy pa ardhur treni. Sot ishte ç'ishte në Durrës. Tani ishte për të punuar atje. Të rronte kjo rini që po bënte çudira!

Kështu me Brahimin. Ai agjitoi për hekurudhën ahëre më mirë, sa dhe organizata e rinisë vetë. Vullnetarë të tjerë u nisën të entusiasur.

Muajt shkuan. Skënderi u kthye vetëm për një pushim të shkurtër në shtëpi. Ai kishte dhënë fjalën se do të mbetej me punë në hekurudhë. Rroga i dilte të ndihmonte edhe shtëpinë. Brahimin më kot nguli këmbë që djali të qëndrojë në fshat. Ky tani dukej si burrë i pjekur. I tregonte t'et ato pesë dynym tokë pa ujë që kishin përmbi Drin, e ato njëzet kokë dhen, e i thoësh se nuk duheshin dy burra për të punuar një hasër vend e për t'iu kujdesur një grushti bagëtie. Brahimin iu mbyll goja. Nëna qau. Adilia qau edhe më shumë. Skënderi iku.

Sot Skënderi po kryen shërbimin ushtarak në Korçë. Brahimin është e dyta herë që ka shkuar krah punë. Vjet që në Rogozhinë, ku u ndërtua një fabrikë për çveshjen e pambukut. Sivjet punoi tre muaj në kanal in e Vilashukut, që kësaj vere do të njomë mijra hektarë tokë të asaj Myzeqeje të zhuritur për ujë, dhe ku do të bëhen pambuku e misri që të mos kenë të çmuar.

Ka qëndruar Brahimin te ai bregu i vet përmbi Drin, përfund arës së korrur. Vështron grurin stivë dhe mendon se e shoqja është përpjekur shu-

më kësaj vere. Punën e ka bërë për bukuri. Vajza e ka ndihmuar.

Adilia tani është rritur. Burrë e grua kanë menduar edhe se ku do ta japin, po s'ia kanë thënë akoma, se është ca vështirë me këto çupat e sotme të vendosësh për gjëra të tilla. Brahim Lika e di mirë këtë. Ai i druhet vajzës, me gjithë se e ka të urtë. I urtë ish edhe Skënderi, të cilin s'e përmbajti ashtu si desh vetë.

Kur ishte nisur për Vllashuk Brahim, rinia po zjente më shumë se ngaherë në fshat. Kërkoreshin vullnetarë për hidrocentralin e Matit. (I kishte ardhur dita Matit! Edhe Drinit do t'i vinte, mendonte Brahim. Kohët ndryshojnë shpejt). Tani ishte puna, sidomos, edhe për vullnetare. Duhej të dilnin vajzat, që, këtyre anëve, gjer më sot kishin dalë tepër pak.

Brahimi, për punë të vajzave, kishte mbetur thua se ku qe. Zjarri të baroti nuk duhet afruar, thosh ai. Po në Vllashuk, vajzat nuk mungonin. Kur i kujtohej atje e bija, që i pat hedhur fjalën një dy herë se do të ishte mirë të shkojë edhe ajo me shoqet (edhe Skënderi kështu i shkruante prej ushtrie). Brahim sikur pendohej se nuk e mori vajzën me vete në Myzeqe, të punonin së bashku dhe ajo ta hiqte edhe këtë merak. Mot, shihte e bënte.

Udhës nga kishte ardhur Brahim, që nga Burreli e gjer në fshat të tij, kish parë kamiona me të rinj dhe të reja prej gjithë kráhinave buzë Drinit, që shkonin për hidrocentral. Thua se kishin lënë shtëpinë gjithë çikat e maleve. Burrit nuk i

erdhi mirë. Nuk i erdhi mirë, jo se kohët kishin ndryshuar kështu, po u druajt se mos dhe e bija iku me shoqet e ai e mbajti kot. Kur po shkënin qindra të tjera, pse të mos shkonte dhe ajo?...

Kështu mendon Brahimi sot, me gjithë se me një halë në zemër.

Burri e ndjeu veten diçka më të kapitur nga ato mendime, po u ngrit e mori të përpjetën. Nga larg, diktoi te shkallë e kullës së tij xhokën e bardhë të gruas që zbriste. E shoqja e pa kur vuri këmbën te kapërcelli i kopshtit nën shtëpi dhe rendi e i mori një torbë të madhe me tesha që ai mbante në sup.

Sikur kishte një gëzim të çqetësuar e shoqja. Brahimi e çoi mendjen menjëherë te e bija.

— Adilien me dhi e ke dërguar? pyeti.

Gruaja e vështroi të shoqin me dy sy ku nisën të shkëlqejnë dy lot. Uli kokën e nuk folli.

— Demek, shkoi dhe Adilia? tha burri dhe e ndjeu veten më të lehtë se brendëshmi.

— M'u dhimbs e e lashë, o Brahim, ia bëri e shoqja. — Fëmija nuk mbahen më sot. Po desh Zoti e na dha fëmijë të mirë dhe nuk ua kam frikën. Po kam mall, tha ajo e, me cepin e shamisë së bardhë të kreit, fshiu sytë e faqet e njomura.

Brahimi u ul në fund të shkallëve prej guri të shtëpisë. Ai vështroi larg malet nga kufiri. Tutje, nga e majta, vështroi udhën pas Drinit, që ish fort i kaltër asaj dite vere, edhe pse i thonë «i zi» dhe është i rrëmbyer. Brahimi ndezi një cigare dhe deshi të bëjë hoka me të shoqen:

— Je e re, moj grua, i tha. — A nuk na bën dhe një të tretë, që t'i thom ik me gjithë shpirt e të mos e pengoj më si këta dy të parët?

Gruaja u bë flakë e kuqe dhe u ngrit e ndoqi me gur një kec që po përpiqej të hedhë gardhin e kopshtit. Ajo kish tre muaj që e kishte ndjerë veten të ngarkuar. Tani, mund t'ia tregonte të shoqit, po i erdhi zor.

Brahimi ia nisi një kënge që kish mësuar në Vlashuk. Kënga fliste për paqen, rininë dhe për ditët e reja.

1953

TRYEZA E LËNDES

FYELLI I MARSIASIT

	Faqe
Tregim i parë — Dallëndyshet	5
» i dytë — Gurnecka	16
» i tretë — Buzë Shkumbinit	23
» i katërtë — Një varr në Tushemish	28
» i pestë — Rogeçët	36
» i gjashtë — Një takim me Avniun	45
» i shtatë — Dy zorrëtharë	49
» i tetë — Cikat e Cenit	56
» i nëntë — Raku	61
» i dhjetë — Gargujt	69
» i njëmbëdhjetë — Një ngjarje e lahtarëshme	74
» i dymbëdhjetë — I duruari	80
» i trembëdhjetë — Dështim	87
» i katërbëdhjetë — Lulet dhe patllixhanat ..	91
» i pesëmbëdhjetë — Kreci i Kokoneshit	99
» i gjashtëmbëdhjetë — Te mulliri nën baçe	105

Tregim i shtatëmbëdhjetë — Otellua dhe Robert Gnis- kardi	111
» i tetëmbëdhjetë — Përmallime	117
» i nëntëmbëdhjetë — Napa e bardhë	126
» i njëzetë — Mandolina e braktisur	131
» i njëzetënjëtë — Fyelli i Marsiasit	137
» i njëzetedytë — Në vend të epilogut	143

TREGIME TË TJERA

Mëshikat	151
Lëmshasi	161
Prendja	171
Xhelati	179
Malli i shqipes	184
Një ditë tek Naimi	192
Apeli	218
Fluturakja	221
Ky çuni i madh i Salë Cenit	227
Rruga e rinisë	237

JANË NË QARKULLIM
LETËRSI ARTISTIKE SHQIPTARE

- G. DARA (I riu) — *Kënga e sprasme e Balës*
- MIGJENT — *Veprat*
- Z. SEREMBE — *Vjersha*
- Q. STAFA — *Qortimet e vjeshtës*
- DH. S. SHUTERIQI — *Këngë*
- LL. SILIQI — *Këngë entuziaste*
- Q. BUXHELI — *Një ndodhi në plazh*
- R. BRAHIMI — *Katër vajza*
- A. ASLLANI — *Shqipëria kryezonjë*
- H. PETRELA — *Të munduarit*
- Autorë të ndryshëm — *Këngë për dritën leniniste*
- XH. BILBILI — *Skena dhe prapaskena*
- Autorë të ndryshëm — *Këngët e rinisë*
- R. NEPRAVISHTA — *Pelikanët ndrojnë fole*
- K. DUSHI — *Kronikë e vëndit tim*
- N. PRIFTI — *Tregime*
- GJ. ZHEJI — *Ngjarje në Çajup*
- A. CERGA — *Njeri i zakonshëm*